

Konrad Adenauer Stiftung

IDSCS | Institute for Democracy Societas Civilis -Skopje

# MANUAL PËR ZGJEDHJET PARLAMENTARE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË 2014

edicioni i dytë i përditësuar

POLITIKË


# MANUAL PËR ZGJEDHJET PARLAMENTARE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË 2014

edicioni i dytë i përditësuar

# MANUAL PËR ZGJEDHJET PARLAMENTARE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË 2014

Jane Dimeski

## Impresum

**Titulli:**
Manual për Zgjedhjet Parlamentare në Republikën e Maqedonisë 2014

**Botues:**
Fondacioni Konrad Adenauer në Republikën e Mqedonisë
Instituti për Demokraci Societas Civilis - Shkup

**Autorë:**
Jane Dimeski

**Bashkërenditje:**
Davor Pashoski

**Përktheu:**
Blerina Starova Zllatku

**Dizajni dhe përgaditja:**
Vinsent grafika

Publikimi mund të shkarkohet falas në:
http://www.kas.de/macedonia
http://www.idscs.org.mk

**Vërejtje:**

**Qëndrimet e prezantuara në këtë publikim nuk janë qëndrime të Fondacionit Konrad Adenauer dhe të Institutit për Demokraci "Societas Civilis" – Shkup, por janë pikëpamje personale të autorit.**

# Përmbatja:


**1. Hyrje në Zgjedhjet Parlamentare 2014** **8**
Përgatitje për zgjedhjet e parakohshme parlamentare 15
Ndryshimet e fundit të legjislacionit zgjedhor 17

**2. Historiku i Zgjedhjeve Parlamentare në Maqedoni (1990 - 2011)** **20**
Zgjedhjet Parlamentare të vitit 1990 21
Zgjedhjet Parlamentare të vitit 1994 23
Zgjedhjet Parlamentare të vitit 1998 25
Zgjedhjet Parlamentare të vitit 2002 27
Zgjedhjet Parlamentare të vitit 2006 28
Zgjedhjet Parlamentare të vitit 2008 29
Zgjedhjet Parlamentare të vitit 2011 31

**3. Sistemi zgjedhor maqedonas për zgjedhjet Parlamentare** **34**
Organet zgjedhore 37
E drejta për t'u zgjedhur 38
E drejta dhe procedura për paraqitjen e kandidaturave 39
Kufizimi i funksionarëve aktual 41
Fushata zgjedhore 43
Roli i mjeteve të informimit publik 45
Monitorimi i zgjedhjeve 46

**4. Njësi zgjedhore** **48**
Njësi zgjedhore 1 51
Njësi zgjedhore 2 52
Njësi zgjedhore 3 53
Njësi zgjedhore 4 54
Njësi zgjedhore 5 55
Njësi zgjedhore 6 56
Njësi zgjedhore 7 57
Njësi zgjedhore 8 58
Njësi zgjedhore 9 59

**5. Pasqyra e pjesëmarrësve të Zgjedhjeve të Parakohshme Parlamentare 2014** **60**
Lidhja Socialdemokrate e Maqedonisë (LSDM) 61
Partia Demokratike Shqiptare (PDSH) 68
Koalicioni "Dinjiteti për Maqedoni" 72
Bashkimi Demokratik për Integrim (BDI) 73
VMRO – Partia Demokratike për Unitetin Kombëtar Maqedonas (VMRO-DPMNE) 78
Rilindja Demokratike Kombëtare (RDK) 84
Lëvizja Popullore E Maqedonisë (LPM) 85
Koalicioni OPQM 86
Koalicioni për Maqedoni Pozitive 87
VMRO – Partia Popullore (VMRO - PP) 88
Partia Social Demokrate e Maqedonisë (PSDM) 89
Partia për Ndryshime Ekonomike 21 (PNE 21) 90
Partia për Prosperitet Demokratik (PPD) 91
Partia për Ardhmëri Evropiane (PAE) 92

**6. Zgjedhje të parakohshme parlamentare në Republikën e Maqedonisë 2014 – rezultate, fushata, vlerësim** **94**
Lista e shkurtesave 95
Hyrje 96
Fushata zgjedhore dhe financimi 98
Mediat 106
Rezultate nga Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare 2014 114
Mbrojtja e të drejtës së zgjedhjes 118
Vlerësimi i zgjedhjeve nga vëzhguesit 120
Vlerësimi i zgjedhjeve nga partitë politike 127
Konkluzione 131

**7. Burime** **136**

# HYRJE NË ZGJEDHJET PARLAMENTARE 2014



Zgjedhjet e shtata parlamentare nga pavarësimi i Maqedonisë dhe zgjedhjet e treta me radhë të parakohshme të njëpasnjëshme për legjislaturën e Kuvendit do të mbahen më 27 prill 2014, bashkë me rrethin e dytë të zgjedhjeve të pesta presidenciale. Legjislatura e fundit e Kuvendit të RM-së unanimisht, me 117 vota ”PRO” nga 117 deputetë të pranishëm, më 5 mars të vitit 2014, mori vendim për shpërndarjen e Kuvendit, që është një vjet e tre muaj para skadimit të mandatit të rregullt të deputetëve, të fituar në zgjedhjet e fundit të cilat u mbajtën më 5 qershor të vitit 2011. Kryetari i Kuvendit, Trajko Veljanovski, ditën e ardhshme, më 6 mars, në kuadër të kompetencave të veta kushtetuese dhe ligjore i caktoi zgjedhjet[1] për 27 prill që përputhet me afatin ligjor, përkatësisht zgjedhjet duhet të mbahen brenda afatit prej 60 ditësh, nga dita e shpërndarjes së Kuvendit. Votimi jashtë vendit, i cili mbahet në përfaqësitë diplomatike-konsullore (PDK), do të mbahet një ditë më parë, përkatësisht më 26 prill. Ditën e njëjtë do të votojnë personat e sëmurë dhe të pamundur në shtëpitë e tyre, personat që vuajnë dënimin me burgim apo të cilëve u është shqiptuar masa e paraburgimit në entet ndëshkuese-korrektuese, personat të cilëve u është përcaktuar masa e arrestit shtëpiak në vendet ku e vuajnë arrestin shtëpiak dhe personat e zhvendosur, të cilët do të votojnë në shtëpi kolektive ose në qendrat e pranimit.

Procedura e mbledhjes së nënshkrimeve para Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve (KSHZ) për propozimin e listave të kandidatëve për deputetë në Kuvendin e RM-së nga grup zgjedhësish filloi 10 ditë pas shpalljes të zgjedhjeve, përkatësisht më 16 mars dhe zgjati deri më 25 mars. Listat përfundimtare të kandidatëve të të gjithë pjesëmarrësve në zgjedhje, sipas afatit ligjor, paraqiten në KSHZ më së voni deri në mesnatë të datës 29 mars.

[1] Vendim për shpalljen e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare për deputetë në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë, “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 46, 6 mars 2014. I aksesshëm në: http://www.sec.mk/index.php?limitstart=20&lang=mk (vizita e fundit: 28 mars 2014).

Deri në afatin e fundit, lista me kandidatë të tyre, paraqitën gjithsej 14 subjekte politike.[2] Partia e parë, e cila i publikoi bartësit e listave të kandidatëve të tyre, në njësitë zgjedhore në territorin e Maqedonisë, është partia më e madhe e shqiptarëve etnikë, Bashkimi Demokratik për Integrim (BDI), parti e cila edhe i inicioi zgjedhjet e parakohshme parlamentare. BDI, e cila në qeverinë e fundit ishte partner koalicioni, në konferencë për shtyp[3] më 21 mars, publikoi se do të kandidojë lista të veta në 5 nga 6 njësitë zgjedhore (NJZ) brenda shtetit, përkatësisht nuk do të paraqesë listë vetëm në NJZ 4, e cila e përfshin Maqedoninë Juglindore. Megjithatë, partia. deri në afatin e fundit. vendosi që edhe në këtë NJZ të ketë kandidatë të tyre ashtu si edhe në NJZ - 7 për Evropë dhe Afrikë, NJZ - 8 për Amerikën Veriore dhe Jugore dhe për NJZ - 9 për Australi dhe Azi. Kjo është hera e parë[4] prej se BDI merr pjesë në zgjedhje parlamentare nga viti 2002 që të paraqesë listë të vet në NJZ - 4, rajon me elektorat dominant etnik maqedonas. BDI u përcaktua që për bartës të listave të kandidatëve të nominojë kandidatë me përvojë nga kreu i partisë, në mesin e të cilëve edhe liderin Ali Ahmeti.

Forca e dytë politike, e cila e miratoi dhe e publikoi vendimin për bartësit e listave, është Koalicioni i udhëhequr nga partia më e madhe opozitare – Lidhja Socialdemokrate e Maqedonisë (LSDM).[5] Në Kongresin e LSDM-së, më 23 mars, u përcaktuan listat e kandidatëve për të gjitha gjashtë NJZ dhe programi zgjedhor, ndërsa pastaj u publikuan para publikut. Deri në skadimin e afatit ligjor, më 29 mars, Koalicioni paraqiti lista edhe për tre njësitë zgjedhore jashtë vendit për NJZ - 7, 8 dhe 9, por edhe ndryshime të listave për gjashtë njësitë e para zgjedhore.[6]

2 Njoftim për listat e paraqitura të kandidatëve për deputetë në Kuvendin e RM-së, Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve, 30 mars 2014. I aksesshëm në: http://www.sec.mk/index.php?lang=mk (vizita e fundit: 31 mars 2014).

3 Bedri Rexhallari, BDI i përcaktoi listat e kandidatëve për deputetë, "Alsa-M", 21 mars 2014. I aksesshëm në: http://goo.gl/mlmJ75 (vizita e fundit: 28 mars 2014).

4 Daliborka Demjanska, BDI me kandidatë për deputetë në të gjitha njësitë zgjedhore, "Telma", 29 mars 2014. I aksesshën në: http://telma.com.mk/index.php?task=content&cat=1&rub=15&item=36315 (vizita e fundit 31 mars 2014).

5 Zaev: Ofertë e ndershme e deputetëve, udhëheqja do ta formojë qeverinë e ardhshme, LSDM, 23 mars 2014. I aksesshëm në: http://sdsm.org.mk/default.aspx?mId=55&agId=5&articleId=10185 (vizita e fundit: 31 mars 2014).

6 N. K., Ndryshime të papritura të listave të LSDM-së, "Utrinski vesnik", 31 mars 2014. I aksesshëm në: http://www.utrinski.mk/default.asp?ItemID=CE331B3F02BDA7418FF97D108DB23802 (vizita e fundit: 1 prill 2014).

Koalicioni, në çastin e fundit, vendosi të ndërrojë 17 emra nga listat e kandidatëve të përcaktuar në Kongres, numri më i madh i tyre për shkak të dorëheqjes së vet kandidatëve. Në mesin e anëtarëve që gëzojnë autoritet, por që dhanë dorëheqje nga kandidatura, ishte edhe Nano Ruzhin nga PLD, ish ambasador i Maqedonisë në NATO dhe kandidat presidencial në zgjedhjet e vitit 2009, me justifikimin se vendin ua lë kandidatëve më të rinj. Për dallim nga BDI, LSDM-ja vendosi që në mesin e bartësve të listave zgjedhore të mos jenë figurat më të larta të partisë, kryetari Zoran Zaev dhe nënkryetarja Radmila Shekerinska. Arsyetimi i LSDM-së është se bëhet fjalë për një koncept të ri, udhëheqësia e partisë të mos jetë bartëse e listave zgjedhore, por bartës të jenë kandidatët të cilët gëzojnë autoritet brenda bashkësive të tyre, e që do t'i përfaqësojnë qytetarët në Kuvend. Së këtejmi, figurat më të larta të partisë do të jenë ato të cilat, eventualisht, do ta formojnë përbërjen e Qeverisë nëse partia në zgjedhje e fiton shumicën në Parlament.

Partia e tretë, e cila para publikut doli me bartësit e listave të kandidatëve, është Koalicioni OPQM (GROM) i udhëhequr nga partia Opsioni Qytetar për Maqedoni OPQM (GROM). Këshilli i Bordit Qendror të OPQM, më 28 mars, vendosi dhe, menjëherë në konferencë për shtyp, i publikoi bartësit e listave në të gjitha gjashtë NJZ brenda shtetit.[7]

Koalicioni "Për Maqedoni më të Mirë" i udhëhequr nga partia në pushtet Organizata e Brendshme Revolucionare Maqedonase – Partia Demokratike për Unitet Kombëtar Maqedonas (VMRO-DPMNE) bartësit e vet i publikoi ditën e fundit të afatit ligjor, pas mbledhjes së mbajtur të Komitetit Qendror.[8] Ashtu siç pritej, Koalicioni i VMRO-DPMNE-së i publikoi listat e kandidatëve për të gjitha 9 NJZ, ndërkaq në të njëjtat, sipas një praktike tanimë të vendosur të partisë nga zgjedhjet paraprake, bartës janë anëtarët e udhëheqësisë më të lartë të partisë, përfshirë këtu edhe liderin Nikolla Gruevski.

7 Koalicioni OPQM (GROM) e kompletoi listën e deputetëve për Zgjedhjet Parlamentare 2014,OPQM ( GROM), 28 mars 2014. I aksesshëm në: http://grom.mk/?p=3962 (vizita e fundit: 28 mars 2014).

8 VMRO-DPMNE me lista për shumicë absolute në parlament, "Kurir", 29 mars 2014. I aksesshëm në: http://www.kurir.mk/makedonija/vesti/152782-VMRO-DPMNE-so-listi-za-apsolutno-mnozinstvo-vo-Parlamentot (vizita e fundit: 31 mars 2014).

Partia më e madhe opozitare e shqiptarëve – Partia Demokratike Shqiptare (PDSH) paraqiti lista të kandidatëve për 5 njësi zgjedhore në Maqedoni, përkatësisht nuk ka paraqitur listë me kandidatë vetëm për njësinë e katërt zgjedhore. Jashtë vendit PDSH-ja do të garojë në NJZ - 7 dhe 8.

Rilindja Demokratike Kombëtare (RDK) paraqiti lista të kandidatëve për NJZ 1, 2, 5, 6 dhe 7. Koalicioni Dinjitet për Maqedoninë paraqiti lista të kandidatëve për të gjitha 6 NJZ në Maqedoni dhe për NJZ 8 jashtë vendit.

Për të gjitha 6 NJZ brenda shtetit lista paraqitën edhe VMRO-Partia Popullore (VMRO-PP), Koalicioni për Maqedoni Pozitive i udhëhequr nga partia Aleanca për Maqedoni Pozitive (AMP) dhe Partia Socialdemokrate e Maqedonisë (PSDM). Partia politike, Lëvizja Popullore për Maqedoni (LPM), lista të kandidatëve ka paraqitur në pesë NJZ 1, 2, 3, 4 dhe 5, Partia për Ardhmëri Evropiane (PAE) në katër njësi zgjedhore brenda shtetit 1, 2, 5 dhe 6. Partia për Ndryshime Ekonomike 21 (PNE 21) ka lista për njësitë zgjedhore 1 dhe 2, ndërkaq Partia për Prosperitet Demokratik (PPD) listë me kandidatë paraqiti vetëm për njësinë e gjashtë zgjedhore.

Në periudhën para shpalljes së zgjedhjeve presidenciale[9] në publik kishte spekulime për mundësinë e mbajtjes së njëkohshme edhe të zgjedhjeve të parakohshme parlamentare.[10] Megjithatë, deri në shpalljen e tyre konkrete erdhi sipas nismës së BDI, si rezultat i mospasjes së suksesit të partisë që të fitojë mbështetje nga blloku politik maqedonas për idenë "Kandidat konsesual për President". Lideri i partisë Ali Ahmeti paraprakisht, në muajin dhjetor, doli me qëndrim se nuk e mbështet Presidentin aktual Gjorge Ivanov,[11] meqë në masë të pamjaftueshme i ka prezantuar shqiptarët etnikë të Maqedonisë. Pastaj, partia doli me qëndrim se nuk do të promovojë kandidat të vet për President dhe angazhohej për të ashtuquajturin "President konsesual", përkatësisht President të pranueshëm për të gjitha bashkësitë etnike në Maqedoni, i cili "do t'i përfaqësojë të gjithë qytetarët e Maqedonisë". Në këtë mënyrë BDI në periudhën parazgjedhore refuzoi t'i japë mbështetje njërit nga kandidatët e nominuar presidencial, përfshirë këtu edhe kandidatin e partnerit të koalicionit VMRO-DPMNE, Gjorge Ivanov. Meqë të dy partnerët e koalicionit VMRO-DPMNE dhe BDI nuk arritën të gjejnë zgjidhje të përbashkët, sa i përket propozimit për "President konsensual" dhe pasi që tanimë u bë e qartë se VMRO-DPMNE do ta mbështesë Ivanovin për mandatin e dytë presidencial, Grupi parlamentar i BDI-së, më 1 mars, formalisht në Kuvend paraqiti nismë për shpërndarjen e tij dhe për shpalljen e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare. Po atë ditë, në Konventën partiake, për zgjedhjen e kandidatit presidencial, Kryeministri dhe kryetari i VMRO-DPMNE-së Nikolla Gruevski, para delegatëve, anëtarësisë dhe para publikut deklaroi se VMRO-DPMNE e pranon propozimin e BDI-së dhe së këndejmi në Maqedoni do të mbahen zgjedhje të parakohshme parlamentare. LSDM-ja e pranoi nismën për shpërndarjen e Kuvendit[12] me arsyetimin se kjo është një mundësi që qytetarët në zgjedhje t'i ndëshkojnë politikat qeveritare me të cilat, siç pohojnë nga opozita, shteti shënon procese retrograde.

Karakteristikë e këtyre zgjedhjeve është se në këto zgjedhje do të marrin pjesë edhe dy parti të sapoformuara. Partia e parë është OPQM (GROM) në krye të së cilës është Stevçe Jakimovski, aktualisht Kryetar i Komunës Karposh. Para Zgjedhjeve Lokale të vitit 2013 Jakimovski ishte Kryetar i Komunës Karposh dhe kryetar i organizatës së Qytetit të Shkupit i LSDM-së. Ai, në muajin shkurt të vitit 2013, u përjashtua[13] nga LSDM-ja meqë nuk e respektoi vendimin partiak për bojkotimin e zgjedhjeve lokale

9 Manual për Zgjedhjet Presidenciale në Republikën e Maqedonisë të vitit 2014, Fondacioni Konrad Adenauer dhe Instituti për Demokraci "Societas Civilis"– Shkup, f. 9-12. I aksesshëm në: http://www.kas.de/wf/doc/kas_37241-1522-2-30.pdf?140327134356 (vizita e fundit: 28 mars 2014).

10 Mirjana Spasovska, Zgjedhjet parlamentare gjithnjë e më të mundshme, "Radio Evropa e Lirë", programi në gjuhën maqedonase, 27 shkurt 2014. I aksesshëm në: http://www.makdenes.org/content/article/25279023.html (vizita e fundit: 24 mars 2014).

11 Zorana Gaxhovska Spasovska, Ahmeti – Nuk do të ketë bombardime në koalicion, "Radio Evropa e Lirë", programi në gjuhën maqedonase, 22 dhjetor 2013. I aksesshëm në: http://www.makdenes.org/content/article/25208426.html (vizita e fundit: 31 mars 2014).

12 "Kuvendi u shpërnda" - "Zëri i Amerikës", programi në gjuhën maqedonase, 5 mars 2014, http://mk.voanews.com/content/parliament-dissolved-voted-for-early-parliamentary-elections/1864874.html.

13 LSDM e përjashtoi Stevço Jakimovski-n nga partia, "24 Vesti", 17 shkurt 2013. I aksesshëm në: http://24vesti.mk/sdsm-go-iskluchi-stevcho-jakimovski-od-partijata (vizita e fundit: 31 mars 2014)..

dhe në çastet e fundit në KSHZ e paraqiti kandidaturën e tij për Kryetar të Komunës Karposh përmes Partisë Përparimtare Serbe në Maqedoni (PPSM). Jakimovski, i cili është ish-ministër i ekonomisë dhe i punës dhe politikës sociale në Qeverinë e Branko Crvenkovskit, pas zgjedhjeve parlamentare të vitit 2002, pa mbështetjen e ndonjë partie të madhe politike arriti në zgjedhjet lokale të vitit 2013 t'i fitojë kandidatët e LSDM-së dhe VMRO-DPMNE-së dhe sërish të zgjidhet për kryetar komune. Së shpejti, pas zgjedhjeve në nivel komunal, bëri koalicion me grupin e këshilltarëve të VMRO-DPMNE-së, ndërsa një muaj më vonë, më 29 shtator 2013, e formoi partinë OPQM (GROM.[14] Partia e re, për një ditë e gjysmë, nga fillimi i afatit për mbledhjen e nënshkrimeve për kandidimin në zgjedhjet presidenciale, arriti të mbledh 10 mijë nënshkrime[15] dhe ta kandidojë profesorin Zoran Popovski, si njërin nga katër kandidatët që do të garojnë në zgjedhjet presidenciale.

Partia e dytë është AMP, e udhëhequr nga Vlado Buçkovski, profesor universitar, ish Kryeministër dhe kryetar i LSDM-së, nga ish kryeredaktori dhe pronari i revistës javore "Kapital" Lupço Zikov dhe nga biznesmeni Minço Jordanov. AMP-ja filloi si lëvizje civile, në muajin maj të vitit 2013, ndërkaq në mars të vitit 2014 u regjistrua si parti politike. Kryetar i partisë është Zikov, por shtytjen kryesore politike në zgjedhje pritet ta japë Buçkovski[16] për shkak të përvojës së tij politike. Ai, në Qeverinë e LSDM-së, në krye me Branko Crvenkovskin në vitin 2002, ishte Ministër i Mbrojtjes. Pasi që Branko Crvenkovski, në vitin 2004, u kandidua dhe fitoi në zgjedhjet e jashtëzakonshme presidenciale[17] në pozitën e Kryeministrit

14 Stevçe Jakimovski: OPQM (GROM) nuk u formua për të qenë opozitë, por për të qenë pushtet, "Republika", 29 maj 2013. I aksesshëm në: http://republika.mk/?p=74417 (vizita e fundit: 31 mars 2014).

15 Manual për Zgjedhjet Presidenciale në Republikën e Maqedonisë të vitit 2014, Fondacioni Konrad Adenauer dhe Instituti për Demokraci "Societas Civilis"–Shkup, f. 10. I aksesshëm në: http://www.kas.de/wf/doc/kas_37241-1522-2-30.pdf?140327134356 (vizita e fundit: 28 mars 2014).

16 Vllado Buçkovski lider i ri i LSDM dhe Kryeministër, "Utrinski vesnik", 27 nëntor 2004. I aksesshëm në: http://star.utrinski.com.mk/?pBroj=1638&stID=26160&pR=2 (vizita e fundit: 31 mars 2014).

17 Manual për Zgjedhjet Presidenciale në Republikën e Maqedonisë të vitit 2014, Fondacioni Konrad Adenauer dhe Instituti për Demokraci "Societas Civilis"– Shkup, f. 28. I aksesshëm në: http://www.kas.de/wf/doc/kas_37241-1522-2-30.pdf?140327134356 (vizita e fundit: 30 mars 2014).



erdhi Hari Kostov, Ministër i deriatëhershëm i Punëve të Brendshme. Vetëm pas 5 muajsh Kostov dha dorëheqje, ndërkaq në Kongresin e LSDM-së, në dhjetor të vitit 2004, për Kryeministër dhe për lider të partisë u votua Buçkovski.[18] Ai ishte në krye të socialdemokratëve në zgjedhjet parlamentare të vitit 2006 kur VMRO-DPMNE e fitoi pushtetin. Në Konventën partiake, pas zgjedhjeve në tetor të vitit 2006, Buçkovskit iu votua mosbesim,[19] me ç'rast ai u largua nga vendi i liderit të partisë. Për shkak të mospajtimit publik me politikat e partisë, në muajin dhjetor të vitit 2012, Buçkovski u përjashtua nga LSDM.[20]

## PËRGATITJE PËR ZGJEDHJET E PARAKOHSHME PARLAMENTARE

Më 7 mars, KSHZ-ja miratoi Kalendarin e afateve për realizimin e aktiviteteve zgjedhore për zbatimin e zgjedhjeve të parakohshme për deputetë të Kuvendit.[21] KSHZ-ja në vazhdimësi i plotëson komisionet komunale të zgjedhjeve (KKZ) me anëtarë në vendet e atyre që u ka pushuar mandati ose ka pasur kërkesë për shkarkim. Në Kalendarin e afateve ceket se rreth zgjedhjeve parlamentare, KSHZ-ja dhe komisionet komunale të zgjedhjeve (KKZ) do t'i ndërmarrin vetëm ato aktivitete

18 Vllado Buçkovski, më 9 dhjetor të vitit 2008 akuzohet se ka abuzuar me pozitën zyrtare, me çka me 3 milionë euro është dëmtuar buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes, derisa ai ka qenë ministër në vitin 2001 në rastin: "Pjesë këmbimi për tanke", nga gjykata e shkallës së parë është dënuar me 3,5 burgim. Gjykata e Apelit e anuloi aktgjykimin në vitin 2009 dhe e ktheu rastin në gjykim të sërishëm. Më 1 korrik të viti 2013 gjykata e shkallës së parë përsëri e dënoi Buçkovskin me 3 vjet burgim. Në rrjedhë është procedura e ankimimit të sërishëm të aktgjykimit para Gjykatës së Apelit.

19 LSDM përgatitet për zgjedhjen e liderit të ri, "Dojçe Vele", programi në gjuhën maqedonase, 10 tetor 2006. I aksesshëm në: http://www.dw.de/%D1%81%D0%B4%D1%81%D0%BC-%D1%81%D0%B5-%D0%BF%D0%BE%D0%B4%D0%B3%D0%BE%D1%82%D0%B2%D1%83%D0%B2%D0%B0-%D0%B7%D0%B0-%D0%B8%D0%B7%D0%B1%D0%BE%D1-%80-%D0%BD%D0%B0-%D0%BD%D0%BE%D0%B2-%D0%BB%D0%B8%D0%B4%D0%B5%D1%80/a-2535543 (vizita e fundit: 31 mars 2014).

20 Buçkovski dhe Buzlevski përjashtohen nga LSDM-ja, "Telma", 15 dhjetor 2012. I aksesshëm në: http://www.telma.com.mk/index.php?task=content&cat=1&rub=15&item=22543 (vizita e fundit: 31 mars 2014).

21 Kalendari i afateve për realizimin e aktiviteteve zgjedhore për zbatimin e zgjedhjeve të parakohshme për deputetë në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë, Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve, 7 mars 2014. I aksesshëm në: http://www.sec.mk/files/izbori2014/parlamentarni/rokovnik.pdf (vizita e fundit: 31 mars 2014).

të cilat kanë të bëjnë me plotësimin e këshillave zgjedhorë (KZ) sipas propozimeve të partive politike edhe atë deri më 26 mars. Në PDK-të këshillat zgjedhorë, KSHZ-ja do t'i formojë më së voni deri më 27 mars.

Në përputhje me Kodin Zgjedhor, KSHZ-ja, 10 ditë pas shpalljes së zgjedhjeve, më 16 mars, Listën e Zgjedhësve e vuri në këqyrje publike në Internet faqen http://izbirackispisok.gov.mk, në njësitë rajonale dhe zyrat vendore dhe në PDK-të. Këqyrja në Listë zgjati deri më 30 mars. Në afat prej 5 ditësh, pas përfundimit të këqyrjes, deri më 4 prill, Listën e Zgjedhësve KSHZ-ja ua dërgoi partive politike, të cilat më pas, brenda afatit prej 5 ditësh, deri më 9 prill, eventualisht paraqesin kërkesë për regjistrim, plotësim ose shlyerje të të dhënave. Komisioni, sipas kërkesave vendos në afat prej 3 ditësh.

Shtetasit maqedonas, të cilët janë me qëndrim të përkohshëm ose me punë jashtë vendit, në mënyrë që të mund të votojnë në zgjedhje, nga data 6 mars, ndërsa më së voni deri më 30 mars, përmes PDK-ve duhej të dërgonin Fletëparaqitje, personalisht të nënshkruar (dora vet), për votim ose Fletëparaqitje elektronike drejtpërsëdrejti në adresë të KSHZ-së.

Sipas afateve të përcaktuara ligjore dhe sipas Kalendarit të afateve të KSHZ-së për zbatimin e Zgjedhjeve të Parakohshme Parlamentare 2014, fushata zgjedhore për këto zgjedhje do të zgjasë nga 5 prilli deri më 25 prill të vitit 2014. Për shkak të heshtjes zgjedhore dhe votimit për rrethin e parë të zgjedhjeve presidenciale, më 12 dhe 13 prill, fushata zgjedhore për zgjedhjet parlamentare do të pezullohet.

Sipas Kalendarit të afateve, raportet financiare të organizatorëve të fushatës zgjedhore, pranë KSHZ-së, Entit Shtetëror të Revizionit (ESHR) dhe Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KSHPK) u dërgohet në afatet si vijojnë:

- më 14 prill për të ardhurat dhe shpenzimet për 11 ditët e para të fushatës;
- më 26 prill për të ardhurat dhe shpenzimet për gjysmën e dytë të fushatës;
- raportet finale financiare dërgohen menjëherë, ndërsa më së voni deri më 20 maj, përkatësisht 25 ditë nga përfundimi i fushatës zgjedhore;
- Enti Shtetëror i Revizionit (ESHR), më së voni deri më 14 korrik, zbaton revizion mbi të gjitha raportet financiare të fushatës.

Ndërkaq, nga 4 marsi, filloi periudha e përcaktuar me nenin 8-a nga Kodi Zgjedhor, në të cilën nuk mund të paguhen subvencione, të cilat nuk janë pagesa të rregullta mujore, e as të mbahen ngjarje publike me rastin e fillimit të ndërtimit ose lëshimit në përdorim të objektit ose infrastrukturës të financuara me mjete nga Buxheti, fondet publike, si dhe mjete të ndërmarrjeve publike me kapital shtetëror. Në përputhje me Kalendarin e afateve, kërkesat për monitorimin e zgjedhjeve nga vëzhgues vendas dhe të huaj mund të paraqiten në periudhën kohore nga 6 marsi deri më 22 prill të vitit 2014, përkatësisht më së voni 5 ditë para mbajtjes së zgjedhjeve.

## NDRYSHIMET E FUNDIT TË LEGJISLACIONIT ZGJEDHOR[22]

Në takimin ndërmjet Qeverisë dhe përfaqësuesve të partive politike, të mbajtur më 15 janar të vitit 2014, u arrit marrëveshje për ndryshime[23] të Kodit Zgjedhor, me të cilat do të miratohen vërejtjet nga raportet monitoruese OSBE/ODIHR[24] dhe vërejtjet e opozitës. Ndryshimet e Kodit Zgjedhor u miratuan me procedurë të shkurtuar më 23 janar të vitit 2014

[22] Për më shumë informacione rreth ndryshimeve të fundit të legjislacionit zgjedhor, shih: Manual për Zgjedhjet Presidenciale në Republikën e Maqedonisë të vitit 2014, Fondacioni Konrad Adenauer dhe Instituti për Demokraci "Societas Civilis"– Shkup, f. 15 - 23. I aksesshëm në: http://www.kas.de/wf/doc/kas_37241-1522-2-30.pdf?140327134356 (vizita e fundit: 31 mars 2014).

[23] Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Zgjedhor, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 14/2014. I aksesshëm në: http://www.pravo.org.mk/document-Detail.php?id=665 (vizita e fundit: 15 shkurt 2014).

[24] OSBE Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut. Republika e Maqedonisë, Zgjedhje Lokale 24 mars dhe 7 prill 2013, Raport përfundimtar, Varshavë 9 korrik 2013. I aksesshëm në: http://www.osce.org/mk/odihr/elections/103832 (vizita e fundit: 15 shkurt 2014).

me mbështetjen e të gjitha partive politike, me përjashtim të PDSH-së. Ndryshimet kishin të bënin me të gjitha vërejtjet kryesore të kornizës normative për zgjedhjet, me përjashtim të sistemit zgjedhor të votimit dhe shpërndarjes së mandateve në njësitë zgjedhore jashtë vendit. Partitë politike nuk ranë dakord për këtë çështje, prandaj u morën vesh që e njëjta të zgjidhet para zgjedhjeve të ardhshme parlamentare.

Ndryshimet dhe plotësimet e Kodit Zgjedhor kanë të bëjnë me këto aspekte thelbësore të procesit zgjedhor:

- Ndarja e shtetit nga partia, në kontekstin e kufizimit të disponimit të mjeteve buxhetore, gjatë kohës së procesit zgjedhor.
- Lidhur me kundërshtimet, KSHZ-ja të vendos vetëm në bazë të këqyrjes në materialin zgjedhor dhe provave të tjera.
- Ndryshime tek organet e administratës zgjedhore rreth afateve për raportet, përbërjen e këshillave zgjedhorë, afatet për listat e kandidatëve.
- Afatet rreth procedimit të KSHZ-së sipas kundërshtimeve.
- Ndryshime në Listën e Zgjedhësve (LZ), të cilat kanë të bëjnë me ekstraktet e posaçme për votim në PDK-të, dërgimi i të dhënave nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe gjykatat kompetente për evidentimin në LZ, kohëzgjatja e këqyrjes dhe mundësia për të kërkuar ndryshime në LZ.
- Ndryshime të procedurës për kandidim dhe afatet për paraqitjen e listave të kandidatëve
- Prezantimi mediatik, në aspekt të mundësimit të kushteve të barabarta për qasje deri te të gjitha format e prezantimit mediatik, shmangie të dhënies privilegj ndonjë subjekti politik, saktësimi i mundësisë për pjesëmarrjen e gazetarëve, redaktorëve, moderatorëve dhe prezantuesve në fushata zgjedhore, regjistrim i detyrueshëm i programeve nga ana e servisit publik radiodifuziv dhe nga radiodifuzerët privat - tregtar, kushtet dhe listat e çmimeve për reklamim politik.



- Ndryshime në pjesën e financimit të fushatës zgjedhore në lidhje me kufizimin e lartësisë së donacioneve dhe instalimin e sistemit elektronik për kontrollin e identitetit personal të votuesve.
- Kufizimi i madhësisë së vendit zgjedhor.

Vërejtjen e vetme të OSBE/ODIHR, të cilën partitë nuk e shqyrtuan është ndryshimi i mënyrës së votimit jashtë vendit. Rekomandimi nga zgjedhjet e kaluara të parakohshme parlamentare në vitin 2011 është se duhet të rishikohet sistemi ekzistues i shpërndarjes së mandateve në njësitë zgjedhore jashtë vendit, në mënyrë që të krijohet siguri se votat e nevojshme nga diaspora, për zgjedhjen e deputetëve në Kuvend, nuk do ta nënvlerësojë në masë të konsiderueshme të drejtën e barabartë të zgjedhjes, të garantuar me Kushtetutë dhe me Kodin Zgjedhor. Gjatë negociatave rreth ndryshimit të fundit të Kodit Zgjedhor, në muajin janar, përfaqësuesit e partivee[25] nga pushteti dhe opozita vendosën që rreth kësaj vërejtje të bisedohet para zgjedhjeve të ardhshme parlamentare. Mirëpo, meqë data e zgjedhjeve u caktua, kjo pikë nuk u diskutua mes partive, kështu që tre deputetët nga NJZ 7, 8 dhe 9 përsëri do të zgjidhen sipas modelit të njëjtë, sikurse edhe në vitin 2011.

[25] ZH. A. U votuan ndryshimet e Kodit Zgjedhor, “Dojçe Vele”, programi në gjuhën maqedonase, 21 janar 2014. I aksesshëm në: http://www.dw.de/%D0%B8%D0%B7%D0%B3%D0%BB%D0%B0%D1%81%D0%B0%D0%BD%D0%B8-%D0%B8%D0%B7%D0%BC%D0%B5%D0%BD%D0%B8%D1%82%D0%B5-%D0%B2%D0%BE-%D0%B8%D0%B7%D0%B1%D0%BE%D1%80%D0%BD%D0%B8%D0%BE%D1%82-%D0%B7%D0%B0%D0%BA%D0%BE%D0%BD%D0%B8%D0%BA/a-17383099 (vizita e fundit: 31 mars 2014).

# HISTORIKU I ZGJEDHJEVE PARLAMENTARE NË MAQEDONI (1990 - 2011)

## ZGJEDHJET PARLAMENTARE TË VITIT 1990

Pas instalimit të pluralizmit politik, me ndryshimet kushtetuese të vitit 1989, me çka u mundësua formimi i partive politike, votuesit maqedonas, për herë të parë patën mundësi të votojnë në zgjedhjet shumë-partiake në vitin 1990,[26] në Republikën e atëhershme Socialiste të Maqedonisë (RSM). Njëkohësisht, ato ishin edhe zgjedhjet e para të lira shumë-partiake të cilat gjatë vitit të njëjtë u zhvilluan në të gjitha gjashtë republikat e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (RSFJ). Zgjedhjet u organizuan në një atmosferë në të cilën shihej fillimi i shpërbërjes së Federatës dhe së këtejmi procesi i zgjedhjeve në shumicën e republikave rezultoi me fitoren e partive të sapoformuara kombëtare ndaj partive të cilat lindën nga degëzimet republikane të Partisë Komuniste të Jugosllavisë. Në Maqedoni zgjedhjet u zhvilluan sipas sistemit zgjedhor mazhoritar në dy rrethe zgjedhore, me ç'rast territori i Republikës u nda në 120 njësi zgjedhore. Në zgjedhjet e para morën pjesë 18 parti politike dhe 43 kandidatë të pavarur. Partitë, në disa nga njësitë zgjedhore, morën pjesë në mënyrë të pavarur, ndërsa në njësi të tjera zgjedhore formuan koalicione të përbashkëta, me ç'rast kandiduan kandidat të përbashkët. Në rrethin e parë, i cili u mbajt më 11 nëntor, më së shumti vota fitoi partia e vetme e deriatëhershme në pushtet, Lidhja Komuniste e Maqedonisë – Partia për Transformim Demokratik (LKM-PTD). Megjithatë, në rrethin e dytë, më 25 nëntor, më së shumti vota fitoi Organizata e Brendshme Revolucionare – Partia Demokratike për Unitet Nacional Maqedonas (VMRO-DPMNE) e themeluar po atë vit.

Në njësitë zgjedhore, në të cilat partitë morën pjesë në mënyrë të pavarur, në rrethin e dytë të zgjedhjeve fituan: VMRO-DPMNE gjithsej - 38 mandate, LKM-PTD – 31, Partia për Prosperitet Demokratik (PPD) – 17, Lidhja e Forcave Reformiste të Maqedonisë (LFRM) – 11, Partia Socialiste e Maqedonisë (PSM) – 4, Partia e Jugosllavëve – 2, Partia Popullore Demokratike (PDP) – 1 mandat, ndërsa në Parlament hynë

[26] Komisioni Republikan (Shtetëror) i Zgjedhjeve. Zgjedhje Parlamentare të datës 11 dhe 25 nëntor të vitit 1990. Buletini nr. 20. Rezultatet përfundimtare nga zgjedhjet për deputetë në Kuvendin RS të Maqedonisë . I aksesshëm në: http://www.sec.mk/arhiva/1990_parlamentarni/konecni_rezultati_1990.pdf (vizita e fundit: 24 mars 2014).

edhe tre deputetë të pavarur. Partitë të cilat si koalicione morën pjesë me kandidatë të përbashkët në disa nga njësitë zgjedhore në mënyrë plotësuese fituan: Koalicioni PPD-PDP – 5 mandate, pastaj LFRM/Partia e Re Demokratike Progresive (PRDR) – 6 deputetë, Koalicioni PSM/LFRM/PRDP – 1 dhe Koalicioni Partia për Emancipimin e Plotë të Romëve (PEPR)/PSM një mandat.

Në rrethin e parë, nga gjithsej 1 339 021 votues të regjistruar, në zgjedhje dolën 84,8%, ndërsa në rrethin e dytë 76,8%. Temë kryesore në zgjedhje ishte statusi i RS të Maqedonisë në Federatën jugosllave dhe çështja se a duhet të vazhdohet në rrugën e pavarësimit më të madh. Mandate, në Kuvendin e ri njëdhomësh, fituan nëntë parti dhe tre deputetë të pavarur. Komisioni Republikan i Zgjedhjeve[27] (KRZ) deklaroi se në zgjedhje, përveç mosmarrëveshjeve të karakterit procedural, nuk ka pasur eksese drastike. Për shkak të parregullsive të konstatuara, u anuluan zgjedhjet në 176 vende zgjedhore, nga 33 njësi zgjedhore në 14 komuna.

Për shkak të raportit relativisht të barabartë të forcave në Kuvend u krijuan vështirësi rreth formimit të Qeverisë, kështu që në fund u formua Qeveri teknike. Mandatin për formimin e Qeverisë e fitoi anëtari i Akademisë Maqedonase të Shkencave dhe Arteve (AMSHA) Nikolla Klusev, i cili për vendet e ministrave propozoi ekspertë. Në përbërjen e saj[28] u përfshin profesorë universitarë dhe intelektualë, ndërsa deputetët e votuan më 20 mars të vitit 1991.

Në mandatin e saj nga aktet më të rëndësishme u miratua Kushtetuta, u organizua Referendum për pavarësi dhe u formua Armata e Republikës së Maqedonisë (ARM). Për shkak të mosmarrëveshjeve ndërmjet partive, kësaj Qeverie, në muajin gusht të vitit 1992, në Parlament iu votua mosbesim. Presidenti Kiro Gligorov mandatin për formimin e Qeverisë së re fillimisht ia besoi Lubço Georgievskit, lider i VMRO-DPMNE, parti me

[27] Në faqen e internetit të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve nuk janë të aksesshëm dokumentet për mbajtjen e zgjedhjeve në vitin 1990.

[28] Vendim për zgjedhjen e Qeverisë së Republikës Socialiste të Maqedonisë," Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 12 nga 22 marsi 1991. I aksesshëm në: http://www.slvesnik.com.mk/Issues/ACD37FD3850E45519F33B7E0F3267A30.pdf . (vizita e fundit: 22 mars 2014).

numër më të madh të deputetëve në Kuvend, mirëpo ai e ktheu. Pastaj, Gligorovi mandatin ia ofroi Petar Goshev-it nga radhët e LKM/PTD, por edhe ai e refuzoi. Më pas, Presidenti mundësinë për formimin e Qeverisë ia besoi Branko Crvenkovskit, lider i LKM/PTD. Ai e pranoi mandatin dhe e formoi Qeverinë e dytë,[29] e cila kësaj radhe ishte qeveri politike për dallim nga Qeveria e parë eksperte. VMRO-DPMNE atëbotë pohonte se u është bërë padrejtësi, meqë mandatin pas refuzimit të Goshev-it nga LKM/PTD duhej sërish t'i kthehej VMRO-DPMNE-së në vend që dy herë radhazi t'i ofrohej LKM/PTD. Crvenkovski, për formimin e Qeverisë së re, bëri koalicion me partinë e shqiptarëve etnikë PPD, e që më vonë u bë rregull e pashkruar, që në çdo Qeveri, krahas partisë më të madhe maqedonase, të marr pjesë edhe partia e cila i përfaqëson votuesit shqiptarë.

Paraprakisht, më 8 shtator të vitit 1991, u mbajt Referendum[30] për pavarësinë e Maqedonisë nga RSFJ-ja, në të cilin u prononcuan 75,74% e qytetarëve me të drejtë vote. Prej tyre në pyetjen e Referendumit: "A jeni për shtet sovran dhe të pavarur të Maqedonisë, me të drejtë që të anëtarësohet në federatë të ardhshme të shteteve sovrane të Jugosllavisë?", 95,26% të qytetarëve ishin "Pro". Prononcimin e bojkotuan[31] shumica e votuesve shqiptarë.

## ZGJEDHJET PARLAMENTARE TË MUAJIT TETOR 1994

Zgjedhjet e para parlamentare, pas pavarësimit të Maqedonisë, u mbajtën në vitin 1994, njëkohësisht me zgjedhjet e para të drejtpërdrejta për President të shtetit. Në zgjedhje kandidatë të tyre propozuan 38 parti politike, ndërsa u paraqitën 283 kandidatë të pavarur. Fitoi Koalicioni

[29] Vendim për zgjedhjen e Qeverisë së Republikës të Maqedonisë, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 53 nga 7 shtatori 1992. I aksesshëm në: http://www.slvesnik.com.mk/Issues/29E222F36D1D4E4A8C218FAEFF2413CE.pdf (vizita e fundit: 22 mars 2014).

[30] Komisioni Republikan (Shtetëror) i Zgjedhjeve. Referendum më 8 shtator të vitit 1991. Raport për zbatimin dhe rezultatin e referendumit, 20 shtator 1991. I aksesshëm në: http://www.sec.mk/arhiva/1990_Referendum/Izvestaj_za_sproveden_referendum_1990.pdf (vizita e fundit: 22 mars 2014).

[31] Andov:Referendumi na shpëtoi nga lufta "Republika", 7 shtator i vitit 2012. I aksesshëm në: http://republika.mk/?p=9486 (vizita e fundit: 24 mars 2014).

Aleanca për Maqedoni, i udhëhequr nga Lidhja Socialdemokrate e Maqedonisë (LSDM), parti pasardhëse e LKM-PTD. Përkatësisht, partia e ndryshoi emrin në Kongresin e mbajtur në muajin prill të vitit 1991 bashkë me ideologjinë e cila nga komuniste u transformua në socialdemokrate.

Në zgjedhje,[32] të cilat zhvilloheshin sipas modelit zgjedhor mazhoritar, nga gjithsej 1.360.729 votues të regjistruar në rrethin e parë, i cili u mbajt më 16 tetor, dolën 77,8%, ndërkaq në rrethin e dytë, i cili u mbajt më 30 tetor, jehona ishte 57,5%. Ulja e konsiderueshme e daljes në zgjedhje në rrethin e dytë konsiston me faktin se partitë opozitare VMRO-DPMNE dhe Partia Demokratike vendosën ta bojkotojnë votimin.[33] Ata pohonin se në rrethin e parë ka pasur parregullsi serioze të procesit zgjedhor, se ka ndodhur falsifikim zgjedhor dhe mangësi në organizimin e zgjedhjeve, veçanërisht rreth listave të zgjedhësve.

Sipas rezultateve të rrethit të parë, Koalicioni Aleanca për Maqedoninë, në të cilin morën pjesë LSDM dhe PSM, ishte në avantazh të konsiderueshme para partive kryesore opozitare VMRO-DPMNE-së dhe Partisë Demokratike (PD). Aleanca për Maqedoninë fitoi 32,6% të votave, VMRO-DPMNE – 14,3%, ndërsa PD – 11,0%.

Partitë e Aleancës për Maqedoninë, për shkak të bojkotit të opozitës, në rrethin e dytë arritën të fitojnë një numër shumë më të madh të deputetëve. LSDM-ja fitoi gjithsej 60 mandate të deputetëve, PL – 29, PPD – 11, PSM – 9, Partia për Prosperitet Demokratik të Shqiptarëve (PPDSH) – 4, PDP – 2. Nga një mandat deputeti fituan: Partia Demokratike e Maqedonisë (PDM), Partia Demokratike e Turqve (PDT), Lidhja Demokratike e Shqiptarëve-Partia Liberale, Partia Socialdemokrate e Maqedonisë (PSDM) dhe PEPR.

[32] Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve. Zgjedhje Parlamentare 16 dhe 30 tetor 1994. Raport për zgjedhjet e zbatuara për deputetë në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë në vitin 1994. Shkup, 8 nëntor 1994. I aksesshëm në: http://www.sec.mk/arhiva/1994_parlamentarni/izvestaj_parlamentarni_1994.pdf (vizita e fundit: 22 mars 2014).

[33] Dr. Cane Mojanovski, Kronikë e demokracisë maqedonase, faqe 43. Shkup, viti 2000. I aksesshëm në: http://www.fb.uklo.edu.mk/knigi/Cane%20T.%20Mojanoski%20Letopis%20na%20makedonskata%20demokratija.pdf (vizita e fundit: 24 mars 2014).



Rrethi i dytë i këtyre zgjedhjeve u monitorua nga vëzhguesit e Institutit Ndërkombëtar Republikan (IRI).[34] Vëzhguesit, gjatë monitorimit nuk kanë vërejtur probleme serioze në procesin zgjedhor të cilat do ta vinin në pikëpyetje legjitimitetin e zgjedhjeve. Megjithatë, ata nënvizuan se përkrah konstatimit të përgjithshëm se zgjedhjet janë mirë të organizuara, në shumë vende listat e zgjedhësve nuk kanë qenë të azhurnuara dhe në vendvotime të ndryshme, votuesve, nga ana e komisioneve zgjedhore, u janë kërkuar dokumente të ndryshme për identifikimin e tyre, me çka është krijuar konfuzion. Vëzhguesit kanë vërejtur edhe ankesa nga ana e votuesve se për shkak të mefshtësisë së organeve shtetërore akoma nuk i kanë pranuar dokumentet e nevojshme, me çka u është pamundësuar realizimi i të drejtës së tyre të votës. Pas zgjedhjeve, Qeverinë përsëri e formoi Branko Crvenkovski, ndërsa në të njëjtën përveç ministrave nga radhët e LSDM-së pozicione fituan edhe partitë: PSM, PPD dhe PL.

## ZGJEDHJET PARLAMENTARE TË MUAJIT NËNTOR 1998

Zgjedhjet e ardhshme të dhomës ligjvënëse u mbajtën në vitin 1998, sipas modelit zgjedhor të ndryshuar. Në vend të zgjedhjeve sipas modelit mazhoritar në dy rrethe, zgjedhjet u mbajtën sipas sistemit të përzier/kombinuar zgjedhor parlamentar,[35] gjithashtu me votim në dy rrethe. Me ndryshimet, nga 120 mandate, 85 u shpërndanë në njësi zgjedhore me një mandat, për të cilat u votua më 18 tetor, ndërkaq 35 mandatet e tjera sipas sistemit proporcional të D'Hontit, me ç'rast i tërë shteti ishte një njësi zgjedhore, për të cilat votimi u mbajt më 1 nëntor. Për listat proporcionale u inkorporua pragu zgjedhor prej 5%. Nga gjithsej 1.572.976 votues të regjistruar për këto zgjedhje, për listat mazhoritare në votim dolën

[34] Sipas: Institutit Ndërkombëtar Republikan (IRI), Misioni Monitorues i Zgjedhjeve në Maqedoni.
Zgjedhje Parlamentare më 18 dhe 30 tetor, 1994. Raport përfundimtar nga monitorimi i rrethit të dytë të zgjedhjeve. I aksesshëm në: http://www.iri.org/sites/default/files/Macedonia's%201994%20Parliamentary%20Elections.pdf (vizita e fundit: 24 mars 2014).

[35] 3Ligji për zgjedhjen e deputetëve në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 24 nga 28 maji 1998. I aksesshëm në: http://www.slvesnik.com.mk/Issues/EF6EE403BB7A4C52B969183A4F04CA8A.pdf (vizita e fundit: 26 mars 2014) http://www.sec.mk/arhiva/1998_parlamentarni/html/zakon_za_izbor_na_pratenici_vo_sobranieto_na_rm.htm#6.

72,9%. Jehona[36] për listën proporcionale në rrethin e dytë ishte 69,4 %. Për listat mazhoritare me kandidatë të tyre dolën 22 parti politike, 4 koalicione dhe 7 kandidatë të pavarur. Në listat proporcionale garonin 12 parti, 4 koalicione dhe një grup zgjedhësish.

Këto zgjedhje rezultuan me ndërrimin e pushtetit, me ç'rast fitues[37] ishte VMRO-DPMNE me 49 mandate të fituara për deputetë, ndërsa në vend të dytë ishte LSDM me 27 mandate, PPD fitoi 14 mandate të deputetëve, Alternativa Demokratike (AD)- 13, Partia Demokratike Shqiptare (PDSH) - 11, Partia Liberal-Demokrate (PLD) - 4, PSM dhe Lidhja e Romëve në Maqedoni (LRM) nga një mandat në Parlament. Pas zgjedhjeve, lideri i VMRO-DPMNE, Lubço Georgievski, formoi Qeveri koalicioni me AD dhe PDSH.

Këto ishin zgjedhjet e para në Maqedoni të monitoruara nga misioni i OSBE/ODIHR përfaqësuesit e të cilëve erdhën me ftesë të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Maqedonisë. Vërejtje e përgjithshme në Raportin[38] e monitorimit është se në këtë proces zgjedhor ka përmirësime të konsiderueshme krahasuar me zgjedhjet e kaluara për shkak të ndryshimeve në legjislacionin zgjedhor, fushatës korrekte parazgjedhore me një numër të vogël të rasteve të izoluara të dhunës. Vërejtjet kryesore konsistojnë me më shumë raste të regjistruara të votimit familjar dhe grupor dhe mefshtësinë e organeve zgjedhore gjatë përpunimit të të dhënave nga votimet.

36 Dr. Cane Mojanovski, Kronikë e demokracisë maqedonase, faqe 67. Shkup viti 2000. Të dhëna për daljen e votuesve në të dy rrethet e Zgjedhjeve Parlamentare në vitin 1998. I aksesshëm në: http://www.fb.uklo.edu.mk/knigi/Cane%20T.%20Mojanoski%20Letopis%20na%20makedonskata%20demokratija.pdf . (vizita e fundit: 26 mars 2014) . Në ueb-faqen e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve në arkiv të dhënat nuk janë të aksesshme për daljen e votuesve në vitin 1998.

37 Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, Rezultate nga zgjedhja e deputetëve në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë nga Zgjedhjet Parlamentare të vitit 1998. I aksesshëm në: http://www.sobranie.mk/?ItemID=9402373424ED504883EE17FED5E72EB4 (vizita e fundit: 26 mars 2014).

38 Sipas: OSBE Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut. Republika e Maqedonisë, Zgjedhje Parlamentare 18 tetor dhe 1 nëntor të vitit 1998, Raport përfundimtar. I aksesshëm në: http://www.osce.org/odihr/elections/fyrom/15887?download=true (vizita e fundit: 23 mars 2014).



## ZGJEDHJET PARLAMENTARE TË VITIT 2002

Zgjedhjet Parlamentare të 15 shtatorit të vitit 2002 u zhvilluan në një atmosferë të tensionuar pas vitit 2001 në të cilin ndodhi konflikti i armatosur ndërmjet forcave të sigurisë dhe pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare (UÇK), i cili përfundoi me nënshkrimin e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit.[39] Karakteristikë e këtij cikli është se në skenën politike të bllokut politik shqiptar u paraqit një subjekt i ri partia Bashkimi Demokratik për Integrim (BDI) e formuar nga udhëheqësia e UÇK-së. Zgjedhjet u mbajtën sipas modelit zgjedhor proporcional,[40] në gjashtë njësi zgjedhore, ndërsa në listat e kandidatëve kishte përfaqësues nga 53 parti. Nga gjithsej 1.664.296 votues të regjistruar, në zgjedhje dolën 73,4 %, përsëri kishim ndërrim të pushtetit. Shumicën e fitoi Koalicioni "Bashkë për Maqedoninë" i udhëhequr nga LSDM. Koalicioni fitoi 60 mandate, prej të cilëve LSDM fitoi - 43, PLD - 12, PDM - 2 dhe nga një mandat të deputetit fituan Partia e Bashkuar e Romëve në Maqedoni (PBRM), Liga Demokratike e Boshnjakëve (LDB) dhe Partia Demokratike e Serbëve (PDS).

Koalicioni VMRO-DPMNE-PL fitoi gjithsej 33 mandate. Prej të cilave 27 i fitoi VMRO-DPMNE, 5 i fitoi PL dhe një mandat e fitoi Partia e Lëvizjes së Turqve në Maqedoni (PLTM).

Nga partitë politike të shqiptarëve në Maqedoni më së shumti vende në Kuvend fitoi partia e sapoformuar BDI përkatësisht 16 mandate. PDSH fitoi - 7, PPD - 2, ndërsa PDP dhe PSM nga një mandat.

Misioni monitorues i OSBE/ODIHR[41] иshprehu shqetësime për periudhën kohore të fushatës, e cila u parapriu këtyre zgjedhjeve, për shkak të

39 Marrëveshja Kornizë e Ohrit, Sekretariati për Implementimin e Marrëveshjes së Ohrit. I aksesshëm në: http://siofa.gov.mk/data/file/Ramkoven_dogovor_mk.pdf (vizita e fundit: 25 mars 2014).

40 Ligji për zgjedhjen e deputetëve në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë, Neni 96, Verifikimi i rezultateve të votimit në njësitë zgjedhore për Zgjedhjet Parlamentare të vitit 2002. I aksesshëm në: http://www.sec.mk/arhiva/2002_parlamentarni/zakonski%20regulativi/zakonski%20regulativi.html (vizita e fundit: 26 mars 2014).

41 Sipas:OSBE Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut. Republika e Maqedonisë, Zgjedhje Parlamentare 15 shtator 2002, Raport përfundimtar. Varshavë, 20 nëntor i vitit 2002. I aksesshëm në: http://www.osce.org/mk/odihr/elections/fyrom/15961?download=true (vizita e fundit: 24 mars 2014).

numrit të madh të rasteve të dhunës, kërcënimeve dhe zbatimit selektiv të procedurave ligjore ndaj kandidatëve të caktuar. Vetë procesi zgjedhor u vlerësua se u zhvillua mirë.

Mandatari i Qeverisë së re, pas 4 vitesh pauzë, përsëri ishte lideri i LSDM-së, Branko Crvenkovski, ndërkaq në të u përfshinë edhe PLD dhe BDI. E rëndësishme për këtë Qeveri është se BDI dhe lideri i saj Ali Ahmeti për herë të parë hynë në Qeveri e që nuk u prit edhe aq ngrohtë nga publiku në Maqedoni, i cili pjesëtarët e kësaj partie i perceptonte si iniciatorë të konfliktit të armatosur para një viti.

## ZGJEDHJET PARLAMENTARE TË VITIT 2006

Në këto zgjedhje, të cilat u mbajtën më 5 qershor të vitit 2006, u shënua jehonë më e ulët,[42] nga gjithsej 1.741.449 votues të regjistruar, në zgjedhje dolën vetëm 56%, ndërsa partitë përsëri i ndërruan rolet. Partia në pushtet LSDM kaloi në opozitë, ndërkaq opozita e deriatëhershme VMRO-DPMNE e fitoi shumicën në Parlament. Këto zgjedhje, sikurse se edhe ato paraprake, u zhvilluan sipas modelit zgjedhor proporcional në gjashtë njësi zgjedhore, ndërsa për pjesëmarrje në to u paraqitën 33 lista të kandidatëve, prej të cilave 31 nga partitë politike dhe koalicionet dhe 2 nga grup zgjedhësish. Koalicioni "Për Maqedoni më të mirë" i udhëhequr nga VMRO-DPMNE fitoi 45 mandate të deputetëve. Prej tyre 38 i takuan VMRO-DPMNE-së. Koalicioni i dytë sipas votave ishte "Bashkë për Maqedoninë" i udhëhequr nga LSDM me 32 mandate. Prej tyre, LSDM fitoi 23 deputetë. Koalicioni i tretë ishte BDI-PPD i cili fitoi 17 mandate të deputetëve. Prej tyre BDI-së i takuan 14 mandate. PDSH fitoi 11 mandate, Partia e Re Social-Demokrate (PRSD) - 7, VMRO-Partia Popullore (VMRO-PP) - 6, Rindërtimi Demokratik i Maqedonisë (RDM) - 1 dhe Partia për Ardhmëri Evropiane (PAE) - 1 mandat.

42 Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, Rezultatet zgjedhore të Zgjedhjeve Parlamentare 2006. Rezultate përmbledhëse përfundimtare nga votimi. Raportin e hartoi Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve, 25 qershor 2006. I aksesshëm në: http://sobranie.mk/WBStorage/Files/Rezultati-2006-5.pdf (vizita e fundit: 25 mars 2014).



Misioni monitorues i OSBE/ODIHR[43] konkludoi se zgjedhjet, në masë të madhe, janë zhvilluar në përputhje me angazhimet për zgjedhje demokratike, megjithatë në ditën e zgjedhjeve është vërejtur një numër i caktuar i parregullsive, ndërkaq në gjysmën e parë të fushatës parazgjedhore ka pasur raste të dhunës dhe frikësimit.

Pas këtyre zgjedhjeve, kryeministrit aktual, Nikola Gruevski iu besua mandati i parë për formimin e Qeverisë. Në përbërjen e saj u përfshinë përfaqësues të Koalicionit të udhëhequr nga VMRO-DPMNE, PDSH dhe PRSD. Qeverinë e mbështeti RDM dhe PAE, të cilët nuk fituan vende të ministrave. VMRO-PP votoi "pro" Qeverisë, por nuk hyri në Koalicionin Qeveritar. Karakteristikë e kësaj përbërje të Qeverisë është se ndonëse BDI fitoi më shumë vota dhe deputetë, VMRO-DPMNE për partner të vet e mori PDSH-në e Menduh Thaçit. Kjo rezultoi me krizë politike dhe me bllokada gjysmë-orëshe disaditore[44] në një pjesë të rrugëve magjistrale në Maqedoninë Veriperëndimore nga anëtarët dhe simpatizantët e BDI-së, e cila konsideronte se konform rezultateve zgjedhore është përfaqësues i vetëm legjitim i shumicës së shqiptarëve në Maqedoni dhe për këtë doemos duhet të jetë në Qeveri dhe se çdo gjë, që është në kundërshtim me këtë, është mosrespektim i vullnetit politik të shqiptarëve. Në mars të vitit 2008, PDSH[45] mori vendim ta braktisë Qeverinë.

## ZGJEDHJET PARLAMENTARE TË VITIT 2008

Dy vjet pas fitimit të pushtetit, partia në pushtet VMRO-DPMNE e pranoi nismën e BDI-së në Kuvend për shpërndarjen e parlamentit dhe për

43 Sipas:OSBE Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut. Republika e Maqedonisë, Zgjedhje Parlamentare 5 korrik 2006, Raport përfundimtar. Varshavë, 18 shtator 2006. I aksesshëm në: http://www.osce.org/mk/odihr/elections/fyrom/20630?download=true (vizita e fundit: 23 mars 2014).

44 Protesta të BDI, Dojçe Vele, servisi në gjuhën maqedonase, 7 gusht 2006. I aksesshëm në: http://www.dw.de/%D0%BF%D1%80%D0%BE%D1%82%D0%B5%D1%81%D1%82%D0%B8-%D0%BD%D0%B0-%D0%B4%D1%83%D0%B8/a-2535607 (vizita e fundit: 22 mars 2014).

45 PDSH doli nga Qeveria, Agjencia Informative Maqedonase, 13 mars 2008. I aksesshëm në: http://www.idividi.com.mk/vesti/makedonija/427732/index.htm (vizita e fundit: 22 mars 2014).

organizimin e zgjedhjeve të parakohshme[46] të cilat u mbajtën më 1 qershor. Partia e Ali Ahmetit konsideronte se duhet të mbahen zgjedhje të reja, në mënyrë që të korrigjohet gjendja paraprake në të cilën PDSH, partia me numër më të vogël të mandateve të fituara, i përfaqësonte shqiptarët në Qeveri. Njëkohësisht, në atë periudhë kohore vendi u përball me sfida të reja në integrimet euroatlantike për shkak të mospranimit të ftesës për anëtarësim në Aleancë[47] në Samitin e Bukureshtit,[48] për shkak të kontestit me Greqinë rreth emrit kushtetues të Maqedonisë. Këto janë zgjedhjet e para të parakohshme parlamentare në Maqedoninë e pavarur, të rëndësishme edhe për atë se zgjedhjet nuk rezultuan me ndërrimin e pushtetit, por VMRO-DPMNE i fuqizoi pozitat e veta. Zgjedhjet u zhvilluan sipas modelit proporcional, ndërsa në votim dolën 57,06% nga gjithsej 1.779.116 qytetarë të regjistruar me të drejtë vote. Në zgjedhjet, të cilat u mbajtën më 1 qershor, me kandidat të tyre në lista morën pjesë 41 parti dhe dy grupe zgjedhësish.

Koalicioni "Për Maqedoni më të mirë" i udhëhequr nga VMRO-DPMNE, nga gjithsej 120 deputetë të mundshëm fitoi 63 mandate[49] e që deri në atë kohë ishte numër rekord. Prej tyre 53 i takuan VMRO-DPMNE-së. Nga partitë e koalicionit, PSM-ja fitoi 3, ndërsa nga një deputet fituan: Lidhja Demokratike (LD), RDM, Partia Demokratike e Turqve në Maqedoni (PDTM), PDS, PBRM, VMRO-Maqedonase dhe Partia për Aksion Demokratik të Maqedonisë (PAD).

46 Sipas: Asociacionit Qytetar "Most", Raport përfundimtar nga monitorimi vendor i Zgjedhjeve të Parakohshme Parlamentare të 1 qershorit 2008. Shkup, shtator 2008. Konteksti politik, faqe 3. I aksesshëm në: http://www.most.org.mk/images/transparency/Parliamentary%20Elections%202008/parlamentarniIzbori2008.pdf (vizita e fundit: 26 mars 2014).

47 Dejection in Bucharest: Jilted Macedonia Walks out of NATO Summit, Spiegel. I aksesshëm në: http://www.spiegel.de/international/world/dejection-in-bucharest-jilted-macedonia-walks-out-of-nato-summit-a-545214.html (vizita e fundit: 22 mars 2014).

48 NATO pas Bukureshtit, NATO Public Diplomacy Division, http://www.nato.int/nato_static/assets/pdf/pdf_publications/20111017_nato_after_bucharest_mac.pdf (vizita e fundit: 20 mars 2014).

49 Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve, Zgjedhje të Parakohshme Parlamentare më 1 qershor 2008. Raport për rezultatet përfundimtare sipas modelit të D'Hontit. I aksesshëm në: http://www.sec.mk/arhiva/2008_predvremeniparlamentarni/index/2008-07-17-10-15-07.htm (vizita e fundit: 20 mars 2014).



Në vend të dytë ishte Koalicioni opozitar "Dielli – Koalicioni për Evropë" i udhëhequr nga LSDM me gjithsej 27 deputetë. Prej tyre 18 u përkisnin LSDM-së, që është numri më i vogël i deputetëve deri më atëherë. Vendet e tjera në Parlament i fituan anëtarët e Koalicionit: PLD – 4, PRSD – 3, ndërsa PL dhe Alternativa e Re (AR) fituan nga një mandat deputeti.

BDI fitoi 18 deputetë dhe pastaj bashkë me Koalicionin fitues formuan Qeverinë. PDSH fitoi 11 deputetë, ndërsa një mandat e fitoi edhe PAE.

Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve e anuloi votimin në 197 vende zgjedhore dhe organizoi rivotim. Misioni monitorues i OSBE/ODIHR[50] regjistroi se në zgjedhje nuk u realizua progresi i pritur për shkak se autoritetet kompetente nuk arritën t'i parandalojnë aktet e dhunës, kryesisht në mjediset me shumicë shqiptare. Mangësitë u shmangën gjatë rivotimit, me prezencë të përforcuar të policisë, me ç'rast qytetarët e realizuan të drejtën e tyre të votës në një atmosferë më të qetë.

Qeverinë përsëri e formoi Nikolla Gruevski, ndërsa në të, përveç ministrave të Koalicionit "Për Maqedoni më të mirë" u përfshinë edhe ministra të BDI-së.

## ZGJEDHJET PARLAMENTARE TË VITIT 2011

Zgjedhjet e parakohshme parlamentare të datës 5 qershor 2011 ishin zgjedhje të dyta të parakohshme për Kuvendin që nga pavarësimi i Maqedonisë dhe zgjedhje të dyta të këtilla të njëpasnjëshme. Atyre u parapriu një gjendje komplekse politike dhe një nga krizat më serioze politike në vend, që nga pavarësimi i shtetit.[51] Opozita e bojkotoi

50 Sipas:OSBE Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut. Republika e Maqedonisë, Zgjedhje të Parakohshme Parlamentare 1 qershor 2008, Raport përfundimtar. Varshavë, 20 gusht 2008. I aksesshëm në: http://www.osce.org/mk/odihr/elections/fyrom/33153?download=true (vizita e fundit: 23 mars 2014).

51 Sipas: Asociacionit Qytetar "Most", Raport përfundimtar nga monitorimi vendor i Zgjedhjeve të Parakohshme Parlamentare 5 qershor 2011. I aksesshëm në: http://www.most.org.mk/images/transparency/elections2011/Final_report_IZBORI_2011_MKD.pdf (vizita e fundit: 22 mars 2014).

Parlamentin, me përjashtim të PLD-së, për shkak të ngrirjes së llogarive bankare të televizionit dhe tri gazetave të biznesmenit Velija Ramkovski. Ai, në muajin dhjetor të vitit 2010, u arrestua dhe u mbajt në paraburgim me akuzën e pastrimit të parave, bashkimit kriminal, abuzimit të tatimit dhe shpërdorim të pozicionit, ndërsa në muajin mars të vitit 2012 u dënua me 13 vjet burgim. Opozita pohonte se burgimi i pronarit të televizionit A1 dhe mbyllja e gazetave: "Shpic", "Vreme" dhe "Koha" ndodh për shkak të faktit se këto media kanë raportuar në mënyrë kritike për Qeverinë dhe se është përpjekje për t'i heshtur ato. Për shkak të bllokimit të llogarive të mediave dhe me pohimin se në vend nuk ekziston dialogu politik, opozita, në krye me Branko Crvenkovski-n, në muajin janar të vitit 2011 e braktisi Parlamentin, ndërsa paraprakisht kërkoi edhe shpalljen e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare. Kryeministri, Nikolla Gruevski[52] në muajin mars e pranoi kërkesën, ndërsa opozita vendosi disa kushte dhe u kërcënua se nëse të njëjtat nuk përmbushen, do t'i bojkotojnë zgjedhjet. Kushtet, të cilat i parashtroi Crvenkovski ishin: debllokomi i llogarive të katër mediave, miratimi i Ligjit për ndarjen e barabartë të parave shtetërore për të gjitha mediat dhe pas realizimit të këtyre kushteve deputetët e LSDM-së do të ktheheshin në Parlament. Pastaj, diskutim mbi ndryshimet e Ligjit zgjedhor me konsensus dhe formimi i Komisionit të përbashkët parlamentar për kontrollin e listave të zgjedhësve. Më 21 mars, partia më e madhe opozitare[53] konstatoi se në përgjithësi kushtet të cilat i kishte parashtruar ishin përmbushur dhe vendosi të kthehej në Parlament.

Karakteristikë e këtyre zgjedhjeve është edhe ajo se u rrit numri i njësive zgjedhore nga 6 në 9. Me tri njësi të reja, njëra në Evropë dhe Afrikë, njëra për Amerikën Veriore dhe Jugore dhe njëra për Australi dhe Azi, me çka u përfshinë edhe votuesit e diasporës. Me këto ndryshime u rrit numri i vendeve në Parlament nga 120 në 123, përkatësisht nga një

[52] S.S.Z. Partitë bëjnë konsultime urgjente, "Nova Makedonija", 22 shkurt 2011. I aksesshëm në: http://www.novamakedonija.com.mk/NewsDetal.asp?vest=22211818202&id=9&setIzdanie=22213 (vizita e fundit: 26 mars 2014).

[53] Crvenkovski: Pas përmbushjes së 4 kushteve LSDM kthehet në Kuvend. LSDM, Shkup 21 mars 2011. Deklaratë e liderit të LSDM, Branko Crvenkovski, rreth përfundimit të krizës politike e cila çoi në zgjedhjet e vitit 2011. I aksesshëm në: http://sdsm.org.mk/default.aspx?mId=55&agId=5&articleId=5008
http://sdsm.org.mk/default.aspx?mId=55&agId=5&articleId=5008 (vizita e fundit: 26 mars 2014).

deputet nga secila nga njësitë e reja zgjedhore. Shtetasit maqedonas, të cilët jetojnë jashtë vendit, votuan në përfaqësitë diplomatike konsullore - PDK.[54] Jehona në këto zgjedhje ishte 63,39% nga gjithsej 1.821.122 votues të regjistruar, ndërsa për shkak të mundësimit të votimit për diasporën u bë një modifikim i vogël i modelit zgjedhor. Kështu, në 6 njësitë zgjedhore, në territorin e Maqedonisë kandidatët zgjidhen sipas modelit proporcional, ndërsa për tri njësitë e reja jashtë vendit u aplikua modeli mazhoritar. Në listat e zgjedhësve me kandidatë të tyre u paraqitën 53 parti politike.

Përsëri fitoi Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE. Koalicioni fitoi 56 mandate nga të cilat 47 i takuan VMRO-DPMNE-së. Nga partitë e Koalicionit: PSM fitoi - 3 deputetë, ndërsa LD, RDM, PAD, PDTM, PDS dhe VMRO-Maqedonase nga një deputet. Në vendin e dytë, sipas vendeve të fituara, ishte Koalicioni i udhëhequr nga LSDM-ja me gjithsej 42 mandate. Prej tyre 29 për LSDM, PRSD – 4, PAE – 3, ndërsa nga një deputet fituan: PL, Lëvizja për Unitet Nacional të Turqve në Maqedoni (LUNT), PEPR, Partia Përparimtare Serbe e Maqedonisë (PPSM) dhe dy deputetë të pavarur. Në vendin e tretë sipas numri të mandateve në Kuvend ishte edhe BDI me 14, vijonin PDSH – 8, RDK - 2 dhe Liga Demokratike e Boshnjakëve (LDB) me 1 deputet.

Vlerësim i përgjithshëm[55] ishte se zgjedhjet u zhvilluan në atmosferë të qetë dhe të ndershme. Pas zgjedhjeve, lideri i VMRO-DPMNE, Nikolla Gruevski, për herë të tretë e formoi Qeverinë në të cilën përsëri partner koalicioni, i cili i përfaqëson shqiptarët, ishte BDI e Ali Ahmetit.

[54] Kodi zgjedhor (tekst i spastruar) "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 54 nga 14 prilli i vitit 2011. I aksesshëm në: http://www.sec.mk/predvremeni2011/IZBOREN_ZAKONIK_(Precisten_tekst).pdf (vizita e fundit: 26 mars 2014).

[55] Sipas:OSBE Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut. Republika e Maqedonisë, Zgjedhje të Parakohshme Parlamentare 5 qershor 2011, Raport përfundimtar. Varshavë, 6 tetor 2011, gusht 2008. I aksesshëm në: http://www.osce.org/mk/node/84061?download=true (vizita e fundit: 26 mars 2014).

# SISTEMI ZGJEDHOR MAQEDONAS PËR ZGJEDHJET PARLAMENTARE

## SISTEMI ZGJEDHOR MAQEDONAS PËR ZGJEDHJET PARLAMENTARE

Në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë deputeti zgjidhet në zgjedhje të përgjithshme, të drejtpërdrejta dhe të lira, me votim të fshehtë për një mandat prej 4 vitesh. Me ndryshimet[56] e Kodit Zgjedhor[57] të vitit 2009 përveç në gjashtë njësitë zgjedhore në territorin e Republikës së Maqedonisë, votimi zhvillohet edhe në njësitë e formuara të reja zgjedhore jashtë vendit: njësia zgjedhore (NJZ) - 7 e cila ka të bëjë me Evropën dhe Afrikën, NJZ - 8 me Amerikën Veriore dhe Jugore dhe NJZ - 9 me Australinë dhe Azinë. Sipas kësaj, numri i deputetëve në Kuvend u rrit për tre dhe numëron 123 deputetë.

Secila nga gjashtë njësitë zgjedhore, në të cilat është ndarë territori i Maqedonisë zgjedh, nga 20 deputetë, sipas modelit zgjedhor proporcional. Tre deputetët nga diaspora zgjidhen sipas modelit mazhoritar. Në njësitë zgjedhore numri i zgjedhësve mund të lëvizë më së shumti nga minus 5% deri në plus 5%, sa i përket numrit mesatar të zgjedhësve në njësinë zgjedhore. Shpërndarja e mandateve bëhet sipas formulës së D'Hontit. Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve (KSHZ) i verifikon rezultatet veç e veç për secilën njësi zgjedhore, sipas numrit të votave të përgjithshme që i kanë fituar listat e kandidatëve veç e veç. Secila nga partitë fiton vende të deputetëve proporcionalisht me numrin e votave për listën e kandidatëve të tyre, krahasuar me numrin e votave të listave të tjera të kandidatëve. Nëse gjatë ndarjes së vendit të fundit për deputet paraqiten dy lista me rezultate identike, atëherë vendi fitohet me short. Gjatë shpërndarjes së vendeve të deputetëve konsiderohen të zgjedhur aq kandidatë sa vende ka fituar lista. Së këtejmi, mandate fitojnë kandidatët sipas radhitjes së përcaktuar në listat e kandidatëve.

[56] Manual për Zgjedhjet Presidenciale në Republikën e Maqedonisë të vitit 2014, Fondacioni Konrad Adenauer dhe Instituti për Demokraci "Societas Civilis"– Shkup, f. 15. I aksesshëm në: http://www.kas.de/wf/doc/kas_37241-1522-2-30.pdf?140327134356 (vizita e fundit: 27 mars 2014)

[57] Kodi Zgjedhor (tekst i spastruar), "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 32 nga 12 shkurti 2014. I aksesshëm në: http://www.sec.mk/files/IzborenzakonikzaWEB1.pdf (vizita e fundit: 27 mars 2014)

Zgjedhjet për deputetë mbahen çdo katër vjet brenda 90 ditëve të fundit të mandatit të legjislaturës paraprake të deputetëve ose brenda afatit prej 60 ditësh nga dita e shpërndarjes së Kuvendit. Në zgjedhjet e parakohshme të gjitha afatet e aktiviteteve zgjedhore shkurtohen për 5 ditë, përveç afatit të përcaktuar për zbatimin e fushatës zgjedhore.

Një deputeti mund t'i pushoj mandati para skadimit të kohës për të cilën është zgjedhur, nëse paraqet dorëheqje, nëse është dënuar për vepër penale për të cilën është caktuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej më së paku pesë vitesh, nëse paraqitet rast që nuk është në pajtim me funksionin deputet, në rast të vdekjes dhe nëse me aktvendim të plotfuqishëm i hiqet aftësia e punës. Nëse deputeti paraqet dorëheqje, Kuvendi në seancën e parë të radhës konstaton se deputetit i pushon mandati nga dita e mbajtjes së seancës.

Nëse deputetit të zgjedhur nga lista e kandidatëve i pushon mandati, sipas njërës nga këto baza, atëherë për pjesën tjetër të mandatit, në vend të tij vjen kandidati i radhës nga lista zgjedhore e partisë në të cilën është zgjedhur deputeti. Përjashtim nga ky rregull bëhet nëse mandati i pushon deputetes. Në rast të këtillë, në vendin e saj, do të vijë kandidatja e radhës nga lista.

Legjislatura e re e deputetëve në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë konstituohet në seancën e parë e cila mbahet në ditën e njëzetë e një nga përfundimi i zgjedhjeve në ora 10:00. Seancën e thërret kryeparlamentari në largim, ndërkaq nëse ai nuk e bën këtë, atëherë, seancën e thërret deputeti i zgjedhur më i madh në moshë, kështu deri te deputeti i zgjedhur i cili do të dakordohet që ta thërras seancën e parë, në të cilën konstituohet Kuvendi.[58] Në afat prej më së shumti dhjetë ditësh, pas konstituimit të legjislaturës së re të Kuvendit, Presidenti i Republikës së Maqedonisë e ka për detyrë që t'ia besoj mandatin[59] për përbërjen e re të Qeverisë, kandidatit (mandatorit) nga partia ose partitë të cilat e kanë shumicën e votave. Mandatori, në afat prej 20 ditësh, nga dita e besimit të mandatit, në Kuvend paraqet program dhe e propozon përbërjen e Qeverisë. Pastaj, deputetët me shumicë të votave, nga numri i përgjithshëm i deputetëve, e zgjedhin Qeverinë.

58 Rregullorja e Punës së Kuvendit të Republikës së Maqedonisë (tekst i spastruar) "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 54 nga 15 prill 2013. I aksesshëm në: http://www.sobranie.mk/delovnik-na-sobranieto-na-republika-makedonija-precisten-tekst.nspx (vizita e fundit: 3 prill 2014)

59 Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, 17 nëntor 1991. I aksesshëm në: http://sobranie.mk/ustav-na-rm.nspx (vizita e fundit: 3 prill 2014)

## ORGANET ZGJEDHORE

KSHZ-ja, bashkë me KKZ-të dhe KZ-të për votim brenda vendit dhe PDK-të e Republikës së Maqedonisë janë organet zgjedhore të ngarkuara për zbatimin e zgjedhjeve parlamentare. Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve përbëhet nga shtatë anëtarë, të cilët i zgjedh Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, me mandat prej katër vitesh. Anëtarët e KSHZ-së zgjidhen në afat prej 60 ditësh nga mbajtja e seancës konstituive të Kuvendit. Kryetari i KSHZ-së dhe dy anëtarë zgjidhen sipas propozimit të partive politike në opozitë, ndërsa nënkryetari dhe tre anëtarë të KSHZ-së zgjidhen sipas propozimit të partive politike në pushtet. KSHZ-ja ka në dispozicion shërbimin profesional, i cili i kryen punët profesionale-administrative dhe organizative-teknike.

KKZ-të formohen në nivel të çdo komune dhe ngarkohen për zbatimin e zgjedhjeve në territorin nën juridiksionin e tyre dhe bëjnë mbikëqyrje mbi punën e këshillave zgjedhorë. Ata përbëhen nga pesë anëtarë, nga të cilët njëri është kryetar, ndërkaq secili nga anëtarët ka edhe zëvendësin e tij. Anëtarët dhe zëvendësit e KKZ-ve zgjidhen nga radhët e të punësuarve në administratën shtetërore, publike dhe komunale, me arsim të lartë, për një mandat prej pesë vitesh. Zgjedhjen e tyre e bën KSHZ-ja.

Këshilli zgjedhor është një organ që formohet për çdo vend zgjedhor, përbëhet nga pesë anëtarë prej të cilëve njëri është kryetar, ndërsa për secilin prej tyre zgjidhet edhe zëvendës. Kryetari i këshillit zgjedhor dhe zëvendësi i tij, dy anëtarë dhe zëvendësit e tyre, zgjidhen nga radhët e të punësuarve në administratën shtetërore, publike dhe komunale, sipas zgjedhjes së rastësishme për një periudhë kohore prej katër vitesh. Një

anëtar të KZ-së dhe zëvendësi i tij delegohet me propozim të partive politike në opozitë, të cilat në zgjedhjet e fundit për deputetë kanë fituar më së shumti vota, ndërkaq një anëtar dhe zëvendësin e tij e propozojnë partitë politike në pushtet, të cilat në zgjedhjet e fundit për deputetë kanë fituar më së shumti vota. Zgjedhjen e rastësishme të anëtarëve të këshillave zgjedhorë (nga radhët e administratës) e bëjnë KKZ-të dhe Komisioni Zgjedhor i Qytetit të Shkupit për rajonin për të cilin janë kompetent, sipas aktit paraprak të KSHZ-së. Numri i vendeve zgjedhore në vend, për zgjedhjet e parakohshme parlamentare, është 3 480, përkatësisht ka 504 vende zgjedhore më shumë, krahasuar me zgjedhjet paraprake. Në një vend zgjedhor nuk mund të votojnë më shumë se 1000 qytetarë. Për votimin jashtë vendit janë parashikuar 47 vende zgjedhore në PDK-të, megjithatë zgjedhjet do të organizohen vetëm në ato PDK në të cilat janë paraqitur më së paku 10 zgjedhës.

## E DREJTA PËR T'U ZGJEDHUR

Të drejtë për t'u kandiduar për deputet kanë të gjithë qytetarët e moshës madhore të shtetit, përveç atyre që janë të dënuar me vendim të plotfuqishëm gjyqësor, me dënim të pakushtëzuar me burgim mbi gjashtë muaj, vuajtja e të cilëve akoma nuk ka filluar dhe ata të cilët e vuajnë dënimin me burgim për vepër të kryer penale. Me Ligjin për përcaktimin e kushtit për kufizimin e ushtrimit të funksionit publik, qasjes në dokumente dhe publikimin e bashkëpunimit me organet e sigurisë shtetërore[60] (pastaj Ligjin për lustrim), nga muaji korrik 2012, ekziston edhe kushti plotësues për kandidatët për deputetë në Kuvend. Sipas tij, deputet nuk mund të bëhet kandidati i cili ka qenë bashkëpunëtor i fshehtë, lidhje operative ose informator i fshehtë gjatë mbledhjes operative njoftimeve dhe të dhënave në periudhën nga dy gushti 1944 deri në ditën e fillimit të zbatimit të Ligjit për qasje të lirë deri te informatat me karakter publikë, siç është përcaktuar me Ligjin për lustrim.

60 Ligji për përcaktimin e kushtit për kufizimin e ushtrimit të funksionit publik, qasjes në dokumente dhe publikimit të bashkëpunimit me organet e sigurisë shtetërore, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 86, nga 9 korrik 2012. I aksesshëm në: http://www.kvf.org.mk/docs/Zakon_09072012.pdf (vizita e fundit: 27 mars 2014)



Kandidatët për deputetë do të mund ta ushtrojnë funksionin, pasi që Komisioni për Verifikimin e Fakteve, i njohur edhe si "Komisioni për lustrim", do t'i konfirmojë deklaratat e tyre me shkrim se nuk kanë bashkëpunuar me organet e sigurisë shtetërore.

## E DREJTA DHE PROCEDURA PËR PARAQITJEN E KANDIDATURAVE[61]

Propozimi i kandidatëve për zgjedhje të deputetëve bëhet përmes paraqitjes së listës së kandidatëve në Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve, së këtejmi, një kandidat mund të propozohet vetëm në një listë, ndërkaq një paraqitës i listës mund të paraqes vetëm një listë të kandidatëve për deputetë. Lista paraqitet në gjuhën maqedonase dhe alfabetin cirilik, si gjuhë zyrtare në Republikën e Maqedonisë, mirëpo paraqitësi i listave në njësitë zgjedhore në të cilat më së paku 20% e qytetarëve flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase këtë mund ta bëjë edhe në gjuhën dhe alfabetin që e përdorin qytetarët në atë njësi të vetëqeverisjes lokale.

Të drejtë për të paraqitur listë të kandidatëve për deputetë kanë partitë e regjistruara politike në mënyrë të pavarur, koalicionet dhe grup zgjedhësish me nënshkrime të mbledhura. Grupi i zgjedhësve, që të mund të paraqes listë të kandidatëve duhet të mbledh më së paku 1.000 nënshkrime nga zgjedhësit e regjistruar në ekstraktin e Listës së Zgjedhësve të njësisë zgjedhore. Mbledhja e nënshkrimeve para KSHZ-së fillon në ditën e pesëmbëdhjetë nga dita e shpalljes së zgjedhjeve dhe zgjat 15 ditë. Procedura e njëjtë parashikohet edhe në rastin kur paraqitës i listës është grup zgjedhësish nga njësitë zgjedhore jashtë vendit. Ata duhet të mbledhin më së paku 1.000 nënshkrime nga zgjedhësit e regjistruar në ato njësi zgjedhore, para personave zyrtarët të PDK-ve, përkatësisht zyrave konsullore në formular të përcaktuar nga Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve.

61 Kodi Zgjedhor (tekst i spastruar) "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 32 nga 12 shkurt 2014. I aksesshëm në: http://www.sec.mk/files/IzborenzakonikzaWEB1.pdf (vizita e fundit: 27 mars 2014)

Në rastin kur paraqitës i listës së kandidatit, përkatësisht kandidatëve është parti politike, doemos duhet ta paraqes vërtetimin për regjistrim nga gjykata kompetente. Kur paraqitësi i listës së kandidatëve është koalicioni, duhet ta paraqes marrëveshjen e koalicionimit ndërmjet partive. Kur paraqitës i listës është grup zgjedhësish, doemos duhet të paraqiten edhe nënshkrimet e mbledhura nga zgjedhësit. Për çdo kandidaturë nevojitet pëlqim me shkrim (deklaratë) e kandidatit që është i parevokueshëm. Listat e kandidatëve paraqiten në komisionin zgjedhor kompetent, më së voni 30 ditë, para ditës së mbajtjes së zgjedhjeve. KSHZ-ja, përkatësisht KKZ-të, pastaj konstatojnë nëse listat janë paraqitur në afatin ligjor dhe sipas kushteve të parashikuara me ligj. Nëse konstatohen parregullsi, KSHZ-ja, përkatësisht KKZ-ja do ta thërras përfaqësuesin e autorizuar të paraqitësit të listës, përkatësisht personin e parë të nënshkruar në listën e kandidatëve, që t'i shmangin parregullsitë në afat prej 48 orësh nga pranimi i listave. Nëse më pas, konstatohet se listat janë paraqitur në përputhje me dispozitat ligjore dhe se parregullsitë e konstatuara eventuale janë shmangur brenda afatit të caktuar, atëherë lista e paraqitur verifikohet me aktvendim. Nëse konstatohet se listat nuk janë paraqitur në kohë, përkatësisht parregullsitë ose mangësitë e konstatuara, paraqitësit e listave nuk i kanë shmangur në afat prej 48 orësh, atëherë do të miratohet aktvendim për hedhjen poshtë të listës. Paraqitësi i listës, kundër aktvendimit mund të paraqes padi në Gjykatën Administrative, në afat prej 24 orësh pas pranimit të aktvendimit, ndërkaq Gjykata në afat prej 24 orësh pas pranimit të padisë duhet të vendos për të njëjtën. Paraqitja përmes postës e kundërshtimit dhe padisë për listat në NJZ në Evropë dhe Afrikë, Amerikën Veriore dhe Jugore dhe Australi dhe Azi, nuk lejohet, por kjo bëhet përmes përfaqësuesit të autorizuar të kandidatëve për ato NJZ në Republikën e Maqedonisë. KSHZ-ja listat, e verifikuara të kandidatëve për deputetë në njësitë zgjedhore, i shpall në shtypin ditor prej të cilëve njëri është në gjuhën e bashkësisë të cilën e flasin më së paku 20% e qytetarëve në Republikën e Maqedonisë, më së voni 23 ditë para ditës së përcaktuar për mbajtjen e zgjedhjeve. Listat, përmes Ministrisë së Punëve të Jashtme, në afat prej 48 orësh, duhet të dërgohen në PDK-të për shkak të publikimit të tyre.

## KUFIZIMI I FUNKSIONARËVE AKTUAL

Me ndryshimet e Kodit Zgjedhor në vitin 2014, funksioni deputet nuk është në pajtim me funksionin President i Republikës, Kryetar i Qeverisë së Republikës të Maqedonisë, ministër, gjyqtar, prokuror publik, Avokat i Shtetit, Avokat i Popullit dhe me bartës të tjerë të funksioneve të cilët i zgjedh ose emëron Kuvendi dhe as me funksionet kryetar komune ose anëtar i Këshillit të vetëqeverisjes lokale. Kjo do të thotë se nëse anëtarë të Qeverisë dhe zëvendësministra si edhe funksionarë të tjerë kandidohen për deputetë, ata nga dita e miratimit të vendimit për shpalljen e zgjedhjeve deri në përfundimin e zgjedhjeve, nuk guxojnë:

- të vënë në dispozicion mjete buxhetore të Republikës së Maqedonisë, mjete të buxheteve të komunave dhe Qytetit të Shkupit, fondeve publike, ndërmarrjeve publike, institucioneve publike ose personave juridikë të cilët kanë në dispozicion kapital shtetëror, përveç nëse kjo ndryshe nuk është përcaktuar me ligj, me të cilin rregullohet financimi i fushatave zgjedhore të partive politike;
- të fillojnë ndërtime, me mjete të buxhetit, fondeve publike, ndërmarrjeve publike dhe personave të tjerë juridikë të cilët kanë në dispozicion kapital shtetëror, të objekteve të reja në infrastrukturë, siç janë: rrugë, ujësjellës, linja të tensionit të lartë, kanalizime, fusha sporti dhe objekte të tjera ose objekte për veprimtari shoqërore-shkolla, kopshte dhe objekte të tjera, përveç nëse për këtë dedikim paraprakisht janë siguruar mjete nga buxheti, përkatësisht bëhet fjalë për realizim të programit të miratuar në bazë të ligjit në vitin rrjedhës;
- të realizohen pagesa të jashtëzakonshme të pagave, pensioneve, asistencave sociale; ose
- të realizohen pagesa të tjera me mjete buxhetore, mjete të fondeve publike;
- të tjetërsohet kapitali shtetëror;
- të nënshkruhen marrëveshje kolektive.

Nëse ndonjë ministër ose zëvendësministër i shkelë këto rregulla atëherë do t'i shqiptohet gjobë në shumë prej 500 deri më 1000 euro në kundërvlerë me denarë.

Nëse dikush nga kandidatët për deputet është pjesëtar i forcave të armatosura të Republikës së Maqedonisë, i pjesës së uniformuar të policisë, personave të autorizuar zyrtarë të Ministrisë së Punëve të Brendshme, Ministrisë së Mbrojtjes ose Agjencisë për Zbulim, nga dita kur do të verifikohet kandidatura e tij, marrëdhënia e punës përkohësisht do t'i pezullohet.

Në mënyrë plotësuese, në periudhën kohore prej 20 ditësh para fillimit të fushatës zgjedhore deri në përfundimin e zgjedhjes së deputetëve dhe zgjedhjes së Qeverisë nuk mund të paguhen subvencione të cilat nuk janë pagesa të rregullta mujore, të mbahen ngjarje publike me rastin e fillimit të ndërtimit ose lëshimit në përdorim të objekteve me mjete nga Buxheti ose nga fondet publike, ose me mjete të ndërmarrjeve publike ose të personave të tjerë juridikë që kanë në dispozicion kapital shtetëror, në pjesën e infrastrukturës siç janë: rrugë, ujësjellës, linja të tensionit të lartë, kanalizime, fusha sporti dhe objekte të tjera ose objekte për veprimtari shoqërore-shkolla, kopshte dhe objekte të tjera. Nga dita e miratimit të vendimit për shpalljen e zgjedhjeve deri në përfundimin e zgjedhjeve dhe zgjedhjes së Qeverisë, Ministria e inancave e ka për detyrë të gjitha pagesat buxhetore, përveç pagave të rregullta, pensioneve dhe shpenzimeve komunale t'i publikojë në ueb faqen e saj, në një bazë të veçantë për shpenzimet buxhetore gjatë periudhës zgjedhore. Ministria e ka për detyrë, dy javë pas shpalljes së zgjedhjeve, të paraqes raport parazgjedhor financiar në të cilin do të përfshihet pasqyra e të gjitha të ardhurave dhe shpenzimeve të planifikuara dhe të realizuara nga Buxheti sipas zërave, në periudhën nga fillimi i vitit fiskal deri në ditën e paraqitjes së raportit, i cili publikohet në ueb faqen e saj.

## FUSHATA ZGJEDHORE[62]

Fushata zgjedhore e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare fillon 20 ditë para ditës së zgjedhjeve ndërkaq, në rrethin e parë dhe të dytë të zgjedhjeve, 24 orë para ditës së zgjedhjeve dhe në ditën e zgjedhjeve, nuk guxon të zhvillohet fushatë. Për shkak të mbivendosjes me rrethin e parë të zgjedhjeve presidenciale, fushata për zgjedhjet parlamentare do të fillojë dy ditë më herët. Përkatësisht, do të fillojë më 5 prill[63] dhe do të zgjas deri më 25 prill, por për shkak të heshtjes zgjedhore dhe votimit në rrethin e parë të zgjedhjeve presidenciale fushata do të pezullohet më 12 dhe 13 prill.

Organizatorët e fushatës zgjedhore, më së voni 48 orë pas verifikimit të listave të kandidatëve, duhet të hapin llogari të veçantë bankare dhe vetëm përmes saj mund të financohet fushata dhe nuk mund të shfrytëzohet për dedikime të tjera. Së këtejmi, fushata mund të financohet edhe nga pagesa e anëtarësisë së partive politike dhe nga donacionet të cilat nuk mund të jenë më të larta se 5.000 euro për persona fizikë dhe 50.000 euro për persona juridikë. Fushata mund të financohet me para, sende dhe shërbime, vlera e të cilave nuk guxon t'i tejkalojë këto shuma. Nëse lartësia e donacionit është më e madhe nga shuma e lejuar, pjesëmarrësi në fushatën zgjedhore e ka për detyrë që, në afat prej pesë ditësh nga dita e pranimit të donacionit, dallimin ndërmjet vlerës së lejuar dhe të donuar ta bartë në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë.

Fushatat zgjedhore nuk mund të financohen me mjete nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë, buxhetet e komunave dhe Qytetit të Shkupit, përveç me mjete të kompensimeve të shpenzimeve për zgjedhje të cilat i posedojnë organizatorët e fushatës zgjedhore. Nuk mund të financohen as

[62] Manual për Zgjedhjet Presidenciale në Republikën e Maqedonisë të vitit 2014, Fondacioni Konrad Adenauer dhe Instituti për Demokraci "Societas Civilis"– Shkup, f. 38. I akseshëm në: http://www.kas.de/wf/doc/kas_37241-1522-2-30.pdf?140327134356 (vizita e fundit: 27 mars 2014)

[63] Kalendari i afateve për realizimin e aktiviteteve zgjedhore për zbatimin e zgjedhjeve të parakohshme për deputetë në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë 6 mars – 27 prill 2014. Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve i Republikës së Maqedonisë, 7 mars 2014. I aksesshëm në: http://www.sec.mk/files/izbori2014/parlamentarni/rokovnik.pdf (vizita e fundit: 27 mars 2014)

nga mjetet e ndërmarrjeve dhe institucioneve publike, nga mjetet e shoqatave të qytetarëve, komuniteteve fetare, grupeve religjioze dhe fondacioneve, mjetet e qeverive të huaja dhe institucioneve ndërkombëtare, si dhe nga mjetet e ndërmarrjeve me kapital të përbashkët ku kapitali i huaj është dominant, por edhe nga burime të paidentifikuara. Në rast se kandidatura nuk realizohet, organizatorët e fushatës zgjedhore e kanë për detyrë që donacionet e pashpenzuara, në afat prej 60 ditësh, tua kthejnë donatorëve.

Pjesëmarrësi në fushatën zgjedhore e ka për detyrë menjëherë dhe më së voni në afat prej 30 ditësh, nga dita e përfundimit të fushatës zgjedhore, të paraqes raport financiar për mjetet e mbledhura dhe të shpenzuara gjatë fushatës. Kandidatët e zgjedhur për deputetë, ose të gjithë ata që kanë fituar më së paku 1,5% të votave të qytetarëve, që kanë dalë në zgjedhje në njësinë zgjedhore, kanë të drejtë për kompensim nga Buxheti i shtetit në lartësi prej 15 denarësh për një votë të fituar. Këto mjete paguhen më së voni tre muaj pas paraqitjes së raportit financiar për fushatën.

Nëse gjatë paraqitjeve ose raportimeve publike shkelen të drejtat e ndonjërit nga kandidatët, të njëjtit kanë të drejtë menjëherë të ngrenë procedurë gjyqësore për mbrojtjen e të drejtave të tyre. Për padi të këtillë, gjykata themelore kompetente vendos në afate urgjente, ndërsa vendimi publikohet në mjetet e informimit publik.

Radiodifuzerët dhe mediat e shkruara në Republikën e Maqedonisë e kanë për detyrë të paraqesin raport për hapësirën reklamuese të shfrytëzuar nga secili pjesëmarrës në fushatën zgjedhore dhe për mjetet e paguara apo të pa arkëtuara mbi këtë bazë.



## ROLI I MJETEVE TË INFORMIMIT PUBLIK[64]

Gjatë fushatës, mediat private dhe servisi publik radiodifuziv e kanë për detyrë të mundësojnë qasje të barabartë për prezantimin e programeve zgjedhore dhe prezantimin e kandidatëve në mënyrë të drejtë, të paanshme dhe të balancuar. Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive,[65] në të cilën me Ligjin e ri për shërbime mediatike audio dhe audiovizive u transformua Këshilli i deriatëhershëm për Radiodifuzion, detyrimisht duhet ta monitorojë prezantimin zgjedhor të partive dhe kandidatëve në mediat radiodifuzive, nga dita e shpalljes së zgjedhjeve deri në përfundimin e votimit në ditën e mbajtjes së zgjedhjeve. Agjencia, në rast të shkeljes së parimit të qasjes së barabartë, e ka për detyrë të ngre procedurë për kundërvajtje kundër medias përkatëse.

Me ndryshimet e fundit të Kodit Zgjedhor[66] redaktorët, gazetarët, moderatorët e programeve dhe prezantuesit e angazhuar në përgatitjen e programeve të radiodifuzerëve nuk guxojnë të marrin pjesë në aktivitete parazgjedhore të partive politike, koalicioneve dhe grupit të zgjedhësve dhe të jenë përfaqësues të tyre, përkatësisht të marrin pjesë në fushatën zgjedhore. Nëse vendosin që të marrin pjesë në aktivitete të këtilla, angazhimi i tyre në programet e radiodifuzerëve do t'u pezullohet nga dita e shpalljes deri në përfundimin e zgjedhjeve.

Servisi publik radiodifuziv e ka për detyrë pa kompensim t'i informojë qytetarët për mënyrën dhe teknikat e votimit, si dhe për çështje të tjera

[64] Manual për Zgjedhjet Presidenciale në Republikën e Maqedonisë të vitit 2014, Fondacioni Konrad Adenauer dhe Instituti për Demokraci "Societas Civilis"– Shkup, f. 39. I aksesshëm në: http://www.kas.de/wf/doc/kas_37241-1522-2-30.pdf?140327134356 (vizita e fundit: 3 prill 2014)

[65] Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizive, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr 184 nga 26 dhjetor 2013. I aksesshëm në: http://www.avmu.mk/images/Zakon_za_audio_i_audiovizuelni_mediumski_uslugi_mkd_1.pdf (vizita e fundit: 27 mars 2014).

[66] ZH. A. U votuan ndryshimet e Kodit Zgjedhor, "Dojçe Vele", programi në gjuhën maqedonase, 23 janar 2014. I aksesshëm në: http://www.dw.de/%D0%B8%D0%B7%D0%B3%D0%BB%D0%B0%D1%81%D0%B0%D0%BD%D0%B8-%D0%B8%D0%B7%D0%BC%D0%B5%D0%BD%D0%B8%D1%82%D0%B5-%D0%B2%D0%BE-%D0%B8%D0%B7%D0%B1%D0%BE%D1%80%D0%BD%D0%B8%D0%BE%D1%82-%D0%B7%D0%B0%D0%BA%D0%BE%D0%BD%D0%B8%D0%BA/a-17383099 (vizita e fundit: 27 mars 2014).

që kanë të bëjnë me procesin zgjedhor. Radiotelevizioni i Maqedonisë (RTVM)[67] duhet të sigurojë qasje të barabartë në programin informativ. Kjo nënkupton se një e treta e programit duhet t'u dedikohet ngjarjeve nga vendi, një e treta ngjarjeve të Qeverisë dhe një e treta ngjarjeve të opozitës. Kanali i Kuvendit duhet të sigurojë reklamim falas nga tri orë për opozitën dhe për partitë në pushtet.

Ndalohet reklamimi i paguar politik nga dita e shpalljes së zgjedhjeve deri në fillimin e fushatës zgjedhore. Nga po ajo ditë ndalohet edhe publikimi i reklamave të financuara nga Buxheti i shtetit dhe buxhetet komunale. Brenda periudhës së njëjtë radiodifuzerët e kanë për detyrë ta regjistrojnë programin e tyre, ndërsa regjistrimet t'i ruajnë më së paku 30 ditë pas përfundimit të zgjedhjeve. Mediat, doemos duhet të përcaktojnë listë të çmimeve për reklamimin politik dhe t'i publikojnë, ndërsa të njëjtat nuk guxojnë të ndryshohen gjatë fushatës. Radiodifuzerët, të cilët i mbulojnë zgjedhjet, mund të transmetojnë 12 minuta kohë shtesë për reklamim për orë reale të programit të transmetuar, ekskluzivisht të dedikuara për reklamim të paguar politik, prej të cilave për një pjesëmarrës në fushatën zgjedhore më së shumti mund të ndajnë 8 minuta. Rezultatet, nga sondazhi i opinionit publik në lidhje me kandidatët, nuk guxon të publikohen përmes mjeteve të informimit publik gjatë 5 ditëve të fundit para ditës së përcaktuar për mbajtjen e zgjedhjeve.

## MONITORIMI I ZGJEDHJEVE

Të drejtë monitorimi të zgjedhjeve kanë vëzhguesit e akredituar, me ç'rast KSHZ-ja e lëshon autorizimin. Akreditim për vëzhgues mund të marrin organizatat civile vendase të cilat janë të regjistruara së paku një vit para mbajtjes së zgjedhjeve, ndërsa në statutin e tyre e kanë inkorporuar parimin për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Organizatat ndërkombëtare dhe përfaqësuesit e vendeve të huaja gjithashtu mund t'i monitorojnë zgjedhjet. Përfaqësuesit e autorizuar të paraqitësve të listave kanë të drejtë të përcaktojnë përfaqësuesin e tyre i cili do ta vëzhgojë punën e organeve zgjedhore.

[67] Kodi Zgjedhor (tekst i spastruar) "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 32 nga 12 shkurt 2014. I aksesshëm në: http://www.sec.mk/files/IzborenzakonikzaWEB1.pdf (vizita e fundit: 27 mars 2014).

# NJËSI ZGJEDHORE

## NJËSI ZGJEDHORE (NJZ)[68]




**Njësitë zgjedhore**
**Burimi: Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve**

Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare të datës 27 prill 2014 në Republikën e Maqedonisë do të mbahen në 9 njësi zgjedhore (NJZ).[69] Territori i shtetit është ndarë në 6 NJZ, ndërsa tri NJZ-të e tjera janë jashtë vendit. Gjashtë NJZ-të në Maqedoni u krijuan para zgjedhjeve parlamentare të vitit 2002 me Ligjin për njësi zgjedhore[70] dhe me të njëjtat territori i shtetit u nda në

[68] Për numrin e mandateve të fituara dhe për votuesit e regjistruar sipas NJZ-ve në zgjedhjet e parakohshme parlamentare më 5 qershor të vitit 2011, u shfrytëzuan rezultatet përfundimtare zyrtare të Komisionit Shtetëror të Zgjedhje të Republikës së Maqedonisë të publikuara më 14 qershor 2011. I aksesshëm në: http://217.16.84.11/Default.aspx (vizita e fundit: 4 prill 2014).

[69] Pasqyra grafike, e njësive zgjedhore në Maqedoni dhe jashtë vendit, është marrë nga internet faqja e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve të Republikës së Maqedonisë (KSHZ). I aksesshëm në: http://217.16.84.11/Default.aspx (vizita e fundit: 2 prill 2014).

[70] Ligji për njësitë zgjedhore për zgjedhjen e deputetëve në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 43 nga 26 qershor 2002. I akseshëm në: http://www.slvesnik.com.mk/Issues/D8BCA0533D35554CA3F003112BB-47F1B.pdf (vizita e fundit: 2 prill 2011).

rajone zgjedhore me numër përafërsisht të njëjtë të votuesve të regjistruar, ose mesatarisht rreth 280 mijë në secilën prej tyre. Numri i zgjedhësve në NJZ-të mund të lëvizë nga minus 5 deri në plus 5 në raport me numrin mesatar të zgjedhësve. Në secilën prej këtyre 6 NJZ zgjidhen nga 20 deputetë në Kuvend, përkatësisht, në total 120 deputetë nga gjithsej 123 deputetë, sipas modelit zgjedhor proporcional. Njësia zgjedhore 7 për Evropë dhe Afrikë, NJZ 8 për Amerikën Veriore dhe jugore dhe NJZ 9 për Australi dhe Azi u shtuan me ndryshimet e Kodit Zgjedhor[71] para Zgjedhjeve të Parakohshme Parlamentare të vitit 2011, me çka u mundësua të votojnë edhe shtetasit e Maqedonisë, të cilët gjenden jashtë shtetit. Ata, votojnë në përfaqësitë diplomatike-konsullore (PDK) dhe në zyrat konsullore të Republikës së Maqedonisë. Prej këtyre NJZ-ve gjithsej zgjidhen 3 deputetë sipas modelit zgjedhor mazhoritar.[72] Numri i vendeve zgjedhore në vend, për këto zgjedhje të parakohshme parlamentare është, 3 480, përkatësisht ka 504 vende zgjedhore më shumë, në krahasim me zgjedhjet paraprake. Në një vend zgjedhor nuk mund të votojnë më shumë se 1000 qytetarë.

[71] Kodi Zgjedhor (tekst i spastruar), "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 52 nga 14 prill 2011. I aksesshëm në: http://www.sec.mk/predvremeni2011/IZBOREN_ZAKONIK_(Precisten_tekst).pdf (vizita e fundit: 2 prill 2014).

[72] Për më shumë informacione, shih Kapitullin 3 – Sistemi zgjedhor maqedonas për zgjedhjet e parakohshme parlamentare.



NJZ 1 përfshin një pjesë të Qytetit të Shkupit dhe një pjesë të Maqedonisë Qendrore, përkatësisht komunat e Shkupit: Aerodrom, Qendër, një pjesë të Komunës Çair, Saraj, Sopishtë, Makedonski Brod dhe Studeniçan. Sipas përkatësisë etnike të popullatës, pjesa më e madhe e votuesve janë maqedonas etnikë. Në këtë NJZ, në Zgjedhjet e fundit Parlamentare të vitit 2011 u regjistruan 302.864 votues. Në ato zgjedhje më së shumti mandate fitoi Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE- 9, Koalicioni i LSDM-së – 8, BDI – 2, ndërsa PDSH – 1 mandat.



**Pasqyra grafike e NJZ 1**

NJZ 2 gjithashtu, përfshin një pjesë të Qytetit të Shkupit dhe një pjesë të Maqedonisë Veriore, me përbërje të balancuar të popullatës, maqedonas etnikë, shqiptarë etnikë, ndërkaq janë të pranishëm edhe serbët dhe romët. Në këtë NJZ bëjnë pjesë komunat e Shkupit: Butel, Gazi Babë, Gjorçe Petrov, një pjesë e Komunës Çair, Shuto Orizarë, Haraçina, një pjesë e Kumanovës, Likova, një pjesë e Nagoriçanit të Vjetër dhe Çuçer Sandev. Në Zgjedhjet e fundit Parlamentare të vitit 2011, në NJZ 2 u regjistruan 312.720 votues. Më së shumti mandate në Zgjedhjet Parlamentare të vitit 2011 në këtë NJZ fitoi Koalicioni i VMRO-DPMNE – 9, i dyti ishte Koalicioni i LSDM-së me 7 mandate, pastaj BDI me 3 dhe PDSH me 1 mandat.



**Pasqyra grafike NJZ 2**

NJZ 3 përfshin pjesë të Maqedonisë Qendrore, Lindore dhe Veriore. Kjo NJZ, mes tjerash, i përfshin edhe komunat më të mëdha si: Berova, Velesi, Vinica, një pjesë të Nagoriçanit të Vjetër, Gradsko, Delçevë, Koçan, Kratovë, Kriva Pallankë, një pjesë të Kumanovës, Makedonska Kamenica, Probishtip, Shtip dhe Sveti Nikolë. Dominon popullata e bashkësisë etnike maqedonase. Në Zgjedhjet e fundit Parlamentare të mbajtura në vitin 2011, në NJZ 3 u regjistruar 291.140 votues. Në Zgjedhjet Parlamentare të vitit 2011, më së shumti mandate fitoi Koalicioni i VMRO-DPMNE – 12, ndërsa i dyti ishte Koalicioni i LSDM-së me 8 mandate.



**Pasqyra grafike e NJZ 3**

NJZ 4  e përfshin territorin e Maqedonisë Juglindore. Në këtë NJZ nga komunat më të mëdha përfshihet një pjesë e Qytetit të Manastirit, Prilepi, Bogdanci, Valandova, Gjevgjelia, Dojrani, Demir Kapia, Kavadari, Negotina, Radovishi dhe Strumica. Në këtë pjesë dominon popullata e bashkësisë etnike maqedonase. Në Zgjedhjet e fundit Parlamentare të vitit 2011 në NJZ 4 u regjistruan 292.596 votues. Në Zgjedhjet Parlamentare të vitit 2011 më së shumti mandate fitoi Koalicioni i VMRO-DPMNE-së – 11, ndërsa i dyti ishte Koalicioni i LSDM-së me 9 mandate.



**Pasqyra grafike e NJZ 4**

NJZ 5 e përfshinë territorin e Maqedonisë Jugperëndimore. Në këtë NJZ nga komunat më të mëdha janë: një pjesë e Qytetit të Manastirit, një pjesë e Dibrës, Vevçani, Ohri, Struga, Krusheva, Kërçova dhe Resnja. Pjesa më e madhe e popullatës është e bashkësisë etnike maqedonase, por në numër të konsiderueshëm janë edhe votuesit e bashkësisë etnike shqiptare. Në Zgjedhjet e fundit Parlamentare të vitit 2011 në NJZ 5 u regjistruan 303.868 votues. Në Zgjedhjet Parlamentare të vitit 2011 më së shumti mandate fitoi Koalicioni i VMRO-DPMNE – 9, i dyti ishte Koalicioni i LSDM-së me 8, pastaj BDI me 2 dhe PDSH me 1 mandat.



**Pasqyra grafike NJZ 5**

NJZ 6 e përfshin territorin e Maqedonisë Veriperëndimore. Në këtë NJZ nga komunat më të mëdha janë: një pjesë e Dibrës, Gostivari, Tetova, Zajazi, Mavrova e Rostusha dhe Zhelina. Në këtë pjesë dominon popullata e bashkësisë etnike shqiptare. Në Zgjedhjet e fundit Parlamentare të vitit 2011 në NJZ 6 u regjistruar 318.116 votues. Në Zgjedhjet Parlamentare të vitit 2011, më së shumti mandate në këtë NJZ fitoi BDI – 8, në vend të dytë ishte PDSH me 5 mandate, pastaj Koalicioni i VMRO-DPMNE-së me 3, pastaj Koalicioni i LSDM-së dhe RDK-ja me nga 2 mandate.



**Pasqyra grafike NJZ 6**

NJZ 7 i përfshin shtetasit e Maqedonisë të cilët jetojnë ose janë me qëndrim të përkohshëm në shtetet e Evropës dhe Afrikës. Në Zgjedhjet e fundit Parlamentare të vitit 2011 u regjistruan 4591 votues, të cilët kishin mundësi të votojnë në 29 vende zgjedhore në PDK-të ose në zyrat konsullore të Republikës së Maqedonisë. Votimi në këtë NJZ u zhvillua në qytetet: Vjenë, Berlin, Hagë, Bern, Bruksel, Bon, Bukuresht, Ankara, Sarajevë, Munih, Moskë, Stamboll, Sofje, Athinë, Beograd, Londër, Zagreb. Budapest, Lubjanë, Podgoricë, Kopenhagë, Romë, Madrid, Prag, Paris, Venecia, Stokholm dhe Prishtinë. Mandatin në këtë NJZ e fitoi Koalicioni i VMRO-DPMNE-së, ndërsa në zgjedhje votuan gjithsej 2494 votues.



**Pasqyra grafike e NJZ 7**

NJZ 8 i përfshin shtetasit e Maqedonisë të cilët jetojnë ose janë me qëndrim të përkohshëm në shtetet e Amerikës Veriore dhe Jugore. Në Zgjedhjet e fundit Parlamentare të vitit 2011 u regjistruan 1824 votues të cilët kishin mundësi të votojnë në 24 vende zgjedhore në PDK-të ose në zyrat konsullore të Republikës së Maqedonisë. Votimi u zhvillua në qytetet: Toronto, Detroit, Çikago, Nju Jork dhe Uashington. Në zgjedhje dolën gjithsej 994 votues, ndërsa mandatin e fitoi Koalicioni i VMRO-DPMNE-së



**Pasqyra grafike 8**



NJZ 9 i përfshin shtetasit e Maqedonisë të cilët jetojnë ose janë me qëndrim të përkohshëm në Australi dhe shtetet e Azisë. Në Zgjedhjet e fundit Parlamentare të vitit 2011 u regjistruan 798 votues, të cilët kishin mundësi të votojnë në 3 vende zgjedhore në PDK-të ose në zyrat konsullore të Republikës së Maqedonisë. Votimi u zhvillua në qytetet: Kanbera, Melburn dhe Pekin. Në zgjedhje dolën gjithsej 600 votues, ndërsa mandatin e fitoi Koalicioni i VMRO-DPMNE-së.



**Pasqyra grafike e NJZ 9**

# PASQYRA E PJESËMARRËSVE TË ZGJEDHJEVE TË PARAKOHSHME PARLAMENTARE 2014

## PASQYRA E PJESËMARRËSVE TË ZGJEDHJEVE TË PARAKOHSHME PARLAMENTARE 2014

Për pjesëmarrje në zgjedhjet e 27 prillit, përmes paraqitjes së listave të kandidatëve pranë KSHZ-së, deri në afatin e fundit, në mesnatë të datës 29 mars, u paraqitën 14 subjekte politike. Në këtë Manual do të bëjmë një prezantim të shkurtër të partive dhe koalicioneve dhe të bartësve të listave të kandidatëve të katër partive më të mëdha parlamentare: VMRO-DPMNE, LSDM, BDI dhe PDSH. Këto katër parti, sipas sondazheve të aksesshme të fundit të opinionit publik, edhe në prag të këtyre zgjedhjeve, mbeten subjektet politike të cilat e gëzojnë besimin e qytetarëve. Partitë dhe koalicionet ua prezantojmë sipas radhitjes[73] që do ta kenë në fletët e votimit.

## PARTI POLITIKE, KOALICIONE DHE BARTËS TË LISTAVE TË KANDIDATËVE[74]

### 1. LIDHJA SOCIALDEMOKRATE E MAQEDONISË (LSDM)

Lidhja Socialdemokrate e Maqedonisë deklarohet si parti e qendrës së majtë, me proveniencë ideologjike socialdemokrate. Sipas madhësisë, aktualisht është partia e dytë në Maqedoni. U themelua në Kongresin e mbajtur më 21 prill të vitit 1991, si pasardhëse juridike e Lidhjes Komuniste të Maqedonisë – Partia për Transformim Demokratik (LKM-PTD). Po atë vit, partia e ndryshon emrin në LSDM, ndërkaq ideologjinë e transformon

[73] U përcaktua radhitja e listave të kandidatëve në fletën e votimit për zgjedhjen e deputetëve në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë, sipas njësive zgjedhore, Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve. I aksesshëm në: http://www.sec.mk/files/izbori2014/parlamentarni/redosled.pdf (vizita e fundit: 9 prill 2014)

[74] Logot e partisë dhe fotografitë e bartësve të listave të kandidatëve janë marrë nga faqet e internetit të partive përkatëse, institucioneve publike të caktuara dhe profilet zyrtare në Facebook të kandidatëve. Për të gjitha logot dhe fotografitë si burim është përdorur interneti.

nga komuniste në socialdemokrate. Ka marrë pjesë në të gjitha zgjedhjet parlamentare dhe lokale nga pavarësimi e deri më sot. Në vitin 1992, pas shpërndarjes së Qeverisë së parë eksperte, LSDM-ja edhe pse nuk kishte shumicë në Kuvend, e mori mandatin dhe e formoi Qeverinë e parë politike në Republikën e Maqedonisë. Në periudhën kohore, nga viti 1994 deri në vitin 1998, partia e kishte shumicën në Kuvend kur bashkë me partnerët e vet të koalicionit në zgjedhjet e vitit 1994 fitoi 85 mandate të deputetëve, mirëpo pastaj në Zgjedhjet Parlamentare të vitit 1998 e humbi pushtetin duke fituar 27 mandate të deputetëve. LSDM-ja është partia më e madhe opozitare deri në vitin 2002, kur përsëri fitoi në zgjedhje dhe siguroi 60 mandate të deputetëve, bashkë me partnerët e vet të koalicionit dhe qëndroi në pushtet deri në Zgjedhjet e ardhshme Parlamentare të vitit 2006. Në Zgjedhjet Parlamentare të vitit 2006, Koalicioni i LSDM-së fitoi 32 mandate të deputetëve. Që atëherë e deri më sot LSDM-ja është në opozitë pasi që humbi edhe në dy cikle zgjedhore të vitit 2008 dhe të vitit 2011. Në zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare të vitit 2008, bashkë me Koalicionin, fituan 27 mandate të deputetëve, ndërkaq në Zgjedhjet e fundit të Parakohshme Parlamentare të vitit 2011, LSDM-ja me Koalicionin fituan 42 mandate të deputetëve.

Kryetar i partisë nga pavarësimi i shtetit dhe transformimi nga LKM-PTD në LSDM vitin 1991 dhe deri në vitin 2004, është Branko Crvenkovski. Nga ky pozicion u tërhoq për shkak të fitores në Zgjedhjet e Jashtëzakonshme Presidenciale të vitit 2004, me ç'rast u bë President i RM-së. Në Kongresin e jashtëzakonshëm të LSDM-së, në nëntor të vitit 2004, për kryetar u zgjodh Vllado Buçkovski, i cili qëndroi në krye të partisë deri në zgjedhjet e vitit 2006 kur të njëjtat i humbi. Pas zgjedhjeve, Buçkovskit iu votua mosbesim ndërsa në Kongresin e jashtëzakonshëm, që u mbajt në nëntor të vitit 2006, kryetare u zgjodh Radmilla Shekerinska. Radmilla Shekerinska, në pozitën e kryetares s LSDM-së qëndroi deri në qershor të vitit 2008, kur edhe dha dorëheqje të parevokueshme për shkak të humbjes në zgjedhjet e parakohshme parlamentare. Në shtator të vitit 2008, në Kongresin e 8 të kësaj partie, ushtrues detyre – kryetar i partisë u zgjodh Zoran Zaev. Në vitin 2009 pas skadimit të mandatit presidencial, në Kongresin partiak, përsëri në krye të LSDM-së kthehet Branko Crvenkovski. Ai do të jetë lider i partisë deri në vitin 2013, kur tërhiqet nga pozicioni, ndërsa në vendin e tij përsëri zgjidhet kryetari aktual i partisë Zoran Zaev.

Partia edhe në nivel lokal është në opozitë. Pas Zgjedhjeve të fundit Lokale të vitit 2013, LSDM e fitoi pushtetin në 4 komuna nga gjithsej 80 dhe Qyteti i Shkupit.

Koalicioni i Lidhjes Socialdemokrate të Maqedonisë (LSDM) dhe partitë e tjera të Koalicionit, udhëhiqet nga LSDM dhe përbëhet nga 8 parti: Partia e Re Socialdemokrate (PRSD), Partia Liberal Demokrate (PLD), Të Bashkuar për Maqedoninë (BM), Partia për Lëvizjen e Turqve në Maqedoni (PLTM), Partia për Emancipimin e Plotë të Romëve (PEPR), Parti Serbe në Maqedoni (PSM), Lidhja Demokrate e Vllehve në Maqedoni (LDVM) dhe Liga e Sanxhakut (LS).

Lidhja Socialdemokrate e Maqedonisë
Rr. "Pavel Shatev" nr. 8
1000 Shkup
Tel: 02 3293 100
Faks: 02 3293 109
web@sdsm.org.mk
www.sdsm.org.mk

## Bartës të listave të kandidatëve të Koalicionit Lidhja Socialdemokrate e Maqedonisë (LSDM) dhe e partive të tjera të Koalicionit



**NJZ 1 – Renata Treneska Deskoska** është profesoreshë e të Drejtës kushtetuese dhe Sistemit politik në Fakultetin Juridik "Justinian Prima" pranë Universitetit "Shën Cirili dhe Metodi" – Shkup dhe anëtare e Këshillit ekzekutiv, organit më të lartë të LSDM-së. Karrierën akademike e ka filluar si demonstratore e fakultetit në vitin 1995, ndërsa profesoreshë e rregullt është zgjedhur në vitin 2012. Nga viti 2002 është doktor i shkencave juridike në Fakultetin Juridik të Lubjanës – Slloveni. Ka diplomuar në Fakultetin Juridik në Universitetin "Shën Cirili e Metodi" – Shkup në vitin 1994. Deri më tani nuk ka ushtruar funksione në pushtetin ekzekutiv dhe ligjvënës në Republikën e Maqedonisë. Për herë të parë është bartëse e listës zgjedhore të kandidatëve në NJZ 1.



**NJZ 2 – Petre Shilegov** është zëdhënës i LSDM-së dhe avokat. Në Qeverinë e LSDM-së të vitit 2002 ishte kryetar i Komisionit të shkallës së dytë për prokurime publike pranë Qeverisë së RM-së. Pastaj, punon në zyrën e avokatisë. Ka diplomuar në Fakultetin Juridik pranë Universitetit "Shën Cirili e Metodi" – Shkup. Ka lindur në vitin 1969 në Shkup. Për herë të parë është kandiduar për deputet në Kuvendin e RM-së dhe për herë të parë është bartës i listës së kandidatëve për zgjedhje parlamentare.



**NJZ 3 – Marjanço Nikollov** ishte deputet në legjislaturën e fundit të Kuvendit të RM-së dhe është anëtar i LSDM-së. Deri më tani, Nikollov tre herë është zgjedhur për deputet në zgjedhjet parlamentare të vitit 2006, 2008 dhe 2011. Karrierën politike e fillon si anëtar i Këshillit të Komunës së Velesit në vitin 2000, ndërsa në Zgjedhjet Lokale të vitit 2005 bëhet kryetar i Këshillit. Nikollovi është ekonomist, ka diplomuar në Fakultetin Ekonomik pranë Universitetit "Shën Cirili e Metodi" – Shkup. Ka lindur më 18 tetor të vitit 1971 në Veles. Për herë të parë është bartës i listës së kandidatëve në zgjedhje parlamentare.



**NJZ 4 – Hari Llokvenec** është ligjërues i lëndës Bazat e menaxhmentit pranë Universitetit Amerikan Kolexh në Shkup dhe është anëtar i KE të LSDM-së. Llokvenec, në Zgjedhjet e fundit Lokale të vitit 2013 ishte kandidat i opozitës për kryetar komune në Prilep. Nga viti 1992 deri në vitin 2008 ka qenë sipërmarrës privat. Nga viti 2008 është doktor i shkencave për Menaxhment teknik pranë Universitetit "Shën Klimenti i Ohrit" – Manastir. Paraprakisht ka magjistruar në biznes administratë pranë Universiteti Shiler në Tampa, Floridë - SHBA. Ka diplomuar në Fakultetin Elektroteknik pranë Universitetit "Shën Cirili e Metodi" – Shkup në vitin 1996. Deri më tani nuk ka ushtruar funksione në pushtetin ekzekutiv dhe ligjvënës në RM. Ka lindur në vitin 1970 në Prilep. Për herë të parë është bartës i listës së kandidatëve për zgjedhje parlamentare.



**NJZ 5 – Vasko Kovaçevski** është anëtar i Këshillit të Komunës së Manastirit dhe kryetar i organizatës komunale të LSDM-së – Manastir. Në pushtetin lokal është zgjedhur në Zgjedhjet Lokale të vitit 2013. Paraprakisht, Kovaçevski ka punuar si sipërmarrës me biznes privat. Ka diplomuar në Fakultetin e Makinerisë pranë Universitetit "Shën Klimenti i Ohrit" – Manastir. Ka lindur në vitin 1969 në Manastir. Për herë të parë është bartës i listës së kandidatëve për zgjedhje parlamentare.



**NJZ 6 – Stojko Paunovski** ishte deputet në legjislaturën e fundit të Kuvendit dhe nga viti 2013 është kryetar i organizatës komunale të LSDM-së – Tetovë. Paraprakisht ka punuar si audit i autorizuar. Paunovski ka diplomuar në Fakultetin Ekonomik pranë Universitetit "Shën Cirili e Metodi" – Shkup. Ka lindur në vitin 1962 në fshatin Çellopek – Tetovë. Për herë të parë është bartës i listës së kandidatëve për zgjedhje parlamentare.



**NJZ 7 – Gjelal Abdijeviq**[75]

75 Për kandidatin e Koalicionit të LSDM-së për deputet në Kuvendin e RM-së nga NJZ 7 nuk mund të gjenden të dhëna elementare të biografisë. Partia LSDM nuk iu përgjigj kërkesave që të na dërgojnë të dhëna elementare për këtë kandidat.



**NJZ 8 – Jani Haxhi-Elenov** është inxhinier i ndërtimtarisë, jeton dhe punon në Toronto – Kanada dhe është anëtar i LSDM-së. Paraprakisht ka punuar si inxhinier ndërtimtarie në Maqedoni. Titullin e ka fituar në Fakultetin Arkitektonik – të Ndërtimtarisë pranë Universitetit "Shën Cirili e Metodi" – Shkup. Deri më tani nuk ka ushtruar funksione në pushtetin ekzekutiv dhe ligjvënës në RM. Ka lindur në vitin 1974 në Strumicë. Për herë të parë është kandidat për deputet në zgjedhje parlamentare.



**NJZ 9 – Pece Smilevski** është sekretar i Klubit "Manastiri" në Melburn – Australi, ku ka emigruar para 10 vitesh. Ai është sipërmarrës dhe në Melburn menaxhon biznesin e tij. Paraprakisht në Manastir ka punuar si profesor i edukatës fizike. Ka diplomuar në Fakultetin e Kulturës Fizike në Beograd – Serbi. Deri më tani nuk ka ushtruar funksione në pushtetin ekzekutiv dhe ligjvënës në RM. Ka lindur në vitin 1961 në Manastir Për herë të parë është kandidat për deputet në zgjedhje parlamentare.

## 2. PARTIA DEMOKRATIKE SHQIPTARE (PDSH)

Partia Demokratike Shqiptare është themeluar në muajin qershor të vitit 1997 me bashkimin e Partisë për Prosperitet Demokratik të Shqiptarëve (PPDSH) dhe Partisë Demokratike Popullore (PDP). PPDSH u themelua në vitin 1994, pasi që krahu radikal i Partisë për Prosperitet Demokratik (PPD), Arben Xhaferi dhe Menduh Thaçi e braktisën partinë amë. PDSH deklarohet si parti e qendrës së djathtë dhe angazhohet për të drejta më të mëdha të shqiptarëve në Maqedoni dhe për ridefinimin e kornizës kushtetuese, të vendosur me Marrëveshjen Kornizë të Ohrit. Kryetar i PDSH-së është Menduh Thaçi, i cili në këtë funksion u zgjodh më 30 qershor të vitit 2007. Thaçi e merr këtë funksion pas dorëheqjes së kryetarit paraprak, Arbën Xhaferi.

Në Zgjedhjet e vitit 1998, PDSH-ja fitoi 11 mandate të deputetëve dhe u bë pjesë e Qeverisë së RM-së, të udhëhequr nga VMRO-DPMNE. Në kohën e konfliktit të vitit 2001, PDSH-ja mbeti pjesë e Qeverisë së Koalicionit të gjerë, e cila më vonë e nënshkroi Marrëveshjen Kornizë të Ohrit. Nënshkrues i Marrëveshjes Kornizë të Ohrit nga ana e PDSH, ishte kryetari i atëhershëm Arbën Xhaferi. Pas shpërbërjes së Qeverisë, PDSH mbetet në koalicionin qeveritar. Në Zgjedhjet e ardhshme Parlamentare të vitit 2002, PDSH fitoi 5.2% të votave, përkatësisht 7 mandate të deputetëve dhe kaloi në opozitë në Kuvend. PDSH përsëri kthehet në pushtet, kur pas zgjedhjeve të vitit 2006 me sukses i përfundoi negociatat me VMRO-DPMNE, e cila e kishte marrë mandatin për formimin e Qeverisë. Në këto zgjedhje, PDSH fitoi 7.5% të votave, përkatësisht 11 mandate të deputetëve që ishte numër më i vogël nga mandatet e partisë rivale BDI. Në zgjedhjet e parakohshme të vitit 2008, PDSH përsëri fitoi 11 mandate të deputetëve, pas Zgjedhjeve të Parakohshme Parlamentare të vitit 2008 partia më e madhe parlamentare VMRO-DPMNE e ndërpreu partneritetin tradicional me PDSH dhe formoi koalicion me partinë më të madhe shqiptare në Parlament - BDI. Në legjislaturën e fundit parlamentare, PDSH kishte 8 deputetë.

Në nivel lokal, pas Zgjedhjeve të fundit Lokale të vitit 2013 partia ka dy kryetarë të komunave nga gjithsej 80 komuna dhe Qyteti i Shkupit.

Partia Demokratike Shqiptare
Qendra e Qytetit 15/1
1200 Tetovë
Tel: 044 333 581
Faks: 044 333 581
info@gurra-pdsh.org
www.pdsh.info

### Bartës të listave të kandidatëve të PDSH



**NJZ 1 – Bekim Fazliu** ishte deputet në legjislaturën e fundit të Kuvendit të RM-së dhe është anëtar i Kryesisë së PDSH-së. Ka diplomuar në Fakultetin Juridik pranë Universitetit "Shën Cirili e Metodi" – Shkup. Ka lindur në vitin 1979 në Shkup. Për herë të dytë është bartës i listës së kandidatëve në NJZ 1.



**NJZ 2 – Orhan Ibraimi** ishte deputet në legjislaturën e fundit të Kuvendit të RM-së dhe është anëtar i Kryesisë së PDSH-së. Ka diplomuar në Fakultetin Pedagogjik pranë Universitetit "Shën Cirili e Metodi" – Shkup. Ka lindur në vitin 1964 në fshatin Opajë, Komuna e Likovës. Për herë të dytë është bartës i listës së kandidatëve në NJZ 2.

**NJZ 3 – Habib Maksudov**[76]




**NJZ 5 – Zija Jonuzi** është avokat dhe anëtar i Kuvendit qendror të PDSH-së. Në të kaluarën ka ushtruar funksione në ndërmarrje publike, mes tjerash, ka qenë drejtor i Postës në Ohër, nga viti 2006 deri në vitin 2008, dhe drejtor i Ndërmarrjes Komunale Publike në Strugë në periudhën kohore nga viti 2003 deri në vitin 2005. Ka diplomuar në Fakultetin Juridik pranë Universitetit të Prishtinës - Kosovë. Ka lindur në Strugë. Për herë të parë është bartës i listës së kandidatëve. Në zgjedhjet e kaluara të vitit 2011 ishte kandidat për deputet në NJZ 5.



**NJZ 6 – Menduh Thaçi** ishte deputet në legjislaturën e fundit të Kuvendit të RM-së dhe është kryetar i PDSH-së. Thaçi është deputet në Kuvendin e RM-së nga viti 2002. Nga viti 1997 deri në vitin 2006 ai është nënkryetar i Partisë, ndërkaq pas tërheqjes së liderit, Arbën Xhaferi, bëhet kryetar i PDSH-së. Ka diplomuar për stomatologji në Fakultetin e Mjekësisë pranë Universitetit të Prishtinës – Kosovë. Në më shumë cikle zgjedhore, Thaçi ka qenë bartës i listës së kandidatëve për deputet në Kuvendin e RM-së,  në NJZ 6.

76 Për kandidatin e PDSH-së për deputet në Kuvend nga NJZ 3 nuk mund të gjenden të dhëna elementare për biografinë. Partia e PDSH-së nuk iu përgjigj kërkesave që të na dërgojnë të dhëna elementare për këtë kandidat.





**NJZ 7 – Shpend Saiti** jeton në Zvicër dhe aktualisht arsimohet në Kolexhin Amerikan për biznes në Zvicër. Me origjinë është nga Kumanova. Deri më tani nuk ka ushtruar funksione në pushtetin ekzekutiv dhe ligjvënës në RM. Për herë të parë është kandidat për deputet në zgjedhje parlamentare.



**NJZ 8 – Ferki Bekteshi** jeton në qytetin Milvoki në shtetin Federal të Amerikës Viskonsin dhe është anëtar i PDSH. Me arsim është ekonomist. Ka diplomuar në Fakultetin Ekonomik pranë Universitetit të Prishtinës - Kosovë. Deri më tani nuk ka ushtruar funksione në pushtetin ekzekutiv dhe ligjvënës në RM. Për herë të parë është kandidat për deputet në zgjedhje parlamentare.

## 3. KOALICIONI "DINJITETI PËR MAQEDONI"

"Dinjiteti" ("Dostoinstvo") është parti politike e themeluar më 20 mars të vitit 2011. Partia lindi nga shoqata e mbrojtësve po me këtë emër, pjesëmarrës të forcave të armatosura, të cilët morën pjesë në konfliktin e vitit 2001. Kryetar i parë i kësaj partie është Stojançe Angelov, ish-gjeneral i policisë. "Dinjiteti" deklarohet si parti politike me orientim djathtist. Në periudhën kohore, nga viti 2011 deri në vitin 2013, partia ishte pjesë e opozitës së bashkuar "Aleanca për Ardhmëri" në krye me LSDM. Para këtyre zgjedhjeve "Dinjiteti" bëri koalicion me partinë Të Bashkuar për Maqedoninë. Koalicioni do të prezantohet me lista të kandidatëve të vet në të gjitha gjashtë njësitë zgjedhore në Republikën e Maqedonisë dhe në NJZ 8.

Koalicionit "Dinjiteti për Maqedoni"
Rr. "Orce Nikollov" nr. 166
1000 Shkup
Tel: 078 368 813
koalicija_m2@yahoo.com

### Bartës të listave të kandidatëve të Koalicionit "Dinjiteti për Maqedoni"

**NJZ 1 – Bllagoja Markovski**
**NJZ 2 – Goran Zafirovski**
**NJZ 3 – Goranço Angelov**
**NJZ 4 – Nadica Mirçovska**
**NJZ 5 – Stojançe Angelov**
**NJZ 6 – Goce Dellçev Todev**
**NJZ 8 – Stojadin Naumovski**

## 4. BASHKIMI DEMOKRATIK PËR INTEGRIM (BDI)

Bashkimi Demokratik për Integrim lindi nga ish-pjesëtarët e ish-Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare (UÇK), e cila e filloi konfliktin e armatosur në vitin 2001. Nga aspekti ideologjik, BDI deklarohet si parti e qendrës së majtë, e cila angazhohet për më shumë të drejta për shqiptarët dhe për implementimin e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit. Partia u formua në vitin 2002 dhe për herë të parë mori pjesë në zgjedhjet parlamentare të po atij viti dhe fitoi numër më të madh të votave nga elektorati etnik shqiptar, me ç'rast siguroi gjithsej 16 mandate të deputetëve dhe u bë pjesë e Qeverisë, e udhëhequr nga LSDM-ja. Që nga themelimi i saj e deri më sot, kryetar i kësaj partie është Ali Ahmeti. BDI ishte pjesë e Qeverisë në periudhën kohore nga viti 2002 deri në vitin 2006 dhe ishte e përfaqësuar me numër më të madh të ministrave që i ka pasur një parti shqiptare në Qeverinë e RM-së. Në Zgjedhjet Parlamentare të vitit 2006, BDI përsëri fitoi numër më të madh të votave nga elektorati shqiptar (12.2%), përkatësisht 17 mandate të deputetëve, megjithatë, pas negociatave të pasuksesshme me VMRO-DPMNE nuk u përfshi në koalicionin e atëhershëm qeveritar. Si rezultat i kësaj, BDI e bojkotoi punën e Kuvendit për një periudhë të gjatë kohore, brenda vitit 2006 - 2008, kur edhe u shpallën zgjedhjet e parakohshme parlamentare. Në Zgjedhjet Parlamentare të vitit 2008, BDI fitoi 12.8% të votave, përkatësisht 18 mandate të deputetëve, ndërsa si parti më e madhe politike, e cila i përfaqëson shqiptarët etnikë, hyri në Qeveri në krye të së cilës ishte Nikolla Gruevski. Në Zgjedhjet e ardhshme Parlamentare të vitit 2011, BDI përsëri është parti e tretë për nga madhësia, sa i përket numrit të votave të fituara dhe mandateve të fituara për deputetë në Maqedoni. BDI-ja, në legjislaturën e fundit të Kuvendit kishte 14 deputetë, ndërsa si parti koalicioni në Qeveri kishte 2 nënkryetarë të Qeverisë dhe 5 ministra.

Në nivel lokal, BDI-ja, pas Zgjedhjeve të fundit Lokale të vitit 2013 ka 14 kryetarë të komunave nga gjithsej 80 komuna dhe Qyteti i Shkupit.

Bashkimi Demokratik për Integrim
Rr. "Reçicë e Vogël"
1200 Tetovë
Tel: 044 334 398
press@bdi.mk
www.bdi.mk

## Bartës të listave të kandidatëve të BDI



**NJZ 1 – Ermira Mehmeti** ishte deputete në legjislaturën e fundit të Kuvendit të RM-së dhe është anëtare e Kuvendit të Përgjithshëm të BDI-së. Është deputete në Kuvendin e RM-së nga viti 2008. Mehmeti është Doktor i Shkencave Juridike pranë Universitetit në Tiranës – Shqipëri. Paraprakisht ka magjistruar për Politikë komparative në Shkollën Londineze për Ekonomi dhe Shkenca Politike. Ka lindur në vitin 1979 në Shkup. Në Zgjedhjet e fundit Parlamentare të vitit 2011, Mehmeti ishte bartëse e listës së kandidatëve në NJZ 2. Në këto zgjedhje për herë të parë do të jetë bartëse në NJZ 1.



**NJZ 2 – Rexhail Ismaili** ishte deputet në legjislaturën e fundit të Kuvendit të RM-së dhe është anëtar i Kuvendit të Përgjithshëm të BDI-së. Është deputet nga Zgjedhjet Parlamentare të vitit 2011. Ismaili është inxhinier i diplomuar i bujqësisë. Paraprakisht, ka ushtruar funksione në ndërmarrje publike. Ka diplomuar në Fakultetin e Bujqësisë në Prishtinë – Kosovë. Ka lindur në vitin 1966 në fshatin Sllupçan, Komuna e Likovës. Ismaili për herë të parë është bartës i listës së kandidatëve në NJZ 2.



**NJZ 3 – Behixhudin Shehapi** ishte deputet në legjislaturën e fundit të Kuvendit të RM-së dhe është anëtar i BDI-së. Në periudhë kohore nga viti 2008 deri në vitin 2011 e ushtron funksionin drejtor i Qendrës Nacionale Konservatore. Paraprakisht ka ushtruar funksione pranë Bashkësisë Fetare Islame në Maqedoni dhe ka ligjëruar në Shkollën e Mesme Teologjike në Shkup. Ka diplomuar për Histori të Artit në Fakultetin e Filozofisë pranë Universitetit "Shën Cirili e Metodi" – Shkup. Ka lindur në vitin 1961 në Tetovë. Për herë të parë është bartës i listës së kandidatëve në NJZ 3, ndërsa në zgjedhjet e kaluara ishte kandidat për deputet në NJZ 6.



**NJZ 4 – Nexhati Jakupi** ishte deputet në legjislaturën e fundit të Kuvendit të RM-së dhe është anëtar i BDI-së. Në periudhën kohore, nga viti 2008 deri në vitin 2011, ishte ministër i Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor në Qeverinë e RM-së. Paraprakisht, ka punuar si kirurg i përgjithshëm në Qendrën Klinike Shtetërore – Shkup dhe në vende të tjera pune në sektorin e shëndetësisë. Paraprakisht, është specializuar për kirurgji të përgjithshme në Fakultetin e Mjekësisë pranë Universitetit "Shën Cirili e Metodi" – Shkup, ndërkaq ka diplomuar në Fakultetin e Mjekësisë në Universitetin e Mjekësisë në Sofje - Bullgari. Ka lindur në vitin 1973 në Gostivar. Jakupi, për herë parë, është bartës i listës së kandidatëve në zgjedhje parlamentare. Në zgjedhjet e kaluara ishte kandidat për deputet në NJZ 6.



**NJZ 5 – Musa Xhaferi** është nënkryetar i Qeverisë së RM-së, i ngarkuar për implementimin e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit. Ai është njëri nga themeluesit e BDI-së, anëtar i Kuvendit të Përgjithshëm të partisë dhe Sekretar i Sekretariatit për Vetëqeverisje Lokale dhe Decentralizim pranë BDI-së. Në periudhën kohore nga viti 2008 deri në vitin 2011 është Ministër i Vetëqeverisjes Lokale. Paraprakisht, në periudhën kohore nga viti 2002 deri në vitin 2006, po ashtu ishte Nënkryetar i Qeverisë, i ngarkuar për implementimin e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit. Nga viti 1995 është magjistër i ekonomisë pranë Universitetit të Cyrihut – Zvicër. Në vitin 2000 ka kryer studime të specializuara për pedagogji në Akademinë për arsimin e të rriturve në Lucern. Ka diplomuar në Fakultetin e Ekonomisë pranë Universitetit të Prishtinës në vitin 1984. Ka lindur në vitin 1959 në fshatin Zajaz, Komuna e Kërçovës. Xhaferi për herë të parë është bartës i listës së kandidatëve në zgjedhje parlamentare.



**NJZ 6 – Ali Ahmeti** ishte deputet në legjislaturën e fundit të Kuvendit të RM-së dhe është lider i BDI-së. Ai është lider i BDI-së që nga themelimi i saj në vitin 2002. Në konfliktin e vitit 2001 ishte komandanti suprem dhe lider politik i Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare (UÇK). Ka diplomuar për filozofi në Universitetin e Prishtinës – Kosovë në vitin 1983. Ka lindur në vitin 1959 në fshatin Zajaz, Komuna e Kërçovës. Ahmeti për herë të pestë është bartës i listës së kandidatëve në NJZ 6.




**NJZ 7 – Ismail Beluli** është sipërmarrës i cili jeton në Zvicër. Në vitin 2011 ishte kandidat i BDI-së për deputet në NJZ 7. Ka punuar në më shumë veprimtari hotelerie. Deri më tani nuk ka ushtruar funksione në pushtetin ekzekutiv dhe ligjvënës në RM. Ka diplomuar në Fakultetin Juridik në Universitetin e Prishtinës – Kosovë. Ka lindur në vitin 1961 në Gostivar. Për herë të dytë kandidohet për deputet në NJZ 7.



**NJZ 8 – Tefik Abdullahi** punon në fushën e arsimit me komunitetet shqiptare në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Kanada. Nga viti 1991 është aktiv në fushën e arsimit dhe organizatat të cilat punojnë në fushën e kulturës në Kanada. Deri më tani nuk ka ushtruar funksione në pushtetin ekzekutiv dhe ligjvënës në RM. Ka diplomuar në Fakultetin Juridik në Universitetin e Prishtinës në vitin 1987. Ka lindur në vitin 1947 në Prespë. Për herë të dytë kandidohet për deputet në NJZ 8.




**NJZ 9 – Driton Maliku** është biznesmen dhe drejtor i radio stacionit i cili transmeton program në gjuhën shqipe në Australi. Deri më tani nuk ka ushtruar funksione në pushtetin ekzekutiv dhe ligjvënës në RM. Nga viti 1987 jeton në Melburn. Ka lindur në vitin 1973 në rrethin e Manastirit. Për herë të parë kandidohet për deputet në Kuvendin e RM-së.

## 5. VMRO – PARTIA DEMOKRATIKE PËR UNITETIN KOMBËTAR MAQEDONAS (VMRO-DPMNE)

VMRO-DPMNE është parti e cila deklarohet si parti popullore e qendrës së djathtë, me proveniencë ideologjike demokristiane. Nga pavarësia e deri më sot, VMRO-DPMNE është njëra nga dy partitë më të mëdha në Maqedoni. Thuaja se ka marrë pjesë në të gjitha zgjedhjet parlamentare dhe lokale, me përjashtim të zgjedhjeve parlamentare të vitit 1994 kur i bojkotoi zgjedhjet e rrethit të dytë. Në zgjedhjet e treta parlamentare, të mbajtura në vitin 1998, me 49 mandate të fituara të deputetëve në koalicion me Alternativën Demokratike, e cila fitoi 13 mandate të deputetëve dhe PPDSH-PDP (më vonë PDSH), me 11 mandate të deputetëve, si dhe me disa parti më të vogla, VMRO-DPMNE për herë të parë formoi Qeveri. VMRO-DPMNE mbetet në pushtet deri në vitin 2002, mirëpo gjatë kohës së konfliktit, nga muaji maj deri në nëntor të vitit 2001, u formua Qeveri e Koalicionit të Gjerë, e cila përfshiu edhe ministra të LSDM-së dhe PLD-së. Në vitin 2002, VMRO-DPMNE bashkë me partnerët e koalicionit fituan 33 mandate të deputetëve, i humbi zgjedhjet dhe kaloi në opozitë deri në vitin 2006. Në vitin 2006, bashkë me koalicionin "Për Maqedoni më të Mirë" përsëri fitoi në zgjedhjet parlamentare duke siguruar 45 mandate të deputetëve dhe e formoi Qeverinë. Në këto zgjedhje, partia, për herë të parë u prezantua me program konkret dhe me afate konkrete që ishte risi në garën zgjedhore. Prej atëherë e deri më sot, VMRO-DPMNE fiton edhe në dy cikle zgjedhore, në zgjedhjet e parakohshme parlamentare të vitit 2008 dhe 2011. Në Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare të vitit 2008, bashkë me Koalicionin "Për Maqedoni më të Mirë", fitoi 63 mandate rekord të deputetëve. VMRO-DPMNE në legjislaturën e fundit të Kuvendit kishte 47 deputetë, ndërkaq bashkë me partnerët e Koalicionit "Për Maqedoni më të Mirë" kishin 56 deputetë, nga gjithsej 123 deputetë në Kuvend.

Kryetar i VMRO-DPMNE-së nga themelimi deri në vitin 2003 është Lubço Georgievski. Në Kongresin partiak të muajit maj të vitit 2003, Georgievski paraqet dorëheqje, ndërkaq në vend të tij zgjidhet Nikolla Gruevski, i cili është në krye të partisë deri në ditët e sotme. Gruevski, nga viti 2006, deri në shpalljen e Zgjedhjeve të Parakohshme të vitit 2014 është Kryetar i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë.

Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE e fitoi pushtetin edhe në nivel lokal. Pas Zgjedhjeve të fundit Lokale të vitit 2013[77] kandidatët e saj janë kryetarë të 57 komunave nga gjithsej 80 komuna dhe Qyteti i Shkupit.

Koalicioni "Për Maqedoni më të Mirë" i udhëhequr nga VMRO-DPMNE-ja përbëhet nga 22 parti: Partia Socialiste e Maqedonisë (PSM), Lidhja Demokratike (LD), Rindërtimi Demokratik i Maqedonisë (RDM), Partia Demokratike e Turqve në Maqedoni (PDTM), Partia Demokratike e Serbëve në Maqedoni (PDSM), Lidhja e Romëve të Maqedonisë (LRM), Partia e Bashkuar për Emancipim (PBE), Partia e Drejtësisë (PD), Partia e Aksionit Demokratik në Maqedoni (PADM), Partia e Vllehve të Maqedonisë (PVM), Partia për Integrimin e Romëve (PIR), Partia Demokratike Boshnjake (PDB), Forcat Demokratike të Romëve (FDR), Bashkimi i Përhershëm Radikal Maqedonas (BPRM/TMRO), Partia e Re Liberale (PRL), Lëvizja Popullore për Maqedoni (LPM), VMRO – PD, VMRO e Bashkuar, Organizata Atdhetare Maqedonase për Rindërtim Radikal – Vardar – Egje – Pirin, Aleanca Maqedonase (AM), VMRO - Maqedonase.

VMRO-DPMNE
Rr. "Maqedonia" nr. 17a
1000 Shkup
Tel: 02 3215 550
Faks: 02 3215 551
contact@vmro-dpmne.org.mk
www.vmro-dpmne.org.mk

77 Rezultate përfundimtare nga Zgjedhjet Lokale të vitit 2013, Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve, 1 maj 2013. I aksesshëm në: http://217.16.84.17/Results.aspx?RaceID=1&UnitID=1&IsPS=0&Turnout=0&LangID=1 (vizita e fundit: 3 prill 2014).

## Bartës të listave të kandidatëve të VMRO-DPMNE dhe Koalicionit "Për Maqedoni më të Mirë"



**NJZ 1 – Nikolla Gruevski** është Kryetar i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë (RM) dhe kryetar i VMRO-DPMNE-së. Në funksionin Kryetar i Qeverisë erdhi pas fitores në Zgjedhjet Parlamentare të vitit 2006. Gruevski në jetën politike është i pranishëm nga vitit 1998 deri në vitin 1999 kur i ushtronte funksionet Ministër pa resor dhe Ministër i Tregtisë. Në periudhën kohore të vitit 1999 deri në vitin 2002 është Guvernator i RM-së në Bankën Botërore dhe në Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, ndërsa pastaj Ministër i Financave. Ishte deputet në legjislaturën e Kuvendit të vitit 2002-2006, ndërsa nga viti 2003 është lider i VMRO-DPMNE-së. Gruevski, nga viti 2006 është magjistër i shkencave ekonomike në Fakultetin e Ekonomisë pranë Universitetit "Shën Cirili e Metodi" – Shkup, ndërkaq diplomoi në Fakultetin Ekonomik – Prilep pranë Universitetit "Shën Klimenti i Ohrit" – Manastir. Ka lindur në vitin 1970 në Shkup. Në katër zgjedhjet parlamentare rresht, Gruevski është bartës i listës zgjedhore në NJZ 1.



**NJZ 2 – Gordana Jankullovska** është Ministre e Punëve të Brendshme në Qeverinë e RM-së dhe është anëtarë e Komitetit Ekzekutiv (KE), organit më të lartë partiak të VMRO-DPMNE-së. Funksionin Ministre e ushtron nga viti 2006. Nga viti 2000 deri në vitin 2002 punon si këshilltare shtetërore në Ministrinë e Financave, ndërsa në periudhën e njëjtë është e angazhuar në pozitën e shefit të kabinetit të ministrit. Nga viti 2004 është Sekretare e Përgjithshme e VMRO-DPMNE-së deri në propozimin e saj për Ministre të Punëve të Brendshme. Në periudhën kohore, nga viti 2005 deri në vitin 2006 është anëtare e Këshillit të Qytetit të Shkupit. Nga viti 2004 Jankullovska është magjistre e të Drejtës ndërkombëtare komerciale në Fakultetin Juridik pranë Universitetit në Kent – Britani e Madhe. Ka diplomuar në Fakultetin Juridik pranë Universitetit "Shën Cirili e Metodi" – Shkup. Ka lindur në vitin 1975 në Ohër. Jankullovska është bartëse e listës së kandidatëve në NJZ 2 në tre zgjedhjet e fundit parlamentare rresht.



**NJZ 3 – Nikolla Todorov** është Ministër i Shëndetësisë në Qeverinë e RM-së dhe anëtar i Komitetit Ekzekutiv të VMRO-DPMNE-së. Nga viti 2006 ushtron një sërë funksionet në ndërmarrjet publike, ndërsa nga viti 2009 deri në vitin 2011 është Ministër i Arsimit dhe Shkencës në Qeverinë e RM-së. Nga viti 2011 është emëruar për Ministër të Shëndetësisë. Ka diplomuar në Fakultetin Juridik pranë Universitetit "Shën Cirili e Metodi" – Shkup. Ka lindur në vitin 1979 në Shkup. Todorov, në zgjedhjet e parakohshme parlamentare të vitit 2011, ishte bartës i listës së kandidatëve në NJZ 6.



**NJZ 4 – Zoran Stavrevski** është Nënkryetar i Qeverisë së RM-së dhe Ministër i Financave dhe anëtar i KE të VMRO-DPMNE-së. Nga viti 1997 deri në vitin 2000 punon në disa pozicione në Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë. Nga viti 2000 deri në vitin 2001 është nënsekretar në Ministrinë e Financave. Nga viti 2001 punon në Bankën Botërore, ndërsa në vitin 2006 është emëruar për ekonomist udhëheqës për politika zhvillimore. Pas fitores së VMRO-DPMNE-së në zgjedhjet e vitit 2006 u emërua për Nënkryetar të Qeverisë për çështje ekonomike në Qeverinë e RM-së. Nga viti 2009 është Nënkryetar i Qeverisë dhe Ministër i Financave. Stavrevski, nga viti 1997 është magjistër i shkencave ekonomike në Fakultetin Ekonomik pranë Universitetit "Shën Cirili e Metodi" – Shkup. Ka diplomuar në Fakultetin e njëjtë në vitin 1987. Ka lindur në vitin 1964 në Ohër. Në Zgjedhjet e fundit Parlamentare të vitit 2011 ai ishte bartës i listës së kandidatëve në njësinë e njëjtë zgjedhore.



**NJZ 5 – Antonio Milloshoski** ishte deputet në legjislaturën e fundit të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë dhe është anëtar i KE të VMRO-DPMNE-së. Në periudhën kohore nga viti 1999 deri në vitin 2000 ishte shef i kabinetit të Nënkryetares së Qeverisë të RM-së, Dosta Dimovska, ndërsa nga viti 2000 deri në vitin 2001 është zëdhënës i Qeverisë. Në zgjedhjet e vitit 2006 u zgjodh për deputet në Kuvendin e RM-së. Menjëherë pastaj u emërua për Ministër të Punëve të Jashtme, funksion të cilin e ushtroi deri në vitin 2011 kur pas zgjedhjeve parlamentare dha dorëheqje nga funksioni i ministrit dhe u kthye në Parlament. Milloshoski nga viti 2002 është magjistër i eurointegrimeve pranë Universitetit "Fridrih Uilhem" në Bon të Gjermanisë. Ka diplomuar në Fakultetin Juridik pranë Universitetit "Shën Cirili e Metodi" – Shkup. Ka lindur në vitin 1976 në Tetovë. Ishte bartës i listës zgjedhore në NJZ 5 në zgjedhjet parlamentare të vitit 2006, 2008 dhe në 2011.



**NJZ 6 – Nikolla Poposki** është Ministër i Punëve të Jashtme në Qeverinë e RM-së. Në të kaluarën ka ushtruar një sërë funksionesh në organe dhe institucione evropiane, ndërsa nga viti 2010 deri në vitin 2011 u emërua për ambasador, shef i Misionit të RM-së pranë Bashkimit Evropian. Nga viti 2004 është magjistër për gjuhë të huaja dhe tregti ndërkombëtare në Universitetin në Ren – Francë dhe Universitetin "Shën Cirili e Metodi" – Shkup, ndërsa nga viti 2005 edhe për studime evropiane ekonomike në Kolexhin e Evropës në Brizh - Belgjikë. Ka lindur në vitin 1977 në Shkup. Poposki është për herë të parë bartës i listës së kandidatëve në zgjedhjet parlamentare.



**NJZ 7– Risto Mançev** ishte deputet në legjislaturën e fundit të Kuvendit të RM-së dhe është anëtar i VMRO-DPMNE-së. Ka diplomuar në Fakultetin e Ndërtimtarisë pranë Universitetit "Shën Cirili e Metodi" – Shkup. Mançev me profesion është inxhinier i ndërtimtarisë. Jeton në Piaçencë – Itali, ndërsa ka lindur në vitin 1969 në Strumicë. U zgjodh për deputet në Kuvendin e RM-së në NJZ 7 në Zgjedhjet Parlamentare të vitit 2011.



**NJZ 8 – Pavle Sazdov** ishte deputet në legjislaturën e fundit të RM-së dhe është anëtar i VMRO-DPMNE-së. Nga viti 2002 punon në fushën e informatikës në më shumë kompani të Kanadasë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Në vitin 2010 u emërua për sekretar shtetëror në Ministrinë e Shoqërisë Informatike. Nga viti 2013 është magjistër në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në Fakultetin e Shkencave Shoqërore FSHSH në Shkup. Ka diplomuar në fushën e teknologjisë së informacionit, në drejtimin Siguria e Rrjeteve dhe Internetit në Kolexhin Everest në Misisaga – Kanada. Ka lindur në vitin 1983 në Shkup. Në zgjedhjet Parlamentare të vitit 2011 Sazdov u zgjodh për deputet në NJZ 8.



**NJZ 9 – Vasko Naumovski** është sipërmarrës maqedonas i cili jeton në Melburn – Australi. Punon në relacionin Melburn – Manastir. Deri më tani nuk ka ushtruar funksione në pushtetin ekzekutiv dhe ligjvënës në RM. Ka lindur në vitin 1971 në Uiliamstaun, Melburn - Australi. Për herë të parë kandidohet për deputet në Kuvendin e RM-së në NJZ 9.

## 6. RILINDJA DEMOKRATIKE KOMBËTARE (RDK)

Rilindja Demokratike Kombëtare u themelua në mars të vitit 2011, si parti më e re politike në bllokun etnik shqiptar. Nga aspekti ideologjik, RDK-ja pozicionet si parti e qendrës së djathtë, si parti me përcaktim kombëtar dhe demokratik dhe angazhohet për avancimin e të drejtave dhe lirive personale dhe kombëtare të shqiptarëve etnikë në Maqedoni. Kryetar dhe themelues është Rufi Osmani, ish-kryetar i Komunës së Gostivarit. Në Zgjedhjet Parlamentare të vitit 2011, RDK-ja fitoi 2.67% nga numri i përgjithshëm i votave, përkatësisht 2 mandate të deputetëve. Partia do të kandidojë lista të deputetëve në NJZ: 1, 2, 5 dhe 6 në Maqedoni dhe në NJZ 7 jashtë vendit.

Rilindja Demokratike Kombëtare
Rr. "Bitpazarska" 60
Shkup
Tel: 02 5511 371
info@rdk.org.mk
www.rdk.org.mk

### Bartës të listave të kandidatëve të RDK-së

**NJZ 1 – Gikten Haziri**
**NJZ 2 – Xhezair Shaqiri**
**NJZ 5 – Ardian Demiri**
**NJZ 6 – Rufi Osmani**
**NJZ 7 – Enver Osmani**

## 7. LËVIZJA POPULLORE E MAQEDONISË (LPM)

Lëvizja Popullore e Maqedonisë është themeluar më 18 maj të vitit 2002, si parti me orientim kombëtar të mbështetur mbi traditën e popullit maqedonas, e cila angazhohet për shtet social dhe tatime për të pasurit. Kryetari i LPM-së është Janko Baçev. LPM do të kandidojë lista të deputetëve në 5 njësi zgjedhore, përkatësisht në NJZ -1, 2, 3, 4 dhe 5.

Lëvizja Popullore e Maqedonisë
Rr. "Dame Gruev" 10
1000 Shkup
Tel: 02 3101 999, 075 335 013
ndm@ndm.org.mk
www.ndm.org.mk

### Bartës të listave të kandidatëve të LPM

**NJZ 1 – Janko Baçev**
**NJZ 2 – Zoran Jovanoviq**
**NJZ 3 – Sashe Ivanovski**
**NJZ 4 – Goce Jankov**
**NJZ 5 – Robert Spasenovski**

## 8. KOALICIONI OPQM

Opsioni Qytetar për Maqedoninë OPQM (GROM) është parti e re politike e cila u themelua në muajin shtator të vitit 2013. Për kryetar të partisë së sapoformuar u zgjodh Stevçe Jakimovski, sipas së cilit partia do të angazhohet që qytetarët të kenë pjesëmarrje më të madhe në pushtet përmes propozimeve, iniciativave dhe sugjerimeve të tyre, si dhe përmes propozimit të projekteve. Koalicioni OPQM (GROM) udhëhiqet nga partia GROM dhe përbëhet nga partitë: Partia Liberale, Partia Përparimtare Serbe në Maqedoni, Lidhja e Forcave të Majta të Titos dhe Partia e Demokratëve të Lirë. Në këto zgjedhje do të marrin pjesë me një emër koalicioni, përkatësisht Koalicioni GROM. Bashkëpunimi i partive do të mbështetet mbi një plan afatgjatë, me respekt të ndërsjellë në bazë të parimeve demokratike, me objektiva qartë të përcaktuara në të cilat qytetarët e Republikës së Maqedonisë janë në plan të parë, pa dallime të përkatësisë së tyre etnike, religjioze ose të ndonjë përkatësie tjetër. Koalicioni GROM do të propozojë lista të kandidatëve në të gjitha 6 NJZ-të në Maqedoni.

Opsioni Qytetar për Maqedoninë
Rr. "Ruzveltova" p.n., hyrja 1, lokali nr. 9
1000 Shkup
info@grom.mk
www.grom.mk

### Opsioni Qytetar për Maqedoninë OPQM (GROM)

**NJZ 1 – Çedomir Sazdovski**
**NJZ 2 – Viktor Cvetkovski**
**NJZ 3 – Shterjo Nikollov**
**NJZ 4 – Panço Minov**
**NJZ 5 – Lupço Nastoski**
**NJZ 6 – Goran Ançeski**

## 9. KOALICIONI PËR MAQEDONI POZITIVE

Aleanca për Maqedoni Pozitive (AMP) është parti e re politike në Republikën e Maqedonisë, e themeluar në muajin mars të vitit 2014. Kryetar i Partisë është Lupço Zikov. Kjo parti politike fokusin e veprimit të vet e orienton kah angazhimi i qytetarëve, të drejtave dhe obligimeve të tyre. Koalicioni për Maqedoni Pozitive përbëhet nga partitë politike AMP dhe Partia e Pensionistëve dhe Qytetarëve të Bashkuar të Maqedonisë. Ky Koalicion angazhohet për shmangien e diskriminim i cili gjenerohet nga Preambula e Kushtetutës dhe do të propozojë ndryshim të legjislacionit për sigurimin e pjesëmarrjes së barabartë të pjesëtarëve të të gjitha bashkësive në jetën publike. Koalicioni për Maqedoni Pozitive paraqiti lista të kandidatëve për deputetë në të gjitha 6 NJZ-të në Maqedoni.

Aleanca për Maqedoni Pozitive
Rr. "Vasill Gjorgov" nr. 37
1000 Shkup
Tel: 02 3256 546
kontakt@pozitivnamakedonija.mk
www.pozitivnamakedonija.mk

### Bartës të listave të kandidatëve të Koalicionit për Maqedoni Pozitive

**NJZ 1 – Lupço Zikov**
**NJZ 2 – Vllado Buçkovski**
**NJZ 3 – Ilija Nikollovski**
**NJZ 4 – Dane Jovanov**
**NJZ 5 – Igor Kambovski**
**NJZ 6 – Xhevdet Halimi**

## 10. VMRO – PARTIA POPULLORE (VMRO - PP)

VMRO-PP deklarohet si parti politike konservative. U themelua më 4 korrik të vitit 2004 në Shkup nga ithtarët e Lubço Georgievskit, kryetarit të parë të VMRO-DPMNE-së dhe ish-Kryeministër i Republikës së Maqedonisë, i cili u nda nga VMRO-DPMNE. VMRO-PP është parti me përvojë në zgjedhje parlamentare. Në Zgjedhjet Parlamentare të vitit 2006, partia mori pjesë në mënyrë të pavarur dhe fitoi 3 mandate. VMRO-PP sipas Statutit të saj, mes tjerash, angazhohet për liri, solidaritet dhe drejtësi. Krijimi i unitetit në liri dhe përgjegjësi, barazi dhe partneritet ndërmjet gruas dhe burrit. Për familjen si shtyllë e shoqërisë, respektimin e kulturës si shprehje të identitetit kombëtar dhe transparencë. Zhvillimi i parimeve të ekonomisë së tregut të lirë, miratimin e konkurrencës së Maqedonisë, si potencial bujqësor dhe industrial, sigurimi i drejtësisë sociale dhe ristrukturimin e shtetit social. Konsolidimi i demokracisë, mbrojtja e shtetit social dhe sundimi i së drejtës, lufta kundër korrupsionit dhe bashkëjetesa me njerëz të nacionaliteteve të ndryshme. VMRO-PP paraqiti lista të kandidatëve për të gjitha 6 NJZ në Maqedoni.

VMRO – Partia Popullore
Rr. "Nikolla Vapcarov" nr. 2
1000 Shkup
Tel: 02 6145 374
Faks: 02 6145 374
contact@vmro-np.org.mk
www.vmro-np.org.mk

### Bartës të listave të kandidatëve të VMRO-PP

**NJZ 1 – Sllobodan Bliznakovski**
**NJZ 2 – Lupço Ballkoski**
**NJZ 3 – Lupço Georgievski**
**NJZ 4 – Risto Pecev**
**NJZ 5 – Vanço Kostoski**
**NJZ 6 – Goran Loteski**

## 11. PARTIA SOCIAL DEMOKRATE E MAQEDONISË (PSDM)

Partia Social Demokrate e Maqedonisë (PSDM) u themelua në vitin 1990. Për kryetar të parë u zgjodh Sllavko Millosavlevski. PSDM-ja është parti e qendrës së majtë dhe në mënyrë deklarative e pranon ideologjinë socialdemokrate si bazë për veprimin e vet. Kryetar aktual është Branko Janevski, i cili është në krye të partisë tre mandate të njëpasnjëshme. Kjo parti ka marrë pjesë në të gjitha ciklet zgjedhore në Maqedoninë pluraliste, por pa ndonjë sukses më të theksuar. Në Zgjedhjet Parlamentare të vitit 2011, PSDM-ja fitoi 1807 vota (0.16%) në territorin e Republikës së Maqedonisë. Në Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare të vitit 2014, PSDM do të merr pjesë në mënyrë të pavarur dhe do të paraqes lista të kandidatëve në të gjitha 6 NJZ në Maqedoni.

Partia Social Demokrate e Maqedonisë
Bul. "JNA" nr. 54, ndërtesa nr. 1, hyrja 1 përdhes
1000 Shkup

### Bartës të listave të kandidatëve të PSDM

**NJZ 1 – Liljana Ivanovska**
**NJZ 2 – Petre Petrov**
**NJZ 3 – Marjanço Nakov**
**NJZ 4 – Natasha Trenkoska**
**NJZ 5 – Igor Ivanovski**
**NJZ 6 – Maja Ivanoska**

## 12. PARTIA PËR NDRYSHIME EKONOMIKE 21 (PNE 21)

Partia për Ndryshime Ekonomike 21 është parti politike relativisht e re, e cila deri më tani nuk ka marrë pjesë në zgjedhje. U themelua në muajin qershor të vitit 2013, ndërkaq deklarohet si parti qytetare e cila angazhohet për progres ekonomik, siguri dhe mirëqenie të të gjithë qytetarëve të Republikës së Maqedonisë. Kryetare e PNE 21 është Biljana Jovanovska, ish-anëtare e VMRO-DPMNE-së, VMRO-PP dhe BM. Partia deklarohet si parti e hapur për bashkëpunim me të gjitha partitë politike dhe fillimisht për mbrojtjen e interesave të Republikës së Maqedonisë dhe qytetarëve të saj. PNE 21 angazhohet për një ekonomi të ndershme dhe moderne me orientim për një treg të lirë që synon çrrënjosjen e plotë të papunësisë. Partia në këto zgjedhje do të paraqes lista të kandidatëve në 2 NJZ, përkatësisht në NJZ 1 dhe 2.

Partia për Ndryshime Ekonomike 21
Rr. "Hristo Tatarçev" nr. 47 I/3-30
1000 Shkup
Tel/faks: 02 6144 540
infocentar@pep21.org.mk
www.pep21.org.mk

### Bartës të listave të kandidatëve të PNE 21

**NJZ 1 – Seadin Xhaferi**
**NJZ 2 – Goce Petrushevski**

## 13. PARTIA PËR PROSPERITET DEMOKRATIK (PPD)

Partia për Prosperitet Demokratik (PPD) është partia më e vjetër e shqiptarëve në Maqedoni, e themeluar në vitin 1990, ndërsa funksiononte deri në Zgjedhjet Parlamentare të viti 2011 kur edhe iu bashkëngjit PDSH-së. Partia u riaktivizua në muajin janar të vitit 2014, ndërsa në krye të saj është Abdyladi Vejseli deputet në tri legjislatura të mëparshme të Kuvendit. Në vitet e nëntëdhjeta PPD-ja ishte partia më e madhe parlamentare e cila i përfaqësonte shqiptarët e Maqedonisë dhe disa herë ishte partner koalicioni në Qeveritë e LSDM-së. Pas ndarjes së krahut, të ashtuquajtur radikal nga partia, në vitin 1994, nga i cili i formua PDSH-ja, PPD-ja konsiderohet si parti politike e matur. PPD-ja angazhohet për barazi të plotë të shqiptarëve në planin politik, ekonomik, social dhe kulturor në Maqedoni, për gjuhën e tyre kombëtare, për marrëdhënie të harmonizuara ndëretnike të mbështetura mbi parimet demokratike të barazisë dhe drejtësisë së mirëfilltë. Partia paraqiti listë të kandidatëve vetëm për NJZ 6.

Partia për Prosperitet Demokratik
Bul. "Ilinden" p.n.
1200 Tetovë

### Bartës të listës së kandidatëve të PPD

**NJZ 6 – Muhamed Halili**

## 14. PARTIA PËR ARDHMËRI EVROPIANE (PAE)

Partia për Ardhmëri Evropiane (PAE) është parti politike e qendrës, e themeluar në Shkup, më 16 prill të vitit 2006. Në Zgjedhjet Parlamentare të vitit 2006 fitoi një mandat të deputetit, ndërsa në legjislaturën e fundit të Kuvendit, PAE kishte 3 deputetë. Lider i partisë nga themelimi i saj e deri më sot është Fijat Canovski. PAE angazhohet për integrimin e Maqedonisë në strukturat euroatlantike, për zhvillim të barabartë të të gjitha pjesëve të shtetit, përmes krijimit të kushteve për investime vendase dhe të huaja, si dhe për kthimin gradual të njerëzve nga diaspora në atdheun e tyre. Partia konsideron se qytetarët e Maqedonisë mund të ndihmojnë në zhvillimin e Maqedonisë përmes investimeve të tyre, por edhe me përvojën e tyre në planin e sipërmarrësisë dhe iniciativave private. PAE në këto zgjedhje paraqiti lista të kandidatëve në 4 NJZ, përkatësisht në NJZ 1, 2, 5 dhe 6.

Partia për Ardhmëri Evropiane
Bul. "Nëna Terezë" nr. 23
1000 – Shkup
Tel: 02 3177 323
Faks: 02 3177 323
kontakt@pei.org.mk
www.pei.org.mk

### Bartës të listave të kandidatëve të PAE

**NJZ 1 – Seadin Xhaferi**
**NJZ 2 – Erkan Alili**
**NJZ 5 – Fijat Canoski**
**NJZ 6 – Abdija Mersovski**

# ZGJEDHJE TË PARAKOHSHME PARLAMENTARE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË 2014 – REZULTATE, FUSHATA, VLERËSIME



## LISTA E SHKURTESAVE

Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive - ASHMAA
Organizata e Brendshme Revolucionare Maqedonase – Partia Demokratike për Unitet Kombëtar Maqedonas -VMRO-DPMNE
Opsioni Qytetar për Maqedoni – OPQM (GROM)
Partia Demokratike Shqiptare - PDSH
Bashkimi Demokratik për Integrim - BDI
Enti Shtetëror i Revizionit - ESHR
Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve - KSHZ
Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit – KSHPK
Bashkimi Evropian – BE
Njësia zgjedhore - NJZ
Radiotelevizioni i Maqedonisë – RTVM
Radio maqedonase - RM
Komisioni Komunal i Zgjedhjeve - KKZ
Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë/Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut – OSBE/ODIHR
Lidhja Socialdemokrate e Maqedonisë – LSDM
Gjykata Administrative - GJA

## HYRJE

Më 27 prill të vitit 2014 u mbajtën zgjedhjet e teta të përgjithshme për deputetë në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë, të cilat njëherësh ishin edhe zgjedhjet e treta të parakohshme parlamentare të njëpasnjëshme. Zgjedhjet parlamentare u mbajtën bashkë me rrethin e dytë të zgjedhjeve presidenciale. Fitore të bindshme arriti Koalicioni "Për Maqedoni më të Mirë" i udhëhequr nga partia Organizata e Brendshme Revolucionare Maqedonase – Partia Demokratike për Unitet Kombëtar Maqedonas (VMRO-DPMNE),në krye me Nikolla Gruevskin, i cili pa ndërprerë është në pushtet nga Zgjedhjet Parlamentare të vitit 2006. Në zgjedhje mori pjesë edhe Koalicioni i udhëhequr nga Lidhja Socialdemokrate e Maqedonisë (LSDM), Bashkimi Demokratik për Integrim (BDI), Partia Demokratike e Shqiptarëve (PDSH), "Koalicioni OPQM", i udhëhequr nga Partia Opsioni Qytetar për Maqedoni (OPQM), Rilindja Demokratike Kombëtare (RDK), Koalicioni "Dinjitet për Maqedoninë", i udhëhequr nga partia "Dinjiteti", "Koalicioni për Maqedoni Pozitive" (KMP), i udhëhequr nga partia Aleanca për Maqedoni Pozitive (AMP), VMRO-Partia Popullore (VMRO-PP), Partia për Prosperitet Demokratik (PPD), Partia për Ardhmëri Evropiane (PAE), Partia për Ndryshime Ekonomike 21 (PNE 21), Partia Socialdemokrate e Maqedonisë (PSDM), Lëvizja Popullore për Maqedoni (LPM). Për zgjedhjet në Listën Unike të Zgjedhësve gjithsej ishin të regjistruar 1,780,128 qytetarë me të drejtë vote, ndërsa më 27 prill në votim dolën 1,120,744 votues, përkatësisht 62,96%.

Zgjedhjet u shpallën më 6 mars, pasi që një ditë më parë, më 5 mars, deputetët njëzëri votuan për shpërndarjen e Kuvendit, ndërsa fushata zgjedhore filloi më 5 prill dhe zgjati deri më 25 prill. Gjatë periudhës parazgjedhore të zgjedhjeve presidenciale për shkak të mospajtimeve midis partnerëve të koalicionit VMRO-DPMNE dhe BDI për nominimin e kandidatit të përbashkët konsensual për President të Republikës së Maqedonisë, BDI paraqiti nismë për vetë-shpërndarjen e Kuvendit dhe për shpalljen e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare, e cila u pranua nga të gjithë deputetët e pranishëm në Kuvend.

Zgjedhjet parlamentare i monitoruan gjithsej 10.013 vëzhgues vendas dhe 610 vëzhgues të huaj. Vlerësimi i përgjithshëm i vëzhguesve ishte se zgjedhjet janë zbatuar në mënyrë efikase, kandidatët lirshëm kanë mundur t'i prezantojnë programet dhe qëndrimet e tyre, ndërkaq retorika dhe fushata është acaruar në gjysmën e dytë të fushatës me afrimin e ditës së zgjedhjeve. Vërejtjet kryesore të vëzhguesve në të vërtetë u shkaktuan nga sjellja e partive politike gjatë periudhës kohore të fushatës. Zgjedhjet rezultuan me rritjen e numrit të deputetëve tek partitë të cilat deri më tani ishin pjesë e Qeverisë së koalicionit, VMRO-DPMNE dhe BDI. Koalicioni i VMRO-DPMNE në legjislaturën e ardhshme të Kuvendit do të ketë 61 deputetë përkundrejt 56 mandateve të deritanishëm, ndërsa BDI do të ketë 19 deputetë përkundrejt 14 mandateve të deputetëve në legjislaturën e fundit. Në llogari të përforcimit të partive në pushtet, partitë opozitare pas këtyre zgjedhjeve do të jenë më pak të përfaqësuara në Parlament, në krahasim me legjislaturën e fundit. Koalicioni i LSDM tani fitoi 34 mandate të deputetëve, përkatësisht 6 deputetë më pas nga legjislatura e fundit parlamentare kur kishte 42 mandate të deputetëve. PDSH tani do të ketë 7 mandate të deputetëve, përkatësisht një më pak sesa në legjislaturën e fundit. Vetëm një deputetë do të ketë partia RDK, e cila deri më tani ishte përfaqësuar me dy mandate të deputetëve, ndërsa edhe një deputet do të vijë nga partia OPQM e cila u themelua kohë më parë dhe për herë të parë hyn në Kuvend.

Në vazhdim, ky Manual ofron një vështrim të detajuar të fushatës zgjedhore, të ardhurat dhe shpenzimet e fushatave zgjedhore, informimin e mediave, rezultatet e zgjedhjeve, respektimin e të drejtës së zgjedhjes, vlerësimin e zgjedhjeve nga vëzhguesit, vlerësimin e partive politike dhe konkluzione përmbledhëse për ciklin e përgjithshëm zgjedhor.

## FUSHATA ZGJEDHORE DHE FINANCIMI

Fushata për zgjedhjet e parakohshme parlamentare formalisht filloi më datë 5 dhe zgjati deri më 25 prill. Për shkak të heshtjes zgjedhore dhe votimit në rrethin e parë të zgjedhjeve presidenciale, partitë u desh t'i ndërpresin fushatat më 12 dhe 15 prill. Në përgjithësi, procesi u karakterizua me promovim pozitiv të kandidatëve dhe programeve zgjedhore partiake, por në gjysmën e dytë të fushatës kryesisht u orientua në sulme negative dhe akuza për skandale korruptive. Partitë, në masë të madhe, i përdorën metodat e zakonshme për promovim, siç janë mitingjet dhe takimet me qytetarët, fushatën nga derë më derë, reklamat televizive, ndërsa në këto zgjedhje bënë përshtypje fokusimi më i madh i fushatave në rrjetet sociale. Fushatat kaluan në atmosferë relativisht të qetë me incidente të vogla. Të gjithë subjektet politikë, gjatë kohës së fushatës, organizuan gjithsej 74 mitingje parazgjedhore dhe shtatë takime me qytetarët. Së kthemi, nuk u regjistruan prishje të rendit dhe qetësisë publike. Ministria e Punëve të Brendshme (MPB)[78] konstatoi se krahasuar me ciklet e zgjedhjeve paraprake, në këtë cikël është regjistruar numër më i vogël i incidenteve dhe prishjeve të rendit dhe qetësisë publike. Gjatë dy javëve të fushatës, policia ka regjistruar nëntë incidente në të cilët është shkaktuar dëm i vogël dhe i pakonsiderueshëm material. Dita e votimit, më 27 prill, ishte e qetë dhe pa incidente.

Misioni monitorues i OSBE/ODIHR[79] vuri në dukje se çështjet kryesore dhe prioritetet e kandidatëve presidencial dhe kandidatëve për zgjedhjen e deputetëve në Kuvend të pasqyruar në programet partiake dhe të koalicioneve përfshinë edhe zhvillimin ekonomik, investimet e huaja, zvogëlimin e varfërisë, punësimin e të rinjve, tejkalimin e ndarjeve etnike, zgjidhjen e çështjes së emrit dhe anëtarësimin në Bashkimin Evropian dhe NATO. Gjatë kohës së fushatës, LSDM paraqiti prova materiale,[80] pranë prokurorisë me të dhëna se kryeministri ka marrë ryshfet për privatizimin e "Makedonska Banka". Si përgjigje ndaj kësaj akuze, kryeministri paralajmëroi se do të nge padi kundër liderit të LSDM-së për shpifje.

Koalicioni "Për Maqedoni më të Mirë" i udhëhequr nga VMRO-DPMNE e zhvillonte fushatën me sloganin "Ka ndryshim, Ti mund ta identifikosh". Partia, para fillimit të fushatës zgjedhore, më 16 mars, botoi dhe publikisht e prezantoi "Llogaridhënie për punën e realizuar të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë të udhëhequr nga VMRO-DPMNE dhe partnerët e koalicionit 2011-2014"[81] në 258 faqe për punën në mandatin e Qeverisë së fundit. Partia, në fushatën zgjedhore, hyri me publikimin e Programit zgjedhor me titull "E provuar, projekte të cilat realizohen me fakte".[82] Në të, në 384 faqe, u numëruan 2046 projekte me të cilët planifikohet hapja e 64.000 vendeve të punës. Në Program, në kapitullin 11 janë përfshirë masa nga të gjitha fushat e punës së Qeverisë. Lideri i partisë Nikolla Gruevski dhe bartësit e listave të kandidatëve gjatë prezantimit të tyre potenconin se në fokus të Programit janë ekonomia dhe krijimi i vendeve të punës, ndërtimi i projekteve të infrastrukturës dhe projekteve të tjera të mëdha, masa dhe aktivitete për sektorin e biznesit, për të punësuarit në sektorin publik, për të rinjtë, pensionistët, bujqit.

Fushata onlajn e VMRO-DPMNE zhvillohej përmes internet faqes së partisë vmro-dpmne.org.mk, profilet zyrtare të rrjeteve sociale Fejsbuk dhe Tuiter, si dhe përmes profileve të bartësve dhe të kandidatëve të listave zgjedhore. Video regjistrimet nga mitingjet dhe takimet me qytetarët dhe

78 Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Maqedonisë, 25.04.2014 Shtabi Operativ pranë MPB për nevojat e zgjedhjeve, në krahasim me ciklet zgjedhor paraprak deri më tani numër më i vogël i incidenteve dhe prishjeve të RQP http://www.mvr.gov.mk/ShowAnnouncements.aspx?ItemID=13451&mid=1367&tabId=358&tabindex=0 (vizituar më 29 prill 2014)

79 Misioni Ndërkombëtar për Monitorimin e Zgjedhjeve në Ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, zgjedhje presidenciale dhe zgjedhje të parakohshme parlamentare, Deklaratë për të dhënat dhe konstatimet preliminare, Shkup 27 prill 2014. I aksesshëm: http://www.osce.org/mk/odihr/elections/fyrom/118079?download=true (vizita e fundit: 4 maj 2014)

80 Zaev: Ja se si Gruevski e vjedhë Maqedoninë. LSDM, pres-konferencë, 17 prill 2014, Shkup. I aksesshëm në: http://sdsm.org.mk/default.aspx?mId=55&agId=6&articleId=10484 (vizita e fundit: 6 maj 2014)

81 Llogaridhënie për punën e realizuar të Qeverisë të Republikës së Maqedonisë, e udhëhequr nga VMRO-DPMNE dhe partnerët e koalicionit 2011-2014, VMRO-DPMNE. I aksesshëm në: http://vmro-dpmne.org.mk/wp-content/uploads/documents/ParlOtcet-2014_online.pdf (vizita e fundit: 10 maj 2014)

82 E provuar, projekte të cilat realizohen me fakte VMRO-DPMNE. I aksesshëm në: http://vmro-dpmne.org.mk/wp-content/uploads/documents/VMRO%20programa%202014-2018%20v2a.pdf (vizita e fundit më: 10 maj 2014)

nga spotet muzikore zgjedhore dhe video spotet publikoheshin në Kanalin Jutub të partisë.

Koalicioni i udhëhequr nga partia më e madhe opozitare LSDM, e zhvillonte fushatën me sloganin "Ndryshime për fillim të ri". Partia botoi Program zgjedhor me 100 faqe[83] me titullin e njëjtë sikurse dhe slogani zgjedhor. Bartësit e listave të kandidatëve të koalicionit i theksonin të tre shtyllat mbi të cilat themelohej Programi zgjedhor. Shtylla e parë "Ta kthejmë klasën e mesme" i dedikohej masave ekonomike dhe tatimore, politikave për rishpërndarje dhe politikave për mbrojtje sociale dhe drejtësi. Shtylla e dytë e Programit ishte "Duam liri" në të cilën u përfshinë masat për avancimin e demokracisë, sundimin e së drejtës dhe luftën kundër korrupsionit. Shtylla e tretë mbante titullin "Investojmë në ardhmërinë" dhe u dedikohej masave për zhvillimin e shoqërisë, mundësimin e shanseve të barabarta për progres, kulturë, mjedisin jetësor, ndalimin e migrimit të të rinjve.

Fushata onlajn e LSDM-së zhvillohej përmes faqes së Internetit të partisë sdsm.org.mk, profileve zyrtare partiake të rrjeteve sociale Fejsbuk dhe Tuiter dhe përmes profileve personale të bartësve dhe kandidatëve të listave zgjedhore të koalicionit. Në këtë fushatë mbresëlënëse ishte që partia më së paku dy herë e bleu faqen e parë të Fejsbukut, në të cilën përdoruesit i shënonin fjalëkalimet për qasje deri te profilet në të cilën publikonte përmbajtjet e veta. Video regjistrimet nga mitingjet dhe takimet me qytetarët publikoheshin në Kanalin Jutub të partisë.

BDI-ja fushatën e saj zgjedhore e zhvilloi me sloganin "Bashkë më mirë, Bashkë më të fortë, Bashkë për Europë". Partia, gjithashtu, para fillimit të fushatës zgjedhore, publikoi llogaridhënie për aktivitetet e punës së ministrave të saj në koalicionin qeveritar[84] me VMRO-DPMNE. Në fillim të fushatës, BDI e botoi dhe publikoi Programin zgjedhor me 376 faqe[85]

[83] Ndryshime për një fillim të ri-Program zgjedhor, LSDM. I aksesshëm në: http://www.sdsm.org.mk/Default.aspx?mId=47&lId=1 (vizita e fundit: 11 maj 2013)

[84] Llogaridhënie e BDI, BDI, I aksesshëm në: http://bdi.mk/docs/RaportojmeBDI2014.pdf (vizita e fundit: 5 maj 2014)

[85] "Bashkë më mirë, Bashkë më të fortë, Bashkë për Europë", BDI. I akesshëm në: http://bdi.mk/docs/RaportojmeBDI2014.pdf (vizita e fundit: 5 maj 2014)



me titull identik sikur slogani zgjedhor. Programi, mes tjerash, fokusohej në premtimin për implementimin e plotë të Marrëveshjes Kornizë të Ohrit dhe përfaqësimin e drejtë të shqiptarëve në institucionet shtetërore, përdorimin e gjuhës shqipe në mbarë territorin e shtetit si gjuhë e dytë shtetërore, kërkesën për pozicionimin e shqiptarëve në funksione të larta udhëheqëse dhe inkorporimin e konceptit të konsensusit politik gjatë zgjedhjes së Presidentit të shtetit. BDI-ja në pjesën ekonomike të Programit parashikoi masa për reduktimin e papunësisë me krijimin e vendeve të reja të punës, avancimin e arsimit, shpërndarjen e drejtë të buxhetit në territorin e mbarë shtetit dhe përmirësimin e mjedisit jetësor.

Fushatën zgjedhore përmes Internetit, BDI, në pjesën më të madhe, e zhvilloi përmes faqes partiake bdi.mk, përmes profileve zyrtare partiake në rrjetin social Fejsbuk dhe përmes profileve të bartësve të listave zgjedhore dhe kandidatëve për deputetë. BDI në këto zgjedhje nuk kishte profil në rrjetin social Tuiter. Spotet muzikore zgjedhore dhe video spotet publikoheshin në Kanalin Jutub të partisë.

Partia PDSH gjatë fushatës zgjedhore u prezantua me sloganin "PDSH për Liri". Votuesve nuk u ofroi program zgjedhor, por Platformë për mandatin e ardhshëm të qeverisë me titull "Platforma e PDSH për periudhën 2014-2018",[86] me 105 faqe. Në të, mes tjerash, parashikoj nevoja për marrëveshje të re shoqërore, në vend të Marrëveshjes Kornizë të Ohrit, dhe shtet federal. Në mesin e masave të tjera, në të bëhet fjalë për eliminimin e diskriminimit ekonomik ndaj shqiptarëve, masa nga politika tatimore, fiskale dhe monetare, promovim të investimeve të huaja dhe vendase, zhvillim të bujqësisë dhe industrisë ushqimore dhe mbrojtje të mjedisit jetësor.

Partia, gjithashtu, zhvillonte fushatë në Internet përmes rrjeteve sociale. Në rastin e parë fushata zhvillohej kryesisht përmes faqes zyrtare gurra-pdsh.org, ndërsa në rrjetet Fejsbuk dhe Tuiter përmes profileve zyrtarë

[86] Platforma e PDSH për periudhën 2014-2018, PDSH. I aksesshëm në: http://gurra-pdsh.org/images/PDF/Platforma%20e%20PDSH-se%202014-2018.pdf (vizita e fundit: 10 maj 2014)

partiak dhe përmes profileve të bartësve dhe kandidatëve të listave zgjedhore. Regjistrimet nga ngjarjet janë distribuuar përmes Kanalit Jutub të partisë.

Koalicioni i udhëhequr nga OPQM (GROM) u prezantua me sloganin zgjedhore "Njerëz të guximshëm, shtet krenar". OPQM në fushatën zgjedhore promovoi Programin[87] i cili, siç pohonte lideri i partisë Stevçe Jakimovski është përpiluar nga kërkesat e qytetarëve në vend se nga ekspertët. Në të, partia, hapësirë më të madhe u përkushton projekteve nga sfera e stimulimit të sipërmarrësisë funksionale, ekonomisë së vogël dhe të mesme, qasjes më të madhe deri te mjetet kualitative financiare, mbështetjes të fermerëve dhe lehtësimeve tatimore, të cilat duhet t'i marrin ata në mënyrë që të reduktohen shpenzimet e prodhimit për bujqësi konkurrente. Programi përfshin edhe propozime për mbështetjen e grupeve të rrezikuara sociale.

OPQM ngjashëm si edhe partitë e tjera, gjatë fushatës i përkushtoi vëmendje promovimit onlajn, me ç'rast pjesë qendrore ishte faqja partiake e Internetit grom.mk, profilet Fejsbuk dhe Tuiter të partisë si dhe profilet e bartësve dhe kandidatëve nga listat zgjedhore.

Partia RDK, në zgjedhje u prezantua me sloganin "Është koha". Partia, në fillim të fushatës para votuesve nuk prezantoi program klasik zgjedhor, por doli me Platformë zgjedhore me 33 faqe[88] me titull identik sikurse edhe slogani i fushatës, në Platformë RDK-ja parashikonte reforma të institucioneve qeveritare, punësim, zhvillim të biznesit, infrastrukturës, energjetikës, turizmit, zonave industriale dhe teknologjike, bujqësisë dhe bashkëpunimit me dhomat ekonomike.

RDK, një pjesë të resurseve të veta ia përkushtoi zhvillimit të fushatës në Internet. Vend qendror kishte faqja zyrtare e partisë rdk.ord.mk, ndërsa fushata zhvillohej edhe përmes profileve në Fejsbuk dhe Tuiter.

87 Programi zgjedhor i OPQM 2014-2018, OPQM. I aksesshëm në: http://issuu.com/gragjanskaopcijazamakedonijagrom/docs/programa_grom_a4_8_a_pripremа?e=9598897/7512073 (vizita e fundit: 10 maj 2014)

88 Platforma zgjedhore, Është koha për RDK, RDK. I akesshëm në: http://www.rdk.org.mk/images/stories/PDF/platforma.pdf (vizita e fundit: 11 maj 2014)



Edhe partitë më të vogla, të cilat morën pjesë në zgjedhje, organizuan fushata të ngjashme, por në përmasa më të vogla. Në përgjithësi ato në masë më të madhe u orientuan në takime të vogla me qytetarët, reklama zgjedhore dukshëm më të vogla në mediat tradicionale dhe prezencë në rrjetet sociale në Internet të cilat u mundësonin falas, ose në masë të konsiderueshme mënyrë më të lirë të promovimit.

## Paraqitja e raporteve financiare

Për shpenzimet, që i kishin gjatë fushatës zgjedhore, partitë e kanë për detyrë të paraqesin gjithsej tre raporte financiare. Raporti i parë, i cili ka të bëjë me 10 ditët e para të fushatës, kandidatët e kishin për detyrë ta paraqesin në ditën e 11-të të fushatës, përkatësisht më 14 prill. Raportin e dytë, kandidatët e kishin për detyrë ta paraqesin një ditë pas përfundimit të fushatës, më 26 prill dhe i njëjti ka të bëjë me gjysmën e dytë të fushatës. Të gjitha partitë i paraqitën me kohë raportet financiare, me përjashtim të partisë LSDM, e cila raportin e dytë e paraqiti me një vonesë prej tre ditësh, përkatësisht më 29 prill edhe atë jo në formular të standardizuar për këtë dedikim por vetëm me deklaratë me shkrim nga kryetari i partisë. Në faqet zyrtare të KSHZ dhe Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KSHPK) mungon raporti i dytë financiar i PPD-së. Mund të gjendet vetëm raporti për pjesën e dytë të fushatës edhe atë në formë të ekstraktit të llogarisë bankare në vend të formularit të përcaktuar. Nëse partitë nuk i paraqesin raportet e specifikuara në formën e përcaktuar dhe në afatet e caktuara dënimi është në lartësi prej 4000 deri në 5000 euro për personin juridik dhe 500 deri më 1500 euro për personin përgjegjës në parti.

Raporti i tretë financiar, i cili ka të bëjë me raportet e përgjithshme financiare, lidhur me mjetet e grumbulluara dhe të shpenzuara, partitë duhet t'i paraqesin më së voni deri më 20 maj, përkatësisht 25 ditë nga përfundimi i fushatave, ndërkaq Enti Shtetëror i Revizionit (ESHR) më së voni deri më 14 korrik duhet të zbatojë revizion mbi këto raporte.

Të gjitha raportet financiare paraqiten pranë KSHZ, KSHPK dhe ESHR, ndërsa raporti i përgjithshëm financiar paraqitet edhe pranë Kuvendit të Republikës së Maqedonisë. Kandidatët kanë të drejtë të shpenzojnë nga 180 denarë për një votues të regjistruar, përkatësisht gjithsej 320.423.040 denarë (5.210.130 euro).[89]

Sipas raporteve të paraqitura financiare[90] nga partitë të cilat kanë fituar mandate në Kuvend më së shumti mjete gjatë fushatës zgjedhore ka shpenzuar VMRO-DPMNE. Sipas të dy raporteve të paraqitur deri te institucionet, partia, në të dyja pjesët e fushatës, ka shpenzuar 44.764.480 denarë, përkatësisht gjithsej 89.528.960 denarë (1.455.755 euro). Partia, deri më 26 prill, ka grumbulluar 16.652.976 denarë që është 72.875.984 denarë më pak nga mjetet e shpenzuara. Që të kompensohen dallimet e këtilla partitë mund t'i grumbullojnë donacionet më së voni deri më 20 maj kur do ta paraqesin raportin final financiar.

Partia e dytë sipas mjeteve të shpenzuara është BDI. Ajo, gjatë fushatës zgjedhore, ka shpenzuar gjithsej 30,885,783 denarë, përkatësisht 18,957,018 denarë në pjesën e parë dhe 11,928,765 denarë në pjesën e dytë. BDI, gjithashtu, deri në paraqitjen e raportit të dytë ka grumbulluar më pak mjete sesa që ka shpenzuar. Partia ka grumbulluar gjithsej 6,499,500 denarë (105,682 euro), ndërsa dallimin duhet ta grumbullojë deri më 20 maj.

Partia e tretë sipas të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë fushatës është LSDM. Partia, në të dyja pjesët e fushatës, ka grumbulluar gjithsej 8,402,077 denarë (136,619 euro). Tek kjo parti ka dallim të konsiderueshëm sa u përket shpenzimeve në të dyja pjesët. Në pjesën e parë, LSDM ka shpenzuar 8,028,077 denarë, ndërsa në rrethin e dytë vetëm 374,000 denarë. Partia, deri më 25 prill, ka grumbulluar gjithsej 8,418,067 denarë, përkatësisht 15,990 denarë më shumë sesa që ka

89 Përllogaritjet në euro janë bërë sipas kursit të mesëm prej 61,5 denarë për 1 euro

90 Raporti financiar nga partitë politike për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare 2014, Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve. I aksesshëm në: http://www.sec.mk/index.php?option=com_content&view=article&id=322:fin-izv-pretvremeni&catid=48&Itemid=1305&lang=mk (vizita e fundit: 7 maj 2014)



shpenzuar. Sipas ligjit, tepricën e mjeteve partia duhet ta dhurojë për qëllime bamirësie.

Partia e radhës është OPQM, e cila ka shpenzuar gjithsej 990,009 denarë (16,097 euro), përkatësisht 938,310 në pjesën e parë dhe 51,699 denarë në pjesën e dytë të fushatës. Partia, deri më 25 prill, ka grumbulluar gjithsej 992,412 denarë ose 2,403 denarë më shumë sesa që ka shpenzuar. OPQM gjithashtu, këto mjete duhet t'i dhurojë për qëllime bamirësie.

Partia RDK gjatë fushatës zgjedhore ka shpenzuar gjithsej 448,120 denarë (7,286 euro), përkatësisht 139,650 në pjesën e parë dhe 308,470 denarë në pjesën e dytë të fushatës. Deri më 26 prill, kur edhe është paraqitur raporti i dytë financiar, RDK ka grumbulluar 202,350 denarë ose 245,770 denarë më pak sesa që ka shpenzuar. Po ashtu, sikurse edhe partitë e tjera, dallimin duhet ta grumbullojë më së voni deri më 20 maj.

PDSH gjatë fushatës ka shpenzuar gjithsej 382,626 denarë (6,221 euro), përkatësisht 130,626 në pjesën e parë dhe 252,000 denarë në pjesën e dytë. Partia, deri më 26 prill, ka grumbulluar gjithsej 90,000 denarë. Dallimi prej 292,626 denarë, midis mjeteve të shpenzuara dhe të grumbulluara, PDSH përmes grumbullimit të donacioneve duhet ta barazojë deri më 20 maj, përkatësisht deri në paraqitjen e raportit final financiar.

Nga partitë e tjera të cilat morën pjesë në zgjedhje, mirëpo nuk arritën të fitojnë mandat të deputetit, shpenzime më të mëdha kishte Koalicioni "Për Maqedoni Pozitive" (KMP) dhe partia VMRO-PP. KMP në të dyja pjesët e fushatës ka shpenzuar gjithsej 6,798,930 denarë (110,551 euro), ndërkaq ka grumbulluar 6,224,706 denarë. VMRO-PP ka shpenzuar gjatë fushatës 3,616,080 denarë (58,798 euro), ndërkaq ka grumbulluar 3,787,900 denarë. Shpenzimet e përgjithshme të të gjitha partive të tjera, PAE, PNE 21, LPM, LM dhe PSDM bashkërisht kapin shifrën prej 585,813 denarë (9,525 euro), ndërsa të gjithë së bashku kanë grumbulluar 132,100 denarë (2,147 euro). Dallimin midis shpenzimeve dhe të ardhurave partitë duhet ta kompensojnë përmes donacioneve deri më 20 maj. Së

këtejmi, partitë PAE dhe PSDM në raportet e tyre kanë theksuar se nuk kanë grumbulluar e as që kanë shpenzuar mjete financiare ose mjete të tjera gjatë fushatës, ndërsa LM ka grumbulluar 3000 denarë (48 euro) por nuk ka shpenzuar fare.

| | VMRO-DPMNE | | LSDM | | BDI | | PDSH | | OPQM | | RDK | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Të ardhura | Shpenzime | Të ardhura | Shpenzime | Të ardhura | Shpenzime | Të ardhura | Shpenzime | Të ardhura | Shpenzime | Të ardhura | Shpenzime |
| Data e raportit të parë - 14 prill | 8,326,488 | 44,764,480 | 8,054,000 | 8,028,077 | 2,699,500 | 18,957,018 | 60,000 | 130,626 | 942,695 | 938,310 | 150,000 | 139,650 |
| Data e raportit të dytë - 26 prill | 8,326,488 | 44,764,480 | 364,067 | 374,000 | 3,800,000 | 11,928,765 | 30,000 | 252,000 | 49,717 | 51,699 | 52,350 | 308,470 |
| Gjithsej | 16,652,976 | 89,528,960 | 8,418,067 | 8,402,077 | 6,499,500 | 30,885,783 | 90,000 | 382,626 | 992,412 | 990,009 | 202,350 | 448,120 |

## MEDIAT

Monitorimi i mediave, i zbatuar nga OSBE/ODIHR[91] gjatë fushatës së zgjedhjeve parlamentare vërejti "mungesë të analizës dhe raportime të pavarura" gjatë raportimeve për aktivitetet e partive politike. Në përgjithësi, Misioni i OSBE/ODIHR në raportin e vet ka nënvizuar se pjesa më e madhe e mediave, mbi të cilat është zbatuar monitorimi, në masë të madhe, ishin të njëanshme në favor të partisë në pushtet VMRO-DPMNE dhe kandidatit presidencial Ivanov dhe kryesisht negative ndaj LSDM-së dhe kandidatit të saj presidencial. Mediat në gjuhën shqipe më shumë ishin të njëanshme ndaj BDI-së sesa ndaj pjesëmarrësve të tjerë etnikë shqiptar në garën zgjedhore. Monitorimi tregoi se mediat, gjatë fushatës, më së shumti janë fokusuar mbi dy partitë më të mëdha politike VMRO-DPMNE dhe LSDM.

[91] Shih: Deklaratat e OSBE/ODIHR për të dhënat dhe konkluzionet preliminare të zgjedhjeve. OSBE/ODIHR, Misioni Ndërkombëtar Monitorues i zgjedhjeve në Republikën e Maqedonisë, Zgjedhje Presidenciale dhe Zgjedhje të Parakohshme Parlamentare, 27 prill 2014, Deklaratë për të dhënat dhe konkluzionet preliminare, Shkup, prill, i aksesshëm në: http://www.osce.org/mk/odihr/elections/fyrom/118079?download=true (vizituar më 13 maj 2014).

Në kuadër të raportimeve të këtilla të servisit publik Radiotelevizioni Maqedonas (RTVM), përderisa të gjithë pjesëmarrësit e tjerë në zgjedhje janë mbuluar në mënyrë neutrale, partitë në pushtet kanë pasur një mbulim më pozitiv. Kështu, partia VMRO-DPMNE kishte përparësi me atë që ka pasur mbulim pozitiv mediatik në të cilin janë theksuar të arriturat e saj dhe projektet e ardhshme. Qasje të ngjashme ka pasur edhe kanali i dytë i RTVM (RTVM2), i cili transmeton programe në gjuhët e bashkësive joshumicë sa i përket partisë BDI. Monitorimi i OSBE/ODIHR i përfshiu mediat elektronike RTVM1, RTVM2, TV Sitel, TV Kala 5, TV Alfa, TV Telma dhe TV Alsat-M, dhe mediat e shkruara: Dnevnik, Nova Makedonia, Sloboden Peçat dhe Koha.

Sa u përket radiodifuzerëve privat, monotrimi i OSBE/ODIHR tregoi se televizionet: Sitel, Kanal 5 dhe Alfa, vëmendje më të madhe i kanë përkushtuar aktiviteteve të VMRO-DPMNE, kryesisht me një mbulim pozitiv ose neutral mediatik. Nga ana tjetër, sa i përket LSDM-së mediat e njëjta i kanë përkushtuar më pak kohë mbulimit i cili kryesisht ka qenë me tone negative. Në raportin e Misionit vërehet se gjatë fushatës këto tre televizione kanë siguruar mbulim të konsiderueshëm mediatik të aktiviteteve të ministrave të cilët ishin edhe kandidatë për deputetë e që po ashtu shpesh është bërë në mënyrë pozitive. Së këtejmi, vërehet se mediat, në masë të madhe, nuk kanë bërë dallime midis mbulimit të këtyre personave si ministra dhe si kandidatë në zgjedhje.

Sipas Kodit Zgjedhor, mediat e kanë për detyrë të raportojnë për kandidatët e zgjedhjeve presidenciale, në mënyrë të drejtë, të balancuar dhe të paanshme. Nga ana tjetër, me ndryshimet e fundit të Kodit Zgjedhor, nga muaji shkurt i vitit 2014, u inokorporuan rregulla të reja lidhur me raportimin mediatik në lajmet e servisit publik radiodifuziv "Radiotelevizionit Maqedonas" (RTVM). Sipas ndryshimeve, servisi publik radiodifuziv e ka për detyrë që kohën për raportim ta shpërndajë në këtë mënyrë: një e treta e kohës dedikohet për raportimin e ngjarjeve ditore nga vendi dhe bota; një e treta e kohës i dedikohet raportimit të aktiviteteve të fushatës së kandidatëve të partive politike në pushtet;

dhe një e treta e kohës i dedikohet raportimit të aktiviteteve të fushatës zgjedhore të kandidatëve të partive politike nga opozita. Koha, e cila i përcaktohet çdo partie, varet nga rezultatet dhe mandatet e fituara në zgjedhjet e fundit parlamentare. Siç është theksuar në deklaratën e të dhënave dhe konkluzioneve preliminare të zgjedhjeve presidenciale dhe të parakohshme parlamentare të OSBE/ODIHR, kjo mënyrë e shpërndarjes nuk korrespondon me paragrafin 7.8 të Dokumentit të Kopenhagës të OSBE-së meqë krijon pengesa për ndarjen e kohës për raportimin mediatik të kandidatëve të partive jashtëparlamentare. Megjithatë, MRTV ndau kohë shtesë jashtë kohës së parashikuar nga një e treta edhe për përfaqësuesit e partive jashtëparlamentare, në bazë të rekomandimit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive (ASHMAA).

## Monitorimi mbi servisin publik RTVM

ASHMAA, si organ kompetent për monitorimin e raportimeve të mediave në periudhën zgjedhore, në raportin e fundit[92] publikoi se servisi publik radiodifuziv për raportimet e zgjedhjeve parlamentare ka mundësuar mbulim mediatik në emisionet informative të kandidatëve, në kuadër të obligimeve ligjore. Sipas raportit, në përgjithësi është respektuar ndarja e një të tretës së kohës ndërmjet lajmeve nga vendi dhe bota, lajmeve për kandidatët e pushtetit dhe lajmeve për kandidatët e opozitës, si dhe për kohën shtesë për partitë jashtëparlamentare. Së këtejmi, në këtë kanal vërehet ekzistimi i dallimit të vogël sa i përket minutazhës së mbulimit. Në programin e parë të servisit publik RTVM1, partitë e pushtetit kanë pasur 6 minuta më shumë kohë në krahasim me partitë opozitare. Partitë e pushtetit gjithsej kanë pasur 2:16 orë, ndërsa opozita 2:10, ndërkaq 2:29 e kohës i është përkushtuar lajmeve nga vendi dhe bota, kurse koha shtesë për partitë jashtëparlamentare ka qenë 18 minuta.

92 Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive (2014) Raport për monitorimin e mbulimit mediatik për zgjedhjet presidenciale dhe zgjedhjet e parakohshme parlamentare. Shkup, maj, i aksesshëm në: http://www.avmu.mk/images/Finalen_Izvestaj_Izbori_2014_-_nacionalni_mediumi.pdf (vizituar më 13 maj 2014).



**Tabela 1:** Subjektet në lajmet e serviseve programore të TVM dhe RM Burimi: ASHMAA

| | TVM 1 | TVM 2 | TVM 2 | Radio maq. | Radio maq. (në gjuhën shqipe) | Radio maq. në gjuhën turke) |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **LSDM e të tjerë** | 50,31% | 13,03% | 29,90% | 48,30% | 13,65% | 24,51% |
| **VMRO-DPMNE e të tjerë** | 68,15% | 13,75% | 35,33% | 37,83% | 9,34% | 37,28% |
| **PDSH** | 13,25% | 50,96% | 19,58% | 11,05% | 50,64% | 11,25% |
| **BDI** | 19,24% | 78,41% | 23,73% | 19,72% | 77,65% | 8,58% |
| **RDK** | 1,32% | 15,98% | | 2,24% | 16,44% | 2,08% |
| **PPD** | 2,04% | 58,61% | | | 57,59% | |
| **VMRO PP** | 19,22% | 8,61% | 6,34% | 22,49% | | 11,71% |
| **Koalicioni OPQM** | 23,38% | 12,64% | 65,15% | 24,03% | 10,68% | 54,66% |
| **KMM** | 29,23% | | 7,79% | 24,73% | | 16,70% |
| **Dinjiteti** | 20,55% | | | 12,60% | | 3,25% |
| **OPQM** | 1,59% | | | | | |

Në bazë të monitorimit të Agjencisë, e cila para së gjithash, në mënyrë kuantitative, por edhe kualitative e matë përfaqësimin e subjekteve politike të servisit publik RTVM, ceket se në kanalin RTVM 1 një e treta e kohës kushtuar fushatës së partive në pushtet është ndarë në mënyrën si vijon: Koalicioni i VMRO-DPMNE ka pasur 68,15% të kohës, BDI 19,24%, USD 0,39, ndërsa koha tjerë i është kushtuar kandidatit presidencial të VMRO-DPMNE Gjorge Ivanov. Koha që i është kushtuar mbulimit të ngjarjeve të opozitës është ndarë në këtë mënyrë: Koalicioni i LSDM ka pasur 50,31%, PDSH 13,25%, RDK 1,32%, kandidatit presidencial të LSDM, Stevo Pendarovski 31,74% dhe për Iljaz Halimin, kandidati presidencial i PDSH 3,38%.

Nga koha shtesë për partitë jashtëparlamentare KMM ka pasur 29,23%, Koalicioni OPQM 23,38%, DM 20,55%, VMRO-PP 19,22%, PPD 2,04% dhe

kandidati presidencial i OPQM Zoran Popovski ka pasur 3,99% nga koha e mbulimit mediatik.

Në kanalin e dytë të servisit publik RTVM 2, i cili transmeton program në gjuhën shqipe, koha është shpërndarë gjithashtu me nga një të tretat, me dallim të vogël në minutazh kushtuar mbulimit mediatik të aktiviteteve të partive. Kështu, marrë në përgjithësi, partitë në pushtet kanë pasur gjithsej 3:29 orë, opozita 3:17, për lajmë janë ndarë 2:44, ndërsa koha shtesë për partitë jashtëparlamentare ka qenë 24 minuta.

Në kuadër të kohës së shpërndarë për mbulimin mediatik të RTVM 2, tek partitë në pushtet vëmendje më të madhe ka pasur BDI 78,41%, Koalicioni i VMRO-DPMNE 13,75%, kandidati presidencial Gjorge Ivanov 7,70% dhe 0,13% e kohës mediatike u është kushtuar subjekteve të tjera. Në një të tretën e paraparë për opozitën më së shumti kohë ka pasur PDSH 50,96%, pastaj RDK 15,98%, Koalicioni i LSDM 13,03%, kandidati presidencial i PDSH, Iljaz Halimika ka pasur 13,42%, ndërsa kandidati i LSDM, Stevo Pendarovski 6,61%. Në kohën shtesë më e pranishme ka qenë PPD 58,61%, OPQM 12,64%, VMRO-PP me 8,61% dhe kandidati presidencial i OPQM, Zoran Popovski ka pasur 20,14%.

Monitorimi ka treguar se gjendja është e ngjashme edhe në Radion Maqedonase. Servisi i parë programor e ka respektuar obligimin për përfaqësim sipas përqindjes së subjekteve politike. Servisi i tretë programor i Radios Maqedonase – Programi në gjuhën shqipe ka siguruar qasje të balancuar të pjesëmarrësve në fushatën zgjedhore, por ka ndarë diç më pak kohë për ngjarjet e ditës. Servisi i tretë programor i Radios Maqedonase – Programi në gjuhën turke, gjithashtu në përgjithësi ka ndarë kohë të njëjtë për fushatat e partive, por nuk e ka respektuar parimin për ndarjen e programit sipas një të tretave me atë që për lajmet e ditës nga vendi dhe bota ka ndarë shumë më shumë kohë sesa për fushatat.

Sipas metodologjisë për monitorimin e raportimit mediatik gjatë fushatës zgjedhore ASHMAA i mat edhe prezantimet e drejtpërdrejta të përfaqësuesve të opsioneve politike në media. Kjo, sipas ASHMAA, merret si një parametër kualitativ për mbulimin e fushatave edhe pse me këtë rast, për mbulimin mediatik të servisëve publik, nuk janë dhënë vlerësime kualitative në bazë të këtij parametri por, vetëm është shënuar numri dhe kohëzgjatja e përgjithshme e prezantimeve të drejtpërdrejta.

**Tabela 2:** Prezantime të drejtpërdrejta në serviset programore të TVM dhe RM Burimi: ASHMAA

| | **TVM 1** | | **TVM 2 në gjuhën shqipe** | | **Radio maq.** | | **Radio maq. (në gjuhën shqipe)** | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Prezantime | Koha | Prezantime | Koha | Prezantime | Koha | Prezantime | Koha |
| **LSDM e të tjerë** | 32 | 0:21:56 | 16 | 0:07:59 | 15 | 0:12:10 | 15 | 0:08:20 |
| **VMRO-DPMNE e të tjerë.** | 38 | 0:31:05 | 16 | 0:07:45 | 17 | 0:12:08 | 14 | 0:07:17 |
| **PDSH** | 19 | 0:05:28 | 30 | 0:37:21 | 16 | 0:03:10 | 21 | 0:32:15 |
| **BDI** | 23 | 0:07:54 | 51 | 1:34:57 | 16 | 0:05:28 | 26 | 0:47:38 |
| **RDK** | 6 | 0:01:05 | 17 | 0:09:32 | 8 | 0:01:02 | 15 | 0:07:56 |
| **PPD** | 1 | 0:00:16 | | | | | 1 | 0:00:18 |
| **VMRO PP** | 7 | 0:02:45 | | | 9 | 0:03:18 | | |
| **Koalicioni OPQM** | 8 | 0:03:14 | | | 13 | 0:03:51 | 1 | 0:00:25 |
| **KMM** | 10 | 0:04:04 | | | 10 | 0:03:42 | | |
| **Dinjiteti** | 8 | 0:02:54 | | | 5 | 0:01:48 | | |

## Monitorimi i mediave komerciale

Në kontekst të mediave komerciale ASHMAA në raport konstaton një përqasje të ndryshme gjatë raportimeve nga fushatat zgjedhore. Për televizionin 24 Vesti në përgjithësi konstatohet se ka raportuar në mënyrë të balancuar dhe profesionale, duke e respektuar parimin e proporcionalitetit në përfaqësimin e pushtetit, opozitës dhe partive jashtëparlamentare, me këtë rast duke raportuar me tone neutrale në kontributet e tyre. Televizioni ka pasur qasje profesionale analitike rreth çështjeve të cilat kanë qenë të hapura në fushata dhe ka bërë një sërë analizash komparative.

TV Alsat – M, sipas ASHMAA, nuk e ka respektuar me konsekuencë parimin e proporcionalitetit dhe pak më shumë kohë u është përkushtuar partive të shqiptarëve në Maqedoni, nga të cilat me intensitet më të madh për BDI. Për një pjesë të pjesëmarrësve të fushatës zgjedhore, media fare nuk ka publikuar informacione. Televizioni, në raportet gazetareske, në përgjithësi i ka respektuar standardet profesionale, edhe pse mundësi më të mëdha për t'u prezantuar drejtpërdrejtë para publikut kanë pasur përfaqësuesit e BDI-së.

**Tabela 3:** Subjektet në lajmet e radiodifuzerëve komercial
Burimi: ASHMAA

| | TV 24 Vesti | TV ALSAT-M | TV ALFA | TV KANAL 5 | SITEL | TV TELMA |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **LSDM e të tjerë** | 1:16:18 | 1:15:58 | 0:45:59 | 1:02:03 | 0:32:44 | 1:36:24 |
| **VMRO-DPMNE e të tjerë** | 1:18:35 | 1:11:42 | 3:44:42 | 5:11:45 | 5:36:12 | 1:19:44 |
| **PDSH** | 0:21:30 | 1:25:04 | 0:13:09 | 0:19:14 | 0:19:27 | 0:23:44 |
| **BDI** | 0:29:24 | 1:58:13 | 0:19:08 | 0:25:42 | 0:22:49 | 0:43:18 |
| **RDK** | 0:01:31 | 0:17:17 | | 0:02:30 | | 0:23:44 |
| **PPD** | 0:00:48 | | 0:00:48 | | 0:00:33 | |
| **VMRO PP** | 0:15:45 | 0:15:11 | 0:02:42 | | 0:02:09 | 0:29:40 |
| **Koalicioni OPQM** | 0:18:38 | | 0:08:24 | 0:19:32 | 0:19:08 | 0:13:49 |
| **KMM** | 0:11:18 | | 0:02:35 | | 0:11:16 | 0:13:15 |
| **Dinjiteti** | 0:09:05 | | | | | 0:10:25 |
| **PNE 21** | 0:01:31 | | | | | |
| **PSDM** | 0:01:31 | | | | | |

Po ashtu, televizioni ALFA nuk e ka respektuar parimin e proporcionalitetit gjatë mbulimit të fushatave të partive politike. Kohë më të madhe informative ALFA u ka kushtuar aktiviteteve të Koalicionit të udhëhequr nga VMRO-DPMNE. Në raportin e ASHMAA bëhen vërejtje se parashikimet e perceptimeve të ekspertëve për hulumtimin e opinionit publik, si dhe komentet e medias – për temë qendrore e kanë pasur krahasimin e platformave zgjedhore të koalicioneve oponente – të Koalicionit qeveritar VMRO-DPMNE dhe të koalicionit opozitar LSDM. Me këtë rast, është vërejtur qëndrim eksplicit negativ të redaksisë në raport me opsionin opozitar.

TV Kanal 5, ka ndarë minutazh dominuese për mbulimin e fushatës së VMRO-DPMNE dhe Koalicionit. Monitorimi ka vënë në pah se vëmendja redaktuese e televizionit është orientuar kah nënvizimi i kontrastit të fuqishëm komparativ ndërmjet programeve zgjedhore të VMRO-DPMNE dhe të LSDM. Së këtejmi, komentet e redaksisë kanë qenë kryesisht negative për politikat e LSDM.

**Tabela 4:** Prezantime të drejtpërdrejta në programet e radiodifuzerëve komercial Burimi: ASHMAA

| | TV 24 Vesti | | TV ALSAT-M | | TV ALFA | | TV KANAL 5 | | SITEL | | TV TELMA | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Prezantime | Koha | Prezantime | Koha | Prezantime | Koha | Prezantime | Koha | Prezantime | Koha | Prezantime | Koha |
| **LSDM e të tjerë** | 52 | 0:33:11 | 54 | 0:33:14 | 118 | 2:09:16 | 116 | 3:19:25 | 28 | 0:12:31 | 47 | 0:52:17 |
| **VMRO-DPMNE e të tjerë** | 48 | 0:29:19 | 43 | 0:24:35 | 37 | 0:19:48 | 41 | 0:27:15 | 131 | 3:42:28 | 38 | 0:43:20 |
| **PDSH** | 18 | 0:08:16 | 60 | 0:38:04 | 11 | 0:05:52 | 22 | 0:11:02 | 18 | 0:08:43 | 20 | 0:17:17 |
| **BDI** | 24 | 0:12:09 | 75 | 0:55:00 | 14 | 0:07:47 | 25 | 0:14:19 | 19 | 0:09:26 | 25 | 0:28:45 |
| **RDK** | 1 | 0:00:27 | 12 | 0:08:39 | | | | | | | 1 | 0:01:07 |
| **PPD** | 1 | 0:00:36 | | | | | 2 | 0:00:56 | | | | |
| **VMRO PP** | 11 | 0:08:23 | 8 | 0:07:01 | 2 | 0:01:11 | | | 2 | 0:00:54 | 15 | 0:14:07 |
| **Koalicioni OPQM** | 19 | 0:09:44 | | | 8 | 0:04:09 | 15 | 0:13:30 | 14 | 0:07:11 | 10 | 0:10:26 |
| **KMM** | 10 | 0:07:16 | | | 3 | 0:01:39 | | | 17 | 0:08:01 | 8 | 0:10:03 |
| **Dinjiteti** | 10 | 0:04:59 | | | | | | | | | 7 | 0:06:47 |
| **PNE 21** | 1 | 0:00:13 | | | | | | | | | | |
| **PSDM** | 2 | 0:00:14 | | | | | | | | | | |

Raporti i ASHMAA nga monitorimi i TV Sitel tregon se ky televizion nuk ka raportuar në mënyrë të balancuar, sepse i ka përkushtuar minutazh shumë më të madhe fushatës së VMRO-DPMNE sesa LSDM-së. Për ilustrim, mbulimi i përgjithshëm mediatik i ngjarjeve të partisë në pushtet ka qenë 5 orë e 36 minuta, ndërsa për partinë opozitare LSDM vetëm 32 minuta.

Sipas ASHMAA kjo i referohet mënyrës me të cilën ka raportuar SITEL për fushatën e VMRO-DPMNE, në të cilën përveç raporteve klasike nga mitingjet, thekset politikë të këtij koalicioni janë prezantuar edhe përmes bisedave dhe intervistave me udhëheqësinë e VMRO-DPMNE, ose me kryetarët e komunave nga radhët e Partisë, pastaj përmes kontributeve nga deklaratat e bashkuara të bartësve të listave të deputetëve në njësitë zgjedhore, dhe me raporte nga konferencat për shtyp. Televizioni, në zhanret analitike, në mënyrë komparative i analizonte programet zgjedhore të VMRO-DPMNE dhe të LSDM, dhe supozimet për pasojat shoqërore nëse lideri i opozitës vendos ta bojkotojë procesin zgjedhor. ASHMAA konstaton se qëndrimi i redaksisë informative i TV Sitel, gjatë gjithë procesit zgjedhor ka qenë në dobi të konceptit programor të partisë në pushtet, ndërsa në mënyrë eksplicite kundër prezantimeve zgjedhore të koalicionit opozitar.

TV Telma, sipas raportit të ASHMAA, në përgjithësi ka qenë e balancuar, me dallim prej disa minutash në dobi të LSDM në kohëzgjatje të mbulimit mediatik të fushatave zgjedhore të pushtetit dhe opozitës. Televizioni kohë të konsiderueshme i ka kushtuar punës së KSHZ-së dhe qëndrimeve të vëzhguesve vendas dhe të huaj, si dhe aferës rreth shitjes së "Makedonska banka". Këtë temë, Telma e ka trajtuar me informacione bazë nga pres-konferencat polemizuese midis LSDM dhe VMRO-DPMNE. Vlerësohet se televizioni, gjatë raportimit për procesin zgjedhor, në përgjithësi i ka kushtuar vëmendje në mënyrë të barabartë prezantimit të opsioneve të ndryshme politike të ofruara nga pjesëmarrësit në fushatën zgjedhore.

## REZULTATE NGA ZGJEDHJET E PARAKOHSHME PARLAMENTARE 2014[93]

Në zgjedhjet e parakohshme parlamentare të cilat u mbajtën më 27 prill të vitit 2014 bashkë me rrethin e dytë të zgjedhjeve presidenciale, të drejtën e votës e shfrytëzuan 1.120.640 votues nga gjithsej 1.780.128 votues sa janë regjistruar në Listën e Zgjedhësve. Sipas kësaj, dalja në zgjedhje ishte 62,95% e që është pothuajse identike me Zgjedhjet e Paraprake të Parakohshme Parlamentare, të cilat u mbajtën më 5 qershor të vitit 2011, kur dalja në zgjedhje ishte 63,48%. Megjithatë, në ato zgjedhje votuan 1.156.049 votues, përkatësisht 35.409 votues më shumë, mirëpo atëherë edhe Lista e Zgjedhësve (LZ) ishte më e madhe, përkatësisht kapte shifrën prej 1.821.122 persona me të drejtë vote. LZ, në periudhën para Zgjedhjeve Lokale të vitit 2013, u pastrua nga personat që kishin ndërruar jetë dhe nga personat e shpërngulur, me ç'rast numri i votuesve u reduktua për mbi 80 mijë persona në territorin e RM-së. Në periudhën para mbajtjes së zgjedhjeve presidenciale dhe zgjedhjeve parlamentare të vitit 2014 LZ edhe një herë u azhurnua dhe u vu në këqyrje publike të qytetarëve dhe partive, mirëpo KSHZ publikisht nuk i shpalli rezultatet e procesit.[94]

Në zgjedhjet, për mandate në Kuvend, lista të kandidatëve paraqitën 14 subjekte politike prej të cilave 5 ishin koalicione dhe 9 parti politike të cilat morën pjesë në mënyrë të pavarur. Lista të kandidatëve paraqitën "Koalicioni për LSDM dhe parti të tjera" i udhëhequr nga LSDM, PDSH, Koalicioni "Për Maqedoni Dinjitoze" i përbërë nga partitë: "Dinjiteti" dhe "Të Bashkuar për Maqedoninë" (BM), BDI, Koalicioni "Për Maqedoni më të Mirë" i udhëhequr nga VMRO-DPMNE, RDK, LPM, "Koalicioni OPQM" i udhëhequr nga partia OPQM, "Koalicioni për Maqedoni Pozitive" i udhëhequr nga Aleanca për Maqedoni Pozitive (AMP), VMRO-PP, PSDM, PNE 21, PPD dhe PAE.

Sipas të dhënave përfundimtare dhe zyrtare të KSHZ-së, më së shumti vota në Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare të 27 prillit të vitit 2014, fitoi Koalicioni "Për Maqedoni më të Mirë", i udhëhequr nga partia në pushtet VMRO-DPMNE ose 481.615 vota e që është 42,97% nga numri i përgjithshëm i votave. Sipas kësaj, Koalicioni fitoi 61 mandate të deputetëve. Në vend të dytë është koalicioni i udhëhequr nga partia

[93] Për të gjitha të dhënat lidhur me rezultatet e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare është përdorur faqja e internetit e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve. I aksesshëm në: http://rezultati.sec.mk/Parliamentary/Results?cs=mk-MK&r=2&rd=r# (vizituar më: 6 maj 2014)

[94] Zgjedhje Presidenciale dhe Zgjedhje të Parakohshme Parlamentare 2014, Deklaratë preliminare. Asociacioni Qytetar MOST, 28 prill 2014, Shkup. I aksesshëm në: http://www.most.org.mk/images/MOST/Preliminarna%20izjava_vtor%20krug_28%2004%202014_MKD.pdf (vizituar më: 13 maj 2014)

opozitare LSDM, e cila fitoi rreth 200.000 vota më pak, përkatësisht fitoi gjithsej 283.955 vota e që është 25,34 % nga numri i përgjithshëm i votave dhe fitoi 34 mandate të deputetëve. Në vend të tretë është BDI, e cila deri më tani ishte pjesë e koalicionit qeveritar. Për listat e kandidatëve të saj votuan gjithsej 153.646 votues, e që është 13,71 % nga numri i përgjithshëm i votave dhe sipas kësaj fituan 19 mandate të deputetëve në Kuvend. Rivali i saj kryesor PDSH, nga blloku i partive politike shqiptare në Maqedoni fitoi 66.393 vota e që është 5,92 % nga numri i përgjithshëm i votave. PDSH-ja në legjislaturën e re të Kuvendit të RM-së do të përfaqësohet me 7 deputetë. Në vend të pestë është OPQM me 31.610 vota të fituara ose 2,82% nga numri i përgjithshëm i votave, me çka kjo parti fitoi një mandat të deputetit. Në vendin e gjashtë është RDK, e cila fitoi 17.783, vota ose 1,59 % nga numri i përgjithshëm i votave e që po ashtu ishte numër i mjaftueshëm që të fitojë një mandat të deputetit. Nga koalicionet e tjera dhe partitë politike vetëm VMRO-PP arriti të fitojë mbi 1 % nga numri i përgjithshëm i votave në zgjedhje, por nuk arriti të fitojë mandat të deputetit. Për VMRO-PP votuan 16.772 – 1,50%, për "Koalicionin për Maqedoni Pozitive" votuan 10.566 – 0,94%, për koalicionin "Dinjitet për Maqedoninë" votuan 9.265 – 0,83%, për PSDM 4.700 – 0,42%, për PAE 3.194 votues ose 0,28%, për LPM 1.925 – 0,17% , për PNE 21 votuan 1.281 – 0,11%, për PPD 385 – 0,03%.

| Njësia zgjedhore | Të regjistruar në Listën e Zgjedhësve | Partia | Gjithsej vota | Gjithsej vota % | Mandate të fituara |
|---|---|---|---|---|---|
| **NJZ 1** | 297,686 | VMRO-DPMNE e të tjerë | 73,554 | 37.88% | 8 |
| | | LSDM e të tjerë | 58,091 | 29.92% | 7 |
| | | BDI | 26,657 | 13.73% | 3 |
| | | PDSH | 11.631 | 0.64% | 1 |
| | | OPQM | 8,725 | 4.49% | 1 |
| Dalja | | | 194,164 | 65.22% | |
| **NJZ 2** | 306,067 | VMRO-DPMNE e të tjerë | 74,649 | 40.53% | 10 |
| | | LSDM e të tjerë | 40,603 | 22.05% | 5 |
| | | BDI | 32,061 | 17.41% | 4 |
| | | PDSH | 13,764 | 7.47% | 1 |
| Dalja | | | 184,176 | 60.18% | |
| **NJZ 3** | 280,890 | VMRO-DPMNE e të tjerë | 112,176 | 56.41% | 13 |
| | | LSDM e të tjerë | 57,088 | 28.71% | 7 |
| Dalja | | | 198,863 | 70.80% | |
| **NJZ 4** | 280,810 | VMRO-DPMNE e të tjerë | 109,809 | 53.46% | 12 |
| | | LSDM e të tjerë | 70,004 | 34.08% | 8 |
| Dalja | | | 205,398 | 73.14% | |
| **NJZ 5** | 286,435 | VMRO-DPMNE e të tjerë | 78,953 | 45.01% | 11 |
| | | LSDM e të tjerë | 43,370 | 25.87% | 6 |
| | | BDI | 23,876 | 13.61% | 3 |
| Dalja | | | 175,402 | 61.24% | |
| **NJZ 6** | 304,458 | BDI | 62,848 | 41.54% | 9 |
| | | PDSH | 34,600 | 22.87% | 5 |
| | | VMRO-DPMNE e të tjerë | 25,911 | 17.13% | 4 |
| | | LSDM e të tjerë | 12,142 | 8.03% | 1 |
| | | RDK | 9,745 | 6.44% | 1 |
| Dalja | | | 151,300 | 49.69% | |
| **NJZ 7** | 18,911 | VMRO-DPMNE e të tjerë | 4,512 | 52.38% | 1 |
| Dalja | | | 8,614 | 45.55% | |
| **NJZ 8** | 3,337 | VMRO-DPMNE e të tjerë | 1,170 | 63.41% | 1 |
| Dalja | | | 1,845 | 65.29% | |
| **NJZ 9** | 1,534 | VMRO-DPMNE e të tjerë | 881 | 89.71% | 1 |
| Dalja | | | 982 | 64.02% | |

## MBROJTJA E TË DREJTËS SË ZGJEDHJES

Kodi Zgjedhor[95] e garanton mbrojtjen e të drejtës së zgjedhjes të paraqitësve të listave dhe të zgjedhësve. Nëse përfaqësuesit e autorizuar të paraqitësve të listave kanë vërejtje ndaj punës së këshillit zgjedhor gjatë procesit të votimit, ata kanë të drejtë të sugjerojnë për parregullsitë dhe të njëjtat të shmangen.

Vërejtjet e këtilla duhet të evidentohen në procesverbal dhe mbi këtë bazë pastaj paraqitësi të ngre procedurë për mbrojtjen e të drejtës së zgjedhjes. Nëse vërejtjet e këtilla nuk evidentohen në procesverbal, përfaqësuesit e paraqitësve të njëjtat duhet t'i paraqesin deri te Komisioni Komunal i Zgjedhjeve (KKZ) në afat prej 5 orësh, pas nënshkrimit të procesverbalit. Për dallim prej tyre, vëzhguesit e akredituar nuk guxojnë të ndikojnë mbi punën e organeve zgjedhore, mirëpo nëse kanë vërejtje duhet të evidentohen në ditarin e vendit zgjedhor. Paraqitësit e listave dhe zgjedhësit kanë të drejtë të paraqesin kundërshtime dhe ankesa nëse konsiderojnë se është shkelur e drejta e tyre. Kundërshtimet e paraqitësve të listave mund t'u referohen procedurave të votimit, përmbledhjes dhe përcaktimit të rezultateve, ndërsa zgjedhësit mund të paraqesin kundërshtim nëse gjatë procedurës u është shkelur e drejta e zgjedhjes. Procedura e cila zhvillohet për mbrojtjen e të drejtës së zgjedhjes është urgjente dhe prandaj paraqitja e kundërshtimit ose padisë nuk mund të dërgohet me postë.

Kundërshtimet, të cilat paraqitësit e listave i paraqesin në KSHZ doemos duhet t'i paraqesin në afat prej 48 orësh pas përfundimit të votimit, përkatësisht publikimit të rezultateve preliminare, ndërsa KSHZ e ka për detyrë që në afat prej 48 orësh pas pranimit të kundërshtimit të marr vendim. KSHZ për vendimin e miratuar e njofton paraqitësin e kundërshtimit përmes postës elektronike, ndërkaq vendimi konsiderohet si i dërguar, në afat prej pesë orësh nga dërgesa e shkresës elektronike.

95 Kodi Zgjedhor (tekst i spastruar), "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 32, nga 12 shkurt 2014. I aksesshëm në: http://www.sec.mk/files/IzborenzakonikzaWEB1.pdf (vizita e fundit: 4 maj 2014)



Paraqitësi i kundërshtimit, për të cilin është marrë vendim negativ, në kuadër të KSHZ-së, ka të drejtë në afat prej 48 orësh pas pranimit të vendimit të ngre padi në Gjykatën Administrative (GJA). Gjykata doemos duhet të miratojë vendim në afat prej 48 orësh pas pranimit të padisë. GJA mund ta konfirmojë ose ta ndryshojë vendimin e KSHZ, me ç'rast vendimet e saj janë të plotfuqishme, përkatësisht kundër tyre nuk mund të paraqitet ankesë ose ndonjë lloj tjetër të mbrojtjes juridike.

Në rast të shkeljes së të drejtës të zgjedhjes së zgjedhësit, i njëjti mund të paraqes kundërshtim deri te KSHZ në afat prej 24 orësh, ndërsa KSHZ e ka për detyrë të marr vendim në afat prej 4 orësh pas pranimit të të njëjtit. Vendimi i KSHZ-së mund të ankimohet, kështu që në afat prej 24 orësh, pas pranimit të vendimit, mund të paraqitet padi në GJA. Nëse afatet janë në rrjedhë e sipër dhe hasen gjatë procesit të votimit, ndërsa vendimi për zgjedhësin është pozitiv, të njëjtit do t'i mundësohet realizimi i të drejtës së tij të votës.

Në kuadër të afatit ligjor partitë politike pranë KSHZ paraqitën gjithsej 12 kundërshtime me të cilat kërkohej anulimi i votimit dhe përsëritje të zgjedhjeve në 72 vende zgjedhore (VZ) për kinse shkeljes së fshehtësisë së votimit dhe votimit familjar. Kundërshtime paraqitën tri parti, si vijojnë: BDI, PDSH dhe OPQM. Prej tyre, BDI paraqiti dy kundërshtime për procesin e votimit në 25 vende zgjedhore jashtë vendit, përkatësisht në njësinë zgjedhore 7 e cila e përfshinë Evropën dhe Afrikën. PDSH gjithsej paraqiti gjashtë kundërshtime për procesin e votimit në gjithsej 43 VZ në territorin e Republikës së Maqedonisë. Partia OPQM paraqiti 4 kundërshtime për votimin në 4 VZ në Maqedoni. Pas shqyrtimit të kundërshtimeve, KSHZ miratoi aktvendime se të gjitha kundërshtimet hidhen poshtë si të pabaza.[96] Pas vendimeve të KSHZ, partia OPQM dhe PDSH, brenda afatit

96 Kundërshtime për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare 2014, Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve të Republikës së Maqedonisë. I aksesshëm në: http://www.sec.mk/index.php?option=com_content&view=article&id=342:%D0%BF%D1%80%D0%B8%D0%B3%D0%BE%D0%B2%D0%BE%D1%80%D0%B8-%D0%B7%D0%B0-%D0%BF%D1%80%D0%B5%D0%B4%D0%B2%D1%80%D0%B5%D0%BC%-D0%B5%D0%BD%D0%B8-%D0%BF%D0%B0%D1%80%D0%BB%D0%B0%D0%BC%D0%B5%D0%BD%D1%82%D0%B0%D1%80%D0%BD%D0%B8-%D0%B8%D0%B7%D0%B1%D0%BE%D1%80%D0%B8-2014&catid=48&Itemid=1305&lang=mk (vizita e fundit: 15 maj 2014)

ligjor paraqitën nga katër padi në Gjykatën Administrative. Gjykata, sa u përket të gjitha padive, vendosi që të hidhen poshtë si të pabaza,[97] për shkak se nuk janë dhënë prova të cilat i vërtetojnë të dhënat sa u përket parregullsive, ose vërejtjet janë paraqitur pas skadimit të afatit. Partia më e madhe opozitare, LSDM, e cila fill pas përfundimit të votimit doli me vlerësim se zgjedhjet nuk ishin të rregullta, nuk paraqiti asnjë kundërshtim pranë KSHZ. Arsyetimi i partisë[98] sa i përket vendimit që të mos paraqesin kundërshtime, konsistonte me atë se ata plotësisht nuk e njohin procesin zgjedhor dhe se gjatë fushatës dhe pas rrethit të parë të zgjedhjeve presidenciale paraqitën 170 parashtresa për të cilat ata pohojnë se janë injoruar ose janë hedhur poshtë nga institucionet kompetente.

## VLERËSIMI I ZGJEDHJEVE NGA VËZHGUESIT

Për monitorimin e Zgjedhjeve të Parakohshme Parlamentare, të cilat u mbajtën njëkohësisht me rrethin e dytë të Zgjedhjeve Presidenciale, u akredituan gjithsej 10.013 vëzhgues vendas dhe 610 vëzhgues të huaj.[99] Shoqata për Aktivitete Humanitare "Sinergjia" ishte organizata me numër më të madh të vëzhguesve, përkatësisht 5.090. Asociacioni Qytetar MOST ishte në vendin e dytë sipas numrit të vëzhguesve me gjithsej 2.413 vëzhgues. Një numër të konsiderueshëm vëzhguesish kishte edhe Shoqata e Qytetarëve për Demokraci dhe Ngritje të Vetëdijes Kolektive "Dvizhenje VEPRO" – Strugë, misioni i së ta cilës numëronte 2.321 vëzhgues. Organizata CIVIL – Qendra për Liri kishte 113 vëzhgues, Shoqata "PLLOSHTAD SLOBODA" – 33 vëzhgues, Instituti për Strategji Ekonomike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare "OHRID" – 28 vëzhgues,

97 Vendime të Gjykatës Administrative Shkup. Gjykata Administrative Shkup, 2 maj 2014. I aksesshëm në: http://www.usskopje.mk/Odluki.aspx?odluka=17135 (vizita e fundit: 6 maj 2014)

98 KQ i LSDM unanimisht e miratoi vendimin për mospranimin e mandateve të deputetëve të zgjedhur. LSDM, komunikatë për publikun, 1 maj 2014. I aksesshëm në: http://sdsm.org.mk/default.aspx?mId=55&agId=5&articleId=10588 (vizita e fundit: 15 maj 2014)

99 Shih: Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve, Zgjedhje të Parakohshme Parlamentare 2014, Vëzhgues të akredituar. I aksesshëm në: http://217.16.84.23/files/izbori2014/21Tabela_na_akreditirani_nabljuduvaci.pdf (vizita e fundit: 30 prill 2014)



Shoqata e Qytetarëve – Qendra për Zhvillimin e Mediave Shkup – 9 vëzhgues dhe Qendra Maqedonase për Kulturë dhe Zhvillim – 6 vëzhgues.

Nga misionet e huaja numerikisht më i madh ishte Misioni i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë/Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (OSBE/ODIHR) me 252 vëzhgues. Misioni i OSBE veçmas kishte edhe 103 vëzhgues shtesë. Ambasada e SHBA – 37 vëzhgues, Organizata nga Danimarka SILBA dhe Asociacioni për Progres, Edukim dhe Lobim NEL – Shkup – 31 vëzhgues, AP e Këshillit të Evropës - 27 vëzhgues, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i Republikës së Kosovës – 17 vëzhgues, Ambasada e Italisë – 12 vëzhgues, Ambasada e Republikës së Turqisë – 11 vëzhgues, Ambasada e Republikës së Francës – 8 vëzhgues, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i Republikës së Shqipërisë – 8 vëzhgues, Komisioni i Zgjedhjeve për Ankesa dhe Parashtresa (ESAR) i Republikës së Kosovës – 6 vëzhgues, nga tre vëzhgues kishte secila nga ambasadat në vijim: Sllovakia, Gjermania, Austria, Spanja, Shqipëria dhe Zyra e NATO-s. Ambasada e Republikës së Kinës kishte dy vëzhgues dhe po aq vëzhgues kishte edhe Ambasada e Federatës Ruse dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i Gjeorgjisë.

Procesin zgjedhor e monitoruan edhe 42 gazetarët të akredituar të huaj.[100] Në numër më të madh ishte ekipi i rrjetit të televizionit "Al Xhezira Ballkan" me 18 gazetarë, Radiotelevizioni i Serbisë me 4, Agjencia dhe Radio "Fokus" me 3, ARD Radioja gjermane – 3, ndërsa nga dy gazetarë kishte Radiotelevizioni nga Turqia "Turk", TV "Rojters" – Serbi, "Top Chanel" – Tiranë, Radiotelevizioni i Turqisë, Agjencia Frans Press, Asoshietet Press dhe Televizioni "Koha Vizion" - Prishtinë.

Në raportin e tij preliminar nga monitorimi i Misionit të OSBE/ODIHR[101] konkludoi se Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare të 27

100 Shih: Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve, Zgjedhje të Parakohshme Parlamentare 2014, Vëzhgues të akredituar të huaj. I aksesshëm në: http://www.sec.mk/files/izbori2014/21Tabela_na_akreditirani_nabljuduvaci.pdf (vizita e fundit: 13 maj 2014)

101 Sipas: OSBE Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut. Republika e Maqedonisë, Zgjedhje Presidenciale dhe Zgjedhje të Parakohshme Parlamentare, 27 prill, 2014, Deklaratë për të dhënat dhe konkluzionet preliminare. Shkup, 28 prill 2014. I aksesshëm në: http://www.osce.org/mk/odihr/elections/fyrom/118079?download=true (vizita e fundit: 13 maj 2014)

prillit u zbatuan në mënyrë efikase, duke e përfshirë edhe ditën e votimit. Zgjedhjet u zbatuan pa pengesa dhe në mënyrë profesionale me disa parregullsi teknike të vërejtura gjatë ditës së votimit, ndërsa këshillat zgjedhorë (KZ) demonstruan njohuri të mirë të procedurave të votimit. Pozitivisht u vlerësua edhe procesi i përmbledhjes së rezultateve gjatë mbrëmjes së zgjedhjeve në ueb-faqen e KSHZ, dhe kjo perceptohet si masë pozitive për rritjen e mëtutjeshme të transparencës. Në konferencën për shtyp, të cilën e mbajti Misioni monitorues i OSBE/ODIHR pas rrethit të dytë të zgjedhjeve presidenciale dhe zgjedhjeve të parakohshme parlamentare, përfaqësuesit e Misionit bënë me dije se bojkotin që e paralajmëroi opozita, menjëherë pas përfundimit të zgjedhjeve, nuk është instrument demokratik dhe se partitë politike duhet të përdorin mjete politike.[102]

Në raportin preliminar theksohen edhe një sërë dobësish në procesin zgjedhor. Në mesin e tyre, konstatohet shfrytëzimi i resurseve publike në fushatën e partisë në pushtet përmes ndarjes joadekuate të aktiviteteve partiake prej atyre shtetërore, që është në kundërshtim me paragrafin 5.4 të Dokumentit të Kopenhagës të OSBE-së nga viti 1990 dhe me standardet e Këshillit të Evropës. Në këtë kontekst, Misioni e apostrofoi Ministren e Punëve të Brendshme e cila ishte bartëse e listës zgjedhore në NJZ 2. Ministrja, edhe përkrah detyrimit, nga Kodi Zgjedhor që funksionin ta pezullojë nëse është kandidate në zgjedhje, nuk është tërhequr nga funksioni dhe ka vazhduar ta ushtrojë të njëjtin. Misioni, sikurse edhe në zgjedhjet paraprake parlamentare, vërejti se shpërndarja e pabarabartë e votuesve në njësitë zgjedhore (NJZ) 7, 8 dhe 9 jashtë vendit dhe dallimi midis numrit të votuesve në NJZ brenda dhe jashtë vendit nuk e sigurojnë plotësisht barazinë e votës. Misioni i OSBE/ODIHR ka pranuar të dhëna të besueshme për presion të bërë ndaj votuesve, veçanërisht ndaj të punësuarve në administratën publike. Të dhënat për presione, në masë më të madhe, kanë të bëjnë me presionin për pjesëmarrje në ngjarjet e fushatës zgjedhore, presione që të mos merret pjesë në ngjarjet e

102 Radio Evropa e Lirë, OSBE - Zgjedhje të zbatuara në mënyrë efikase, por problemet mbeten, e mërkurë 30 prill 2014 http://www.makdenes.org/content/article/25365682.html (i aksesshëm më 28 prill 2014)



opozitës, premtime ose kërcënime sa i përket punësimit në administratën shtetërore. Janë pranuar edhe të dhëna lidhur me ndërprerjen e favoreve për mbrojtje sociale dhe blerje të votave në mesin e grupeve të rrezikuara ekonomikisht.

OSBE/ODIHR shprehu shqetësime sa i përket saktësisë së Listës së Zgjedhësve, dhe veçanërisht sa i përket numrit të madh të votuesve të cilët jetojnë në adresë të njëjtë. Misioni konstatoi se dispozitat ligjore, të cilat partive politike u mundësojnë që t'i kontestojnë të dhënat që kanë të bëjnë me votuesit në Listën e Zgjedhësve, janë të paqarta dhe në mënyrë të paqartë përcaktojnë se cila agjenci është përgjegjëse për zbatimin e hetimit që e ka dëmtuar zbatimin adekuat.

Asociacioni Qytetar MOST[103] i dha vlerësimet preliminare se votimi, më 27 prill, u zbatua në mënyrë efikase dhe pa incidente. Vëzhguesit vlerësuan se në ditën e zgjedhjeve ka pasur një intensitet të shtuar të mobilizimit të votuesve i cili në një numër të caktuar të rasteve ka kaluar në presion, ndërsa para disa vendeve zgjedhore janë vërejtur agjitime dhe evidentime të votuesve. Sipas MOST, në krahasim me rrethin e parë të zgjedhjeve presidenciale, dy javë paraprakisht, në zgjedhjet parlamentare të cilat u mbajtën bashkë me rrethin e dytë të zgjedhjeve presidenciale ka pasur rritje të konsiderueshme të rasteve të votimit grupor dhe familjar.

Nga OSBE/ODIHR dita e votimit u vlerësua si pozitive dhe mirë e organizuar, e zbatuar pa pengesa dhe në mënyrë profesionale në 96% të vëzhgimeve. Së këtejmi, parregullsia më e shpeshtë ka qenë votimi grupor. Vërehet se këshillat zgjedhorë nuk i kanë respektuar instruksionet e KSHZ-së që t'ua bëjnë me dije votuesve se mund të votojnë për njërën ose për të dyja zgjedhjet, ndërsa në pjesët në të cilat kryesisht jetojnë shqiptarë etnike, këshillat zgjedhorë u kanë sugjeruar votuesve të mos e marrin fletëvotimin për Zgjedhjet Presidenciale. Misioni vëren se votimi, një ditë para zgjedhjeve, sa u përket të sëmurëve, të pamundurve dhe të

103 Asociacioni Qytetar MOST, Zgjedhje Presidenciale dhe Zgjedhje të Parakohshme Parlamentare 2014, Deklaratë preliminare 28.04.2014, Shkup http://most.org.mk/images/MOST/Preliminarna%20izjava_vtor%20krug_28%2004%202014_MKD.pdf I aksesshëm më 3 maj 2014

burgosurve, i cili u mbajt më 26 prill, parimisht është zhvilluar në mënyrë transparente, mirëpo fshehtësia e votimit nuk është siguruar në 16 prej 95 rasteve. OSBE/ODIHR ka nënvizuar se ka pasur raste kur disa të burgosur përkrah asaj se kanë pasur letërnjoftime të vlefshme nuk janë përfshirë në Listën e Zgjedhësve dhe për këtë shkak nuk kanë mundur të votojnë. Pozitivë është vlerësimi i përgjithshëm për numërimin e votave, me ç'rast janë vërejtur parregullsi procedurale vetëm në 17 raste.

Vlerësimi i OSBE/ODIHR konsiston me atë se, gjatë fushatave të zgjedhjeve të parakohshme parlamentare, kandidatët kishin mundësi pa pengesë t'i zhvillojnë fushatat, ndërkaq liria e bashkimit dhe shoqërimit ishte e respektuar. Në konferencën për shtyp, të cilën e mbajti Misioni pas votimit në zgjedhjet parlamentare dhe rrethit të dytë të zgjedhjeve presidenciale, u theksua se megjithatë, problemet e periudhës parazgjedhore e kanë vënë nën hije ditën e votimit. Vërejtjet kryesore kishin të bënin me ndarjen e shtetit nga partia, paanshmërinë e mediave, saktësinë e Listës së Zgjedhësve dhe mundësinë e procedurave efektive në procedurat ankimore.

Vërehet se përveç dy partive më të mëdha, VMRO-DPMNE dhe LSDM, të cilat kanë organizuar mitingje të përbashkëta për kandidatët e tyre presidencial dhe për kandidatët për deputetë në Kuvend, në përgjithësi të gjitha partitë dhe koalicionet janë përqendruar në ngjarje dhe takime më të vogla, si dhe në fushatë nga dera në derë, si strategji kryesore për komunikim me votuesit. Së këtejmi, në mitingjet e monitoruara nuk janë vërejtur çrregullime dhe të njëjtat kanë qenë mirë të vizituara.

OSBE/ODIHR vëren se fjalimet në mitingjet e PDSH-së janë përcjellë me një gjuhë të tensionuar të drejtuar kundër BDI-së dhe veçanërisht kundër liderit të saj Ali Ahmeti. Akuzat për korrupsion midis partive, në kuadër të blloqeve etnike, e kanë ulur nivelin e diskutimeve në fushata dhe e kanë tërhequr vëmendjen nga çështjet konkrete dhe platformat partiake. Vërehet se të dyja partitë e koalicionit qeveritar, VMRO-DPMNE dhe BDI, u kanë apeluar bashkësive të tyre etnike që tua sigurojnë numrin e nevojshëm të mandateve në mënyrë që t'i përforcojnë pozitat e tyre dhe t'u shmangen reterimeve  në negociatat e ardhshme për formimin e Qeverisë.

Asociacioni MOST vlerëson se në periudhën nga fillimi i fushatës së zgjedhjeve parlamentare dhe në rrethin e dytë të zgjedhjeve presidenciale, fushata është tensionuar, sa i përket retorikës dhe aktiviteteve, me ç'rast numërohen incidente më të vogla në më shumë komuna, të cilat në masë më të madhe kanë të bëjnë me dëmtimin e shtabeve zgjedhore. Në periudhën e njëjtë, raportohet edhe për kinse presione mbi të punësuarit në administratën publike, ndërsa në të njëjtën kohë vërehet edhe një intensitet i rritur i zhvillimit të fushatës negative midis partive politike. Vëzhguesit e MOST kanë vërejtur përdorimin e automjeteve zyrtare në fushata dhe prezencë të të miturve nëpër mitingjet e të gjitha subjekteve politike. Vërehet edhe thirrje për mobilizimin e votuesve në baza etnike, i shprehur përmes kërkesë së liderit të VMRO-DPMNE për fitimin e shumicës absolute në Kuvend dhe kërkesës së liderit të BDI-së për fitimin e 25 mandateve të deputetëve që vlerësohet se është në kundërshtim me angazhimet për ndërtimin e një shoqërie të qëndrueshme multietnike dhe multikulturore.

Misioni i OSBE/ODIHR punën e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve e vlerësoi si efikase dhe transparente, mirëpo në disa raste janë mbajtur seanca në të cilat KSHZ nuk i ka thërritur që të marrin pjesë mediat dhe vëzhguesit. Vërejtja kryesore është se ka pasur ndarje të dukshme midis anëtarëve të KSHZ-së të partive të ndryshme politike dhe votim sipas linjës partiake për të gjitha çështjet me rëndësi politike, gjë të cilën e ka nënvizuar edhe MOST, e cila po ashtu ka nënvizuar se në këtë cikël zgjedhor KSHZ ka qenë më pak transparente, në krahasim me zgjedhjet paraprake. Raporti i OSBE/ODIHR e kritikon komunikimin e dobët të KSHZ me komisionet komunale të zgjedhjeve në dy rrethet zgjedhore dhe ka rezultuar me konfuzione sa u përket procedurave. MOST i përkushton vëmendje të veçantë asaj se KSHZ nuk i ka publikuar të dhënat e këqyrjes publike të listave të zgjedhësve për të dy ciklet zgjedhore.

Monitorimi i mediave nga ana e OSBE/ODIHR tregoi se ka dallime midis informimit kuantitativ dhe kualitativ të pjesëmarrësve në fushatën zgjedhore nga ana e mediave, mungesë të analizave, mungesë të informimit të pavarur. Misioni vlerëson se kanali i servisit publik Radiotelevizioni Maqedonas 1 (RTVM), në mënyrë pozitive i ka mbuluar aktivitetet e partisë në pushtet VMRO-DPMNE dhe të kandidatit të saj presidencial. Televizionet private: Sitel, Kanal 5 dhe Alfa, kryesisht kanë pasur qëndrime negative ndaj LSDM-së dhe kandidatit të tyre presidencial, ndërsa kanali i servisit publik RTVM 2 në gjuhën shqipe ka pasur raportime më pozitive dhe neutrale ndaj BDI-së. Raporti, gjithashtu, vlerëson se televizionet private: Sitel, Kanal 5 dhe Alfa kanë pasur qëndrim pozitiv ose neutral gjatë raportimeve për VMRO-DPMNE, ndërsa qëndrim negativ gjatë raportimeve për LSDM. Po ashtu, kanë siguruar mbulim të konsiderueshëm mediatik të aktiviteteve të ministrave – kandidatë në garën zgjedhore. Televizioni Telma, 24 Vesti dhe Alsat – M u vlerësuan se kanë raportuar në mënyrë të balancuar, neutrale dhe me një proporcion të ngjashëm sa u përket kundër-kandidatëve. Nga ana tjetër, qëndrimi i raportimeve mediatike të 24 Vesti u vlerësua si neutral, ndërsa i TV Telma me qëndrim kritik gjatë raportimeve për Qeverinë dhe partinë në pushtet VMRO-DPMNE. Vlerësohet se qëndrimi i raportimeve mediatike të TV Alsat – M ka qenë kryesisht neutral me atë që BDI ka pasur më shumë mbulim pozitiv mediatik, në krahasim me partitë e tjera.

Delegacioni i Bashkimit Evropian dhe Ambasada e SHBA-së në Republikën e Maqedonisë dolën me deklaratë[104] të përbashkët me vlerësime dhe komente për zgjedhjet. Ata u shprehën mirënjohje qytetarëve që e shfrytëzuan të drejtën e tyre të votës në zgjedhjet presidenciale dhe në ato parlamentare më 27 prill. Në deklaratë u prezantuan vlerësimet e OSBE/ODIHR rreth zbatimit efikas të zgjedhjeve, njëanshmërisë mediatike, bashkimit të aktiviteteve shtetërore dhe partiake. Përfaqësuesit e BE-së dhe SHBA-së shpresojnë se qeveria e ardhshme do t'i adresojë këto vërejtje, si

[104] Deklaratë e përbashkët e Delegacionit të Bashkimit Evropian dhe Misionit të SHBA. Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, 29 prill 2014. I aksesshëm në: http://macedonia.usembassy.gov/news-events2/press-releases2014/pr04292014.html (vizita e fundit: 13 maj 2014)



dhe shpresojnë se të gjithë liderët politikë do të kenë qasje konstruktive sa u përket reformave lidhur me integrimin euroatlantik të vendit.

## VLERËSIMI I ZGJEDHJEVE NGA PARTITË POLITIKE

Me vlerësime të ndryshme për procesin zgjedhor dolën partitë politike, pjesëmarrëse në zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 27 prillit. Partitë më të mëdha politike, VMRO-DPMNE e cila e udhëhiqte koalicionin "Për Maqedoni më të Mirë" dhe LSDM e cila e udhëhiqte koalicionin e opozitës, të cilat fituan më së shumti vota dhe mandate në legjislaturën e re të Kuvendit, dolën me vlerësime të kundërta për procesin zgjedhor. Vetëm pak minuta pas mbylljes së vendvotimeve, në ora 19 në ditën e zgjedhjeve, më 27 prill, konferencë për shtyp mbajti VMRO-DPMNE. Kandidati për deputet dhe bartës i listës zgjedhore nga VMRO-DPMNE, Antonio Milloshoski, procesin zgjedhor e kualifikoi si proces të qetë, të ndershëm dhe demokratik. Milloshoski deklaroi se "qytetarët treguan se kanë vetëdije demokratike dhe në vepër konfirmuan se dinë të përcaktojnë se cili është interesi i tyre dhe interesi shtetëror". Ai theksoi se duke e pasur parasysh se procesi zgjedhor dhe votimi kaluan pa asnjë incident dhe probleme më serioze, të cilat do të mund të ndikonin mbi rezultatin e zgjedhjeve është arritur fitore e madhe, ndërkohë që zgjedhjet i vlerësoi si më të qetat në historinë e Republikës së Maqedonisë së pavarur. Milloshoski e akuzoi LSDM dhe liderin e opozitës Zoran Zaev për fabrikimin e skenarëve për parregullsi zgjedhore, gjë që ishte identifikuar nga qytetarët.[105] Ai tha se LSDM ka bërë përpjekje të inskenojë ambient për jolegjitimitet të zgjedhjeve përmes shkeljes së heshtjes zgjedhore nga ana e mediave, të cilat janë të afërta me partinë në opozitë, me atë që kanë shpërndarë teza të pakonfirmuara për kinse sjellje jodemokratike të pjesëmarrësve në zgjedhje dhe në procesin zgjedhor, por pa prova legjitime dhe të vlefshme, të cilat kanë qenë në nivel të spekulimeve dhe manipulimeve. Milloshoski e akuzoi partinë opozitare për presione

[105] VMRO-DPMNE: "Fituan qytetarët, patëm zgjedhje të qeta dhe të ndershme". "Dnevnik", 27 prill 2014. I aksesshëm në: http://www.dnevnik.mk/default.asp?ItemID=FCA9C798EE508648B7BAE3B60B977D83 (vizituar më 5 maj 2014).

mbi administratorët në komuna, të cilët janë nën kontrollin e tyre. Lideri, Nikolla Gruevski[106] vonë në mbrëmje, pas shpalljes së rezultateve jozyrtare të votimit, vlerësoi se VMRO-DPMNE në zgjedhje ka realizuar fitore të dyfishtë të madhe dhe të fuqishme, me çka qytetarët në nëntë cikle zgjedhor me radhë ia kanë dhënë besimin partisë së tij. Ai tha se ka fituar koncepti i punës së palodhshme, qasjes së sinqertë ndaj qytetarëve dhe realizimit të premtimeve konkrete.

Njëkohësisht, me konferencën e parë për shtyp të VMRO-DPMNE, disa minuta pas përfundimit të votimit, konferencë për shtyp mbajti edhe lideri i LSDM, Zoran Zaev,[107] në të cilën deklaroi se para se të fillojë numërimi i votave, partia e tij nuk do t'i pranojë zgjedhjet sepse në to ka pasur vjedhje zgjedhore nga ana e pushtetit, në të cilat, siç tha, janë shkelur të gjitha nenet e Kodit Zgjedhor. Zaev akuzoi për keqpërdorim të sistemit shtetëror në shërbim të interesave partiake të partisë në pushtet, uzurpim të së drejtës së qytetarëve për shprehjen e lirë të vullnetit, mitosje të votuesve, presione mbi punonjësit e administratës publike, pranuesve të asistencës sociale dhe firmave, votim të të ashtuquajturve "votues fantazmë", agjitim të liderëve fetarë, keqpërdorim të servisit publik radiodifuziv dhe dezinformim të publikut nga ana e mediave private proqeveritare. Në kontekst të zbatimit të procesit zgjedhor, Zaev akuzoi edhe për ekzistimin e fletëvotimeve të dyfishta, fotografimin e fletëvotimeve, fshirjen e bojës së gishtit, votimin grupor, si dhe parregullsi të tjera. Lideri i LSDM shpalli se zgjedhjet presidenciale dhe parlamentare nuk do të njihen nga ana e LSDM dhe opozitës së bashkuar, kërkoi formimin e qeverisë teknike, e cila do ta zhvillonte procesin zgjedhor. Duke e marrë parasysh qëndrimin e këtillë për procesin zgjedhor, partia nuk mbajti konferencë plotësuese për shtyp kur u shpallën rezultatet jozyrtare nga numërimi i votave.

BDI, atë natë, pas përfundimit të votimit derisa zgjaste numërimi i votave doli me vlerësim se zgjedhjet kanë kaluar në atmosferë të qetë,

[106] Gruevski: "Kjo është fitore e madhe, e fuqishme dhe besim i pakontestueshëm". "Dojçe Vele", programi në gjuhën maqedonase, 27 prill 2014. I aksesshëm në: http://goo.gl/TBFzII (vizituar më: 5 maj 2014)

[107] Zaev: "Nuk e njohim procesin zgjedhor, qeveri teknike për zgjedhje të ndershme", LSDM 27 prill 2014. I aksesshëm në: http://sdsm.org.mk/default.aspx?articleId=10576&mId=55& agId=6 . (vizita e fundit: 5 maj 2014)



të ndershme dhe demokratike. Para mesnatës, lideri i partisë, Ali Ahmeti mbajti konferencë për shtyp[108] në të cilën deklaroi se partia, në këto zgjedhje ka realizuar fitore historike ndaj rivalit të tij më të madh të bllokut politik shqiptar PDSH. Ai, i falënderoi votuesit shqiptarë për mbështetjen e dhënë. Ahmeti nuk e komentoi qëndrimin e opozitës për mosnjohjen e procesit zgjedhor.

Lideri i PDSH-së, Menduh Thaçi,[109] në konferencën për shtyp vlerësoi se procesi zgjedhor ka kaluar me një sërë parregullsish, përfshirë edhe kërcënime, blerje të votave dhe presione nga ana e BDI-së. Ai deklaroi se është i kënaqur nga rezultati i zgjedhjeve të PDSH, por edhe se nuk do t'i njeh rezultatet e rreth 30 vendeve zgjedhore. Thaçi akuzoi se BDI ka fituar rreth 57 mijë vota me anë të vjedhjeve, dhunës dhe kërcënimeve.

Rufi Osmani, kryetar i RDK,[110] pas zgjedhjeve, ngjashëm sikurse edhe LSDM shpalli se partia nuk do t'i njeh zgjedhjet. Ai vlerësoi se zgjedhjet kanë kaluar me presione dhe parregullsi të mëdha dhe i vlerësoi si "masakër zgjedhor". Në mënyrë që të dilet nga situata e tillë, Osmani kërkoi të formohet qeveri e përkohshme, ndërsa bashkësia ndërkombëtare të mos i pranojë rezultatet e zgjedhjeve në Maqedoni.

Stevçe Jakimovski,[111] kryetar i partisë OPQM (GROM), e cila e udhëhiqte Koalicionin OPQM, natën pas përfundimit të votimit, në konferencën për shtyp vlerësoi se zgjedhjet parlamentare kanë qenë të ndershme, demokratike dhe dinjitoze. Ai deklaroi se anëtarët e tyre nga asnjë shtab zgjedhor ose organizatë komunale nuk kanë pasur kurrfarë vërejtje ose ankesa për rrjedhën e procesit zgjedhor në dhe jashtë vendeve të votimit.

[108] Ali Ahmeti: "Fitore historike e BDI", Telegraf, 27 prill 2014. I aksesshëm në: http://www.telegraf.mk/aktuelno/makedonija/142223-ali-ahmeti-istoriska-pobeda-na-dui (vizita e fundit: 5 maj 2014)

[109] Thaçi: PDSH ka mjaftueshëm deputetë për të hyrë në qeveri. TV Nova, 27 prill 2014. I aksesshëm në: http://novatv.mk/index.php?navig=8&cat=23&vest=13668 (vizita e fundit: 5 maj 2014)

[110] Rufi Osmani: Nuk i pranojmë rezultatet e zgjedhjeve. Plusinfo, 27 prill 2014. I aksesshëm në: http://www.plusinfo.mk/vest/134856/Rufi-Osmani-Ne-gi-prifakjame-iz-bornite-rezultati (vizita e fundit: 13 maj 2014)

[111] Jakimovski, OPQM: Kishim zgjedhje të ndershme, urime për VMRO-DPMNE. Vest, 27 prill 2014. I aksesshëm në: http://www.vest.mk/default.asp?ItemID=8C2E9E7FEDDEFA469210015F49E35751 (vizita e fundit: 5 maj 2014)

Jakimovski ia uroi fitoren VMRO-DPMNE. Nga ana tjetër, partia PL[112] e cila në zgjedhje mori pjesë si pjesë e Koalicionit OPQM, menjëherë pas përfundimit të votimit, përmes komunikatës publikoi se solidarizohet me partitë opozitave në krye me LSDM për të mos e njohur procesin zgjedhor dhe mospranimin e rezultateve të zgjedhjeve. Partia arsyetoi se rregullshmëria nuk varet vetëm nga dita e votimit, por nga atmosfera e përgjithshme gjatë periudhës parazgjedhore, përdorimit të institucioneve dhe organeve të shtetit dhe nga liria e shprehjes së besimit personal politik. PL vlerësoi se shteti është futur në një gjendje të re politike dhe shthurja është e mundshme vetëm pasi të sqarohen të dhënat për aferat korruptive të cilat u plasuan në publik ndërmjet dy rretheve zgjedhore.

